MAL BERISHA

Mal Berisha
REALITETE
Shqiptaro ~ Britanike
Histori
Diplomaci
Kulturë

NË NJË KRONIKË HISTORIKE – DIPLOMATIKE

Diplomacia ka qenë ëndrra e rinisë time prandaj edhe ky libër i kushtohet pikërisht:

Andrës.

Ambasada shqiptare në Londër
33 St George's Drive, London, SW1V4DG

HYRJE

Ky libër është rezultati i një vëzhgimi të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar në një rrjedhë kronologjike, historike dhe diplomatike. Lexuesi do të gjejë një mori faktesh që ndodhin në një periudhë kohore që përthekon mëse katër shekuj. Ajo pasqyron në një masë të madhe perceptimin e britanikëve për popullin shqiptar të cilin e kanë formuar nëpërmjet shënimeve të udhëtarëve të tyre që e kanë vizituar vendin tonë. Në të gjënden materialet e disa prej ngjarjeve më kryesore të cilat iu kanë dhënë formën marrëdhënieve midis dy popujve tanë. Ato të gjitha kanë rëndësi historike të jashtëzakonëshme të ndodhura tërësisht në një sfond diplomatik dhe kanë të bëjnë me Shqipërinë, përpjekjet për çlirimin nga otomanët, formimin e shtetit shqiptar, përcaktimin e kufijve, njohjen ndërkombëtare, Luftën e Dytë Botërore, çlirimin e Kosovës... Si një rrjedhojë llogjike e këtyre marrëdhënieve lind përfaqësimi diplomatik i të dy vendeve respektive. Në libër është vendosur një përshkrim kronologjik i pranisë së misioneve diplomatike dhe shefave të tyre në dy vendet që nga viti 1922 deri më sot. Në të gjendet një boshllëk i madh pesëdhjetë vjeçar, por që është edhe ai pjesë e historisë. Një vend të rëndësishëm ze edhe misioni diplomatik i Republikës së Kosovës në Londër, i vendosur në një plan korrektimi të historisë sonë që nga Kongresi i Berlinit dhe Konferenca e Londrës deri tek ndërhyrja e NATO–s kundër Jugosllavisë së Milosheviçit, ku britanikët kanë patur rol parësor. Më tej vijohet me një përshkrim të Shoqatës Anglo – Shqiptare si organizata më e vjetër ende në ekzistencë jo vetëm në Britaninë e Madhe por edhe në botë e krahasueshme vetëm me atë "*Vatra*" në ShBA. Libri përmban një listë biografishë të shkurtëra të disa miqëve të shquar britanikë të Shqipërisë, në të gjallë të tyre. Marrëdhëniet diplomatike midis dy shteteve maten nga numri i marrëveshjeve që ato kanë nënshkruar. Kjo është arsyeja përse janë vënë tëra ato që ne kemi nënshkruar tashmë me këtë vend në rrjedhë të kohërave. Në një libër si ky ku nënkuptohet aq shumë diplomacia kulturore nuk mund të mos përmenden katër shenja të rëndësishme që jo vetëm të kujtojnë Shqipërinë në Londër, por edhe e nderojnë atë.

Ky nuk është një libër analitik mbi historinë e diplomacisë shqiptaro – britanike. Këtë e kanë bërë shumë autorë dhe secili ka dhënë mendimin e vet. Ky është një libër i bazuar në fakte të cilat secili lexues mund t'i shohë dhe interpretojë sipas dëshirës. Ndoshta vendosja e tyre në një libër të përbashkët, thjesht ndihmon në ndriçimin e atyre gjërave që ne shpesh i kemi dëgjuar të interpretuara sipas interesave të caktuara. Qëllimi im është thjesht të mundësoj njohjen me to, njohjen me anën më pozitive të

këtyre mardhënjeve të cilat sa më shumë të forcohen aq më mirë është për ne shqiptarët. Tek e fundit, sikur vetëm nxjerrja nga dollapët e pluhurosur për një moment dhe paraqitja e këtyre shkrimeve para lexuesit shqiptar do t'ja vlente një mundim të tillë.

Me këtë rast dua të falënderoj miqt e mi Sir Noel Malcom, Dr. Robert Elsie, studjuesin Bejto Destani, Prof David Shankland, koleksionisten e veprave në gjuhën shqipe, znj. Patrica Nugee, z. Alexander Duma, Dr. Adam Yemey të cilët më kanë ndihmuar dhe frymëzuar në përpjekjet e mia për të arritur në fund të këtij libri.

Shpresoj se ky libër do të shërbej edhe si një metodë pune për diplomatët tanë, në mënyrën sesi duhet të njohin historinë e marrëdhënieve midis vendit tonë dhe vendit ku ata do të kenë fatin të postohen për t'i shërbyer më mirë çështjes tonë kombëtare.

Mal Berisha

KAPITULLI I PARË

UDHËTARËT MË TË SHQUAR BRITANIKË NË SHQIPËRI NGA SHEKULLI XVII DERI SOT

Ky kapitull është një përmbledhje e shkurtër historike e përshkrimeve që shumë udhëtarë britanikë, të cilët kanë kaluar nëpër Shqipëri, kanë lënë të shkruara nëpër librat dhe kronikat e kohës së tyre. Ata shkruajnë për Ilirinë dhe Shqipërinë që nga vitin 1602 dhe 1603, duke filluar nga Shekspiri e Richard Knolles.

I pari anglez që ka shkelur në Shqipëri mendohet të jetë Edward Braun, në vitin 1669. Të tjerë autorë të njohur për ne shqiptarët janë Lord Byron, Edward Lear, Edith Durham. Sidoqoftë një pjesë e madhe e këtyre udhëtarëve që kanë shkruar kujtimet e tyre ende nuk janë shumë të njohur për opinionin e gjerë në Shqipëri. Të gjithë këta udhëtarë britanikë, artistë, studiues, politikanë, arkitektë ose njerëz të thjeshtë i kanë ndihmuar me shkrimet e tyre njohjes së popullit shqiptar dhe trojeve të tij në Ballkan, duke krijuar një fond me vlera të rralla në Britaninë e Madhe. Përshtypjet, ditaret, përshkrimet e tyre historike, gjeografike, antropologjike, studimet gjuhësore ose thjesht veprat letrare poetike, sigurisht, parë në prizmin e teorive dhe dijeve të epokës së tyre, kanë ndërtuar imazhin dhe idenë për ne shqiptarët, si një popull me një histori e kulturë të lashtë, që jeton në vise të një bukurie të rrallë. Natyrisht, kjo nuk është kufizuar thjesht në ishullin Britanik por është shtrirë në të gjithë botën anglisht - folëse në tri kontinentet. Dhe kjo është edhe një ndihmesë tjetër e këtyre udhëtarëve në njohjen e Shqipërisë në ato anë të botës.

Në faqet e këtij libri gjenden fragmente të zgjedhura, shpesh të përkthyera për herë të parë në gjuhën shqipe nga ky varg i madh emrash të shkrimtarëve anglezë që përfshin me dhjetra vepra të shkruara në një hark kohor prej gati katër shekujsh.

Më duhet të theksoj se qëllimi i këtij libri nuk është krijimi i një antologjie të shkrimeve britanike për Shqipërinë, por kryesisht për të nënvizuar mesazhin, se janë pikërisht këto shkrime që përbëjnë kontekstin e hapësirës enciklopedike në të cilën janë thurur marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve e popujve tanë, duke ravijëzuar edhe bazat e para të këtyre relacioneve.

Përzgjedhja e fragmenteve ka synuar paraqitjen e larmisë dhe vlerës së këtyre përshkrimeve, të cilët përfshijnë komente mbi prejardhjen pellazge – ilire të popullit tonë, të gjuhës shqipe, natyrës, si dhe kontributin e kombit tonë në historinë e njerëzimit.

Britanikët i kanë rënë kryq e tërthor Shqipërisë nga Janina e Preveza deri në Mitrovicë, nga Plavë e Gucia në Ulqin e në Tivar, nga Shkupi, Dibra, Mirdita, Struga e Manastiri në Kaçanik e Ferizaj, nga Elbasani në Vlorë, Korçë, Berat e Gjirokastër, nga Malësia e Madhe në Pukë e Gjakovë, nga Kavaja, Durrësi, Tirana, Lezha e Shkodra... Nuk ka thuajse asnjë vend të Shqipërisë që ata nuk e kanë shkelur me këmbë. Një pjesë e tyre kanë vënë re të njëtat gjëra, madje kanë cituar udhëtarët paraardhës, por secili ka ruajtur origjinalitetin e vet në mënyrën sesi e ka përshkruar vendin tonë.

Autori i parë anglez i cili e përmend Ilirinë, mbetet padyshim William Shakespeare në komedinë e tij *"Nata e Dymbëdhjetë"*. Kjo vepër mendohet se është shkruar në vitin 1602. Ngjarja zhvillohet në brigjet e Ilirisë dhe kjo përbën ndoshta rastin e parë kur përmenden ndodhi ilire nga gjeniu më i madh i letrave në historinë e njerëzimit. Fill pas tij një anglez tjetër, Richard Knolles boton një libër shumë voluminoz për Historinë e Turqisë, ku vendi ynë gjen një pasqyrim të veçantë. Kështu do të desha ta marr lexuesin në një udhëtim letrar me shënime udhëtimi, ditare, shkrime, poezi, drama, piktura në të cilat gjenden vlerësime nga ato që sot do të dëshironim t'i dëgjonim përsëri për kombin tonë.

1610

RICHARD KNOLLES

[1]

Një histori e tërë e shqiptarëve, brenda një historie tjetër.

Richard Knolles ka qenë një historian i famshëm anglez. Mendohet se ka lindur në vitin 1540 në Northamtonshire dhe ka vdekur në vitin 1610. Ai ka studjuar në Kolegjin Linkoln, në Oksford. Knolles ka shkruar librin *"Historia e Përgjithshme e Turqve"*. Ky libër është botuar për herë të parë në vitin 1603 dhe për herë të dytë në vitin 1610. Më pas libri është botuar disa herë deri në vitin 1700. Çështja e turqve në atë kohë, në Europë, ishte bërë shumë temë tërheqëse. Nga viti 1501 deri në vitin 1550, për ta janë botuar thuajse 1000 libra në mbarë Europën. Megjithatë libri i Richard Knolles mbetet si e para kronikë e bazuar në aspektet ushtarake dhe politike të Perandorisë Osmane, e shkruar në gjuhën angleze. Historitë e mëparshme për Turqinë janë shkruar në latinisht dhe nuk janë aq të njohura. Ai ka lënë një trashëgimi të jashtëzakonshme në përkthimin nga latinishtja të origjinalit të Camden-it, të cilin e ka quajtur "*Bretannia*". Ky libër gjëndet

[1] Kjo është foto e marrë nga kopertina e librit origjinal, botuar në vitin 1610, i cili ruhet në rezidencën e Ambasadorit Turk në Londër.

në librarinë Bodleian në Universitetin e Oksfordit. Në librin në fjalë[2] gjenden dy prej historive më interesante të mesjetës që kanë të bëjnë me shqiptarët: Njëra është Historia e Luftës së Kosovës, 1389, aq shumë e përvetësuar nga serbët si një betejë thjesht midis turqve dhe serbëve, ku shqiptarët përjashtohen tërësisht. Richard Knolles e përshkruan atë si "*një betejw ku u ndeshën një koalicion i përbërë nga të krishterët, hungarezë, kroatë, shqiptarë, boshnjakë e serbë dhe në anën tjetër turqit osmanë*". Në të gjithë kapitujt e librit flitet për sulltanët osmanë dhe paralel me ta princët dhe mbretërit e krishterë bashkëkohës në Europë. Ai e fillon rrëfimin e tij me Sulltanin Ertuğrul dhe e mbyll me Sulltan Mehmetin e Tretë. Interesante është periudha nga viti (1443–1468)[3]. Një kopje e botimit të vitit 1610 gjendet në Rezidencën e Ambasadorit turk në Londër[4] dhe përbën një thesar të çmuar të kësaj rezidence, siç përbën interes fakti që marrëdhëniet midis Perandorisë Osmane dhe asaj Britanike janë vendosur në vitin 1510.

[2]The General Historie of the Turkes from the first beginning of that nation to the rising of the Othoman familie: Ky është titulli në original i librit tashmë 405 vjeçar.

[3]*Scanderbeg* prince of the Epirots, vnto *Vladislaus* king of Hvngarie and Polonia. Faqe 745

[4] Këtë libër kam patur rastin ta shoh dhe fotografoj më datën 10 prill të vitit 2015 në rezidencën e Ambasadorit Turk në Porltand, në Londër, z. Abdurrahman Bilgic. Më pas arrita të siguroja një kopje elektronike, e cila përbën edhe materialin faktik të përdorur për këtë pasazh libri.

1669

EDWARD BROWN

Ndoshta i pari Britanik në Shqipëri

"Këtu, ushtria më e madhe e krishterë që ishte sjellë ndonjëherë në fushë-betejë në Europë, e përbërë prej pesëqindmijë burrash nën Despotin Llazar të Serbisë, luftoi kundër forcave të Muratit të Parë dhe humbi."

Eduard Brown, mendohet se mund të jetë i pari britanik, i cili ka shkelur në Shqipëri, në vitin 1669. Po kush ishte ky njeri që guxoi të shkelte në viset shqiptare në atë kohë?

Eduard Brown ka lindur në vitin 1644 dhe ka vdekur në vitin 1708. Ishte mjek dhe udhëtar anglez i shquar, i cili ka kaluar nëpër shumë toka europiane. Ai ka udhëtuar dhe në Shkup edhe në Kosovë. Njihet për librin e tij të quajtur "*Një vlerësim i shkurtër i disa udhëtimeve në pjesë të ndryshme të Europës*"[5], botuar në Londër në vitin 1673. Në shkrimet e tij ai na jep një pamje të këtij qyteti me tregti të madhe, aty flet për Shkupin si një qytet me punishte lëkure dhe me shtatëqind regjës të tyre, të cilët furnizojnë pjesët e tjera me këtë mall. Aty ai përshkruan monumente të shumta veçanërisht një ujësjellës të gjatë që lidhte dy malet. Po ashtu në shkrimin e tij "*Një udhëtim nëpërmjet Shkupit dhe Kosovës*", ai shkruan për romakun Regillianus dhe betejat e tij të fituara siç i tregon Trebellius Pollio në Shkup. Më pas përshkruan historinë e Betejës së Kosovës ku mbetën të vrarë Car Llazari dhe Sulltan Murati. Ai e përshkruan edhe Kaçanikun, Bjellacerkën ose Kurshumlinë dhe po ashtu Prishtinën. Ja sesi e përshkruan Betejën e Fushë Kosovës:

> *"Këtu, ushtria më e madhe e krishterë (vini re, jo ushtria serbe - MB) që ishte sjellë ndonjëherë në fushë-betejë në Europë, e përbërë prej pesëqindmijë burrash nën Despotin Llazar të Serbisë, luftoi kundër forcave të Muratit të Parë dhe humbi. Në atë betejë Llazari u vra ndërsa Murati, tek vizitonte trupat e vdekur u godit me thikë prej Milosh Kopiliçit, një ushtar i krishterë i pandehur si i vdekur në fushë. Murati ka në ato fusha një monument përkujtimor edhe sot e kësaj dite. Dhe*

[5] *Edward Brown,* A Brief Account of Some Travels in Divers Parts of Europe, viz. Hungaria, Servia, Bulgaria, Macedonia, Thessaly, Austria, Styria, etc. *London: Benj. Tooke, 1687.*

kjo pjesë është quajtur fusha e varrit (sepulcher), në të njejtën fushë ku ishte bërë edhe beteja e jashtëzakonshme midis Huniadit dhe Muhametit, për tri ditë rresht; kur Huniadi, duke patur forca krejt të pabarabarta, më në fund u mund".

Kështu shkruan ky udhëtar për Shqipërinë në shënimet e tij.

1717

LADY MARY WORTLEY MONTAGU

Një zonjë angleze shkruan për Shqipërinë.

"Këta njerëz që jetojnë midis Krishtërimit dhe fesë Muhamedane pa asnjë farë grindje midis tyre, shfaqen krejt të paaftë të gjykojnë se cila fe është më e mire se tjetra"[6].

Ajo ishte e shoqja e Ambasadorit Britanik në Stamboll Eduard Wortley Montagu (1716–1718). Në letrat e saj për shqiptarët që kishte njohur në Stamboll, ajo më datën 1 prill 1717 jep një përshkrim pak kontradiktor. Ajo thotë se nga tërë ato fe që kishte parë, ajo e arnautëve i dukej më e veçanta…

> *"Këta njerëz që jetojnë midis Krishtërimit dhe fesë Muhamedane pa asnjë farë grindje midis tyre, shfaqen krejt të paaftë të gjykojnë se cila fe është më e mirë se tjetra. Ata me shumë kujdes i ndjekin të dyja. Shkojnë në xhami të premten dhe në kishë të dielën, duke besuar se në ditën e gjykimit janë të sigurtë që do të kenë mbrojtjen e profetit të vërtetë, ndonëse për sa kohë që janë në këtë botë, nuk e përcaktojnë*

[6] *Përshkrimet e udhëtimit të tyre në Stamboll dhe vëzhgimet e jetës në Perandorinë Otomane janë fiksuar në kujtimet e shkruara në formë letrash nga Turqia.*

dot drejtimin e duhur. Besoj se në këtë botë nuk ka racë të njerëzimit që të ketë mendim kaq modest rreth vetvetes"[7]

[7]The Letters and Works of Lady Mary Wortley Montagu, *vol. 1 (London: Henry G. Bohn, 1861), pp. 290-291*

1804

WILLIAM MARTIN LEAKE


TRAVELS
IN
THE MOREA.
WITH
A MAP AND PLANS.
BY
WILLIAM MARTIN LEAKE,
F.R.S. ETC.
IN THREE VOLUMES.
VOL. III.
LONDON:
JOHN MURRAY, ALBEMARLE STREET.
MDCCCXXX.

Një dashamirës i pashoq i popullit shqiptar

"Nuk është aq e lehtë të shpjegosh se përse shtetet nganjëherë veprojnë bazuar thjesht në interesat e veta edhe pse ballafaqohemi me luftëra mizore edhe pse politika jonë e tashme është e tillë që të mbështesë perandorinë turke".

Një ndër udhëtarët më të famshëm britanikë dhe ndoshta edhe nga më dashamirësit ndaj shqiptarëve është William Martin Leake.

Ai ka qenë një topograf dhe diplomat (1777-1860). Vepra e tij në katër volume "*Udhëtime në Greqinë Veriore*"[8] botuar në Londër në vitin 1835 tregon për udhëtimet e tij në Jug të Shqipërisë. Udhëtimi i tij i parë në Shqipëri na shpie në vitin 1804 kur ai vizitoi Vlorën, Kaninën, Sarandën, Delvinën, Gjirokastrën, Tepelenën, Kardhiqin, Finiqin, Himarën dhe Ksamilin. Së dyti ai e vizitoi Shqipërinë në vitin 1805, duke kaluar që nga Devolli deri në Apolloni pastaj Këlcyrë e Përmet. Në kapitujt I, II, VII dhe VIII ai merret intensivisht me Shqipërinë. Është për tu theksuar përshkrimi që iu bën zonave të bregdetit tonë jugor që nga Vlora, deri në Himarë e Butrint. Veçanërisht ndalet tek betejat midis Pompeut, i cili arriti aty nga

[8]Leake, William Martin, (1777-1860), *Travels in Northern Greece* Publikuar nga London, J. Rodwell

Candavia në një kohë kur mund të mbronte vetëm Durrahiumin. Më pas vijon me betejën e tij me Qesarin sipas autorit romak Appian. Ai i përshkruan me hollësi rrugët që nga Vlora në Palasë, Himarë e deri përballë Korfuzit në gjendjen e atëhershme, duke shënuar se Himara i jepte edhe emrin vargmalit të Acrocerauniaeve. Më pas përshkruan Porto Palermon, ashtu siç e përshkruan Strabo, si një gji në mes të maleve Ceraunian. Mjaft interesante janë përshkrimet për Sarandën ose Forty Saints (dyzet shenjtët) siç e cilëson autori. Në mes të Sarandës dhe Porto Palermos ku edhe viziton Nivicën, Lukovën dhe Piqerasin prej nga nisen anije të vogla nga gjiu i Onchesmus–it në jug të Palermos, të përshkruara edhe nga Ptolemeu dhe Strabo, por që nën penën e tij kanë ngjyrime po kaq interesante. Ai pohon, duke iu referuar Ciceronit, se ky vend kishte një farë rëndësie në atë kohë. Përshkrimet e Martin Leake janë aq të sakta dhe të detajuara sa vetëm një njeri tepër i vëmendshëm mund të regjistrojë çdo gjë sikundër ka bërë ai. Ai ka përshkuar me detaje tërë udhëtimin e tij në toskërinë shqiptare. Trashëgimia e tij e shkruar jep një pasqyrë të një momenti të rëndësishëm historik të procesit të islamizimit, përpjekjeve për ti rezistuar pushtimit turk dhe veçoritë e natyrës, shoqërisë dhe mjedisit shqiptar.

1809 – 1810

GEORGE GORDON BYRON

Poeti që e bëri Shqipërinë të njohur në botën anglofone

"*Shqipëri, lejomë të kthej syt' e mi mbi ty,*
***O nënë e rreptë burrash t'egër*!"**

Udhëtimet në një vend ekzotik si Shqipëria po shndërroheshin në një farë mode për anglezët, të cilët kërkonin aventura dhe dalje nga një jetë rregullash shumë të forta dhe kodesh të pathyeshme drejt "*lirisë*", ku natyra kishte falur pa kursim ngjyrat, relievet, larminë pakufi brenda territoresh të limituara. Një ndër ta është Lordi Byron, aq i njohur për të gjithë shqiptarët për gjithçka që shkruajti për ne në poemën e tij "*Child Harold",* ku romantizmi dhe ekzaltimet nga natyra rebele shqiptare duket se kanë ndikuar dukshëm në portretet e detajuara. Ishte ajo poemë që e bëri atë të shkëlqente menjëherë pas botimit. Ai e vizitoi jugun e Shqipërisë pothuajse fill pas William Martin Leake. Në letrën e tij dërguar nënës, ai i përshkruan shqiptarët në veshjet e tyre kombëtare si veshja më madhështore në botë. Një kopje e portretit të tij me kostumin kombëtar shqiptar gjëndet e ekspozuar në National Portrait's Gallery në Londër[9] Ai është konsideruar edhe si portreti më i bukur i tërë kohërave i përzgjedhur

[9] Ky portret i Lordit Byron i pikturuar nga Thomas Filips vlerëson poetin e njohur në kostumin tradicional shqiptar. (Foto nga MB në Galerinë Kombëtare të Portreteve, Londër) Byron – i e ka blerë këtë kostum shqiptar në vitin 1809 ndërkohë që po bënte turneun e madh europian bashkë me mikun e tij Xhon Hobhouse (1786 – 1869). Ai ka pozuar me të për këtë portret në vitin 1813, kur ishte njëzet e pesë vjeç.

me të drejtë në atë muze arti. Ai tani është objekt studimi i një filmi dokumentar të BBC – së[10].

Njohja me veprën e Byroni-t dhe veçanërisht me këto dy letra dërguar nënës së tij dhe udhëtarin tjetër Hobhouse përbëjnë një pamje interesante mbi ndërtimin e marrëdhënieve shpirtërore (ende jo diplomatike) midis shqiptarëve dhe anglezëve. Kjo përbën një bazë themelore të njohjes së kombeve tona shumë kohë para se Shqipëria të ribëhej shtet dhe të vendoste marrëdhënie diplomatike me Britaninë e Madhe. Ai vuri një gur të rëndë themeli në historinë tonë me përshkrimet e tij për suliotët, Ali Pashain, shqiptarët trima e të paepur, si dhe vendin që zinin ata në raport me grekët e kohës, etj.

[10] Në fillimin e dhjetorit 2014 kam takuar Profesorin e Universitetit të Kolumbias, Simon Schama, rrëfimtari më i mirë i BBC–së. Profesori më tha, se pas Historisë së hebrejve në BBC po përgatiste një dokumentar me historinë e portreteve. Iu luta atij tw mos harronte nënvizonte faktin se portreti i Byron – it është një kostum popullor shqiptar'. Po ashtu e nxita që të mos harronte të trajtonte edhe portretin e Ali Pashait, themelues i Egjyptit modern, i cili gjendet në Muzeun e Artit Tate Britain në Londër.

1809

JOHN HOBHOUSE



Bashkëudhëtari i Byron - it, autori i qindra faqeve për shqiptarët

***Ai (Ali Pashai – MB) na pyeti: Çfarë ju shtyu të udhëtoni në Shqipëri? I thamë, dëshira për të parë një burrë të zotin me sytë tanë. "Ashtu ë"- na e ktheu ai, "po a keni dëgjuar ju ndonjëherë për mua në Angli?" Ne sigurisht që e siguruam atë se ai ishte një objekt shumë i përhapur bisedash në vendin tonë dhe kjo lajkë duket se i pëlqeu jashtëzakonisht shumë*[11].**

Bashkë me Byron - nin drejt Shqipërisë udhëtoi edhe një anglez tjetër, John Cameron Hobhouse (1786–1869) i njohur si Lord Broughton. Ai përmendet pak tek ne, por vepra e tij është aq e madhe sa përbën një trashëgimi të pashoqe për Shqipërinë. Nga 1150 faqet e librit të tij "*Një udhëtim nëpër Shqipëri dhe provinca të tjera të Turqisë në Europë dhe Azi*

[11] *John Hobhouse* - A Journey through Albania and Other Provinces of Turkey in Europe and Asia to Constantinople during the Years 1809 and 1810*, London 1813.*

deri në Konstandinopul", gjatë viteve 1809 dhe 1810, ai më shumë se gjysmën e volumit ia ka kushtuar Shqipërisë. Në vijim të traditës së Martin Leake, ai jep një përshkrim të mrekullueshëm dhe të detajuar të Shqipërisë. Përshkrimet e tij për Ali Pashë Tepelenën janë aq reale, të detajuara, bindëse. Ai pasqyron influencën dhe forcën e tij ndikuese në atë kohë, duke e konsideruar atë si pasardhës të Pirros së Epirit. Hobhause me librin e tij ka plotësuar një pamje të jashtëzakonshme të Shqipërisë së fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Për një diplomat shqiptar në Britaninë e Madhe, por edhe anasjelltas, një diplomati britanik në Tiranë, ky libër përbën një monument të rëndësishëm në kuptimin sesi inteligjenca angleze e ka përshkruar Shqipërinë e asaj kohe dhe shqiptarët në trojet e tyre etnike.

1812 – 1813

HENRY HOLLAND



TRAVELS

IN

THE IONIAN ISLES,

ALBANIA,

THESSALY, MACEDONIA, &c.

DURING THE YEARS

1812 AND 1813.

BY

HENRY HOLLAND, M.D. F.R.S.

&c. &c.

LONDON:

PRINTED FOR LONGMAN, HURST, REES, ORME, AND BROWN, PATERNOSTER-ROW.

1815.

Mjeku që i bëri "autopsinë" karakterit shqiptar

Udhëtimi në zotërimet e Ali Pashës[12]

"...bazuar në trimërinë dhe guximin e pashoq, shqiptarët kanë emër të madh në hierarkinë e Perandorisë Turke, në More, Egjypt, në Siri, dhe provinca të tjera."

Udhëtimi ynë vazhdon me Sir Henri Holland (1788–1873), një mjek që u diplomua në Edinburg në vitin 1811. Ai i shërbeu Mbretëreshës Viktoria, duke mbajtur edhe detyrën e Presidentit të Institutit Mbretëror të Britanisë së Madhe. Ai ishte një person me një njohje dhe reputacion shumë të lartë në Londër. Me veprën e tij "*Udhëtimet në Ishujt Jonianë, Shqipëri dhe Thesali, Maqedoni etj*"[13], gjatë viteve (1812–1813) jep një pamje reale të

[12] *Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia, etc. during the Years (1812-1813)* (London: Longman, Hurst, Rees, Orme and Broën)

[13] Henry Holland, Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia, Longman, Hurst, 1812, 1813. Published in Rees, Orme and Brown, 1815.

atyre trevave në atë kohë. Në mënyrë të veçantë ai shkruan për takimin e tij me Ali Pashë Tepelenën, si dhe një përshkrim të plotë të udhëtimit të tij që nga Janina në Tepelenë. Nga të gjithë udhëtarët e deriatëhershëm Henry Holland është ai që dallon më mirë veçoritë e shqiptarëve, të cilët "*lidhen prej gjuhës shqipe edhe pse flasin dialekte të ndryshme*", gegë, toskë. Ai e përshkruan me përpikmëri jetën fisnore që nga Kelmendi në veri e deri tek Suli në Jug. Si një njeri me kulturë shumë të gjerë ai hyn deri në gjërat esenciale të popullit shqiptar. Duke u marrë me origjinën e tyre ai iu referohet autorëve si Tacitus, Chardin etj. Është marrë edhe me gjuhën shqipe, influencat latine dhe greke ndaj saj si dhe me emrin dhe origjinën e shqiptarëve. Ai ka vënë re shumë cilësi tonat por edhe disa dobësi në të njëjtën kohë. P.sh: kur flet për ushtrinë e Ali Pashait ai i quan ata ushtarë shqiptarë, por në përshkrimin që iu bën ai thotë:

> *"Karakteri i një ushtari shqiptar është ai i një ushtrie shqiptare. Ata janë thjeshtë një masë burrash, individualisht të fuqishëm dhe trima, por pa organizim dhe as taktika luftarake. Komandantët e tyre është vështirë t'i dallosh sipas rangjeve, pasi kanë marrë poste pa bërë ndonjë stërvitje madje pa kaluar nëpër rrangjet e duhura. Ata i kanë ato grada thjesht bazuar në rastësi dhe nga ndikimi dhe lidhjet personale ose nga reputacioni i fituar prej trimërisë së tyre të jashtëzakonshme. Gjithsesi bazuar në trimërinë dhe guximin e pashoq, shqiptarët kanë emër të madh në hierarkinë e Perandorisë Turke, në More, Egjypt, në Siri, dhe* provinca të tjera*"*

Ato çfarë jep Henry Holland në librin e tij janë një evidencë e pakundërshtueshme e përbërjes së popullsisë në atë kohë. Natyrisht, një diplomat shqiptar nuk mund të hyjë në debate të tilla të përbërjes së popullsisë në një vend fqinj, por mendoj se njohuritë për atë çfarë ka pësuar, përjetuar dhe humbur kombi ynë të dokumentuara nga personalitete të tilla janë mëse të domosdoshme për tu njohur në punën e një diplomati shqiptar. Prandaj dua të citoj një pasazh të veprës së tij:

> *"Dua ta marr lexuesin nëpër ishujt Jonianë, Shqipëri, Thesali, dhe disa pjesë të Maqedonisë, duke skicuar pastaj edhe më shpejt rrugën time nëpër pjesën jugore të Greqisë dhe më në fund të përshkruaj udhëtimin e dytë që kam bërë nëpër dominionet e Ali Pashait. Jam mbështetur gjatë qëndrimit tim kryesisht në qeverinë e atyshme dhe në mënyrë të veçantë në karakterin e jashtëzakonshëm të këtij sunduesi modern të*

Shqipërisë, me të cilin unë kam patur privilegjin e veçantë të njihesha nga afër"[14].

[14] Thomas Smart Huges – Travels in Greece and Albania, faqe 100 London, Henry Colburn and Richard Bently, New Berlington Street, 1830

1813

THOMAS SMART HUGHES



TRAVELS

IN

SICILY GREECE AND ALBANIA

IN THE

REV. THOS. SMART HUGHES

ILLUSTRATED WITH

ENGRAVINGS OF MAPS SCENERY PLANS &c.

IN TWO VOLUMES

VOL. I.

LONDON

PRINTED FOR J. MAWMAN 39 LUDGATE STREET.

1820.

15

Studiuesi i pasurisë shpirtërore të shqiptarëve

Udhëtime në Siçili, Greqi dhe Shqipëri

Thomas Smart Hughes, është tjetër udhëtar i famshëm që na sjell një pamje të përafërt me atë të Henry Holland, por në të njëjtën kohë edhe të ndryshme të Shqipërisë së "*Veriut*", siç e quan ai pjesën veriore të trojeve shqiptare që tani janë nën Greqinë. Thomas Smart Hughes ishte një studiues, historian, shkrimtar, përshkrues udhëtimesh. Ai ishte diplomuar në Cambridge në vitin 1812. Udhëtoi si kujdestar i një pasaniku të ri të quajtur Robert Tounley Parker (1793–1879). Për rreth dy vjet të dy këta zotërinj udhëtuan së bashku në ato vende prej nga doli edhe libri "*Udhëtime në Siçili, Greqi dhe Shqipëri*", i cili u botua në vitin 1820 dhe u ribotua i ilustruar me pikturat e Charles Robert Cockerell. Libri ka 1200 faqe. Në këtë libër me përshkrime rreth Shqipërisë së Jugut jo vetëm një studiues i zellshëm, por çdo lexues shqiptar dhe i huaj, nëse i intereson, mund të

[15] Travels in Sicily, Greece and Albania, Book digitalized by Google from the library of Oxford University.

"*shëtisë*" pa ndrojtje nëpër të gjitha fshatrat, qytezat dhe qytetet e Shqipërisë. Është një pasuri aq e madhe e një bukurie përshkruese që të mahnit me të dhënat e pafundme të toponimisë, terrenit, folklorit, traditave, gjuhës si dhe përbërjes së popullsisë, në zona shqiptare, të cilat janë edhe sot të popullara prej shqiptarësh, por edhe në ato që tashmë janë çpopulluar.

1814

CHARLES COCKERELL

Arkitekti i Katedrales së Shën Palit dhe Kryearkitekti i Mbretëreshës Viktoria

Travels in Southern Europe

"Pamja natyrore, megjithëse nuk është aq e bukur sa duhet në dimër, është mëse e bukur dhe banorët janë një race e mrekullueshme – jo aq të pashëm por të guximshëm dhe energjikë".

Charles Cockerell (1788–1863) ka qenë drejtuesi i punimeve arkitekturore të Katedrales së Shën Palit në Londër, President i Institutit Mbretëror të Arkitektëve Britanikë dhe një ndër arkitektët e stilit gjeorgjian të Londrës. E megjithatë ai i kushtoi udhëtimeve plot 7 vjet nga viti (1810-1817) në vende të ndryshme përfshirë edhe Shqipërinë. Shënimet e udhëtimit të tij u botuan në vitin 1903. Midis përshkrimeve të tij më të bukura është ky i mëposhtmi:

"Artistikisht nuk di të kem fituar aq shumë, por nuk më vjen keq për kohën që kalova në Shqipëri. Pamja natyrore megjithëse nuk është aq e bukur sa duhet në dimër, prapëseprapë është mëse e bukur dhe banorët janë një racë e mrekullueshme – jo aq të pashëm, por të guximshëm dhe energjikë. Me një thikë, një pistoletë në brez dhe pushkën në krah shqiptari fle fare mirë në qiell të hapur me kokën e vendosur mbi një gur dhe me xhaketën mbi fytyrë. Sa për Ali Pashain, ai do të kujtohet për atë që arriti, duke qetësuar vendin nga gjendja kaotike, ndërtoi rrugë, fortifikoi kufijtë, vuri nën zap kusarinë dhe e bëri Shqipërinë një fuqi të njëfarë rëndësie në Europë".

1830

BENJAMIN DISRAELI

Ideologu i Torit dhe dy herë Kryeministër i Britanisë së Madhe viziton Shqipërinë.

Midis gjithë udhëtarëve që kanë udhëtuar nëpër Shqipëri, njëri prej tyre është ndoshta më interesanti për nga rëndësia. Ai ishte Benjamin Dizraeli, dy herë kryeministër i Britanisë së Madhe gjatë epokës së Mbretëreshës Viktoria. Siç kishte edhe emrin, ai njihet si benjamini i kësaj të fundit. Herën e parë ai qeverisi vetëm për 9 muaj, nga shkurti deri në dhjetor të vitit 1868, ndërsa herën e dytë për 6 vjet, nga shkurti 1874 deri në prill 1880. Në vitin 1830, ai ndërmori një udhëtim, i cili zgjati 17 muaj nga Malta deri në Shqipëri. Në letrën e parë që ai i shkruan të atit i drejtohet me këto fjalë:

"I dashur baba.
…Të përmenda në letrën time se ka mundësi që të bëj një vizitë tek Veziri i Madh në Janinë, në kryeqytetin e Shqipërisë".

Të jetë vizituar Shqipëria e atëherëshme nga një kryeministër i ardhshëm britanik, sigurisht që sot mund të shihet si një ngjarje e madhe e asaj kohe, pavarësisht se në kohën e udhëtimit ai ishte thjesht një djalë që kërkonte aventura në vende ekzotike, larg Londrës së tij të zhurmshme.

Benjamin Dizraeli vizitoi Artën dhe Janinën, këtë të fundit duke e cilësuar edhe kryeqyteti i Shqipërisë. Letrat e tij, dërguar babait janë të mbushura me plot informacion për Shqipërinë e asaj kohe. Në fakt është interesant të shënohet se të gjithë udhëtarët britanikë që kanë kaluar në viset jugore të Shqipërisë deri në Janinë e Prevezë dhe Artë i referohen vendit tonë si Shqipëria dhe jo si një Provincë Osmane. Por ajo që citon Dizraeli është shumë më e rëndësishme dhe një referencë historiografike me vlerë. Dizraeli ishte Kryeministri britanik në kohën e Kongresit të Berlinit, një ngjarje pasojat e të cilit dihen mirë.

Si një intelektual i klasit të parë, Disraeli ka shkruar njëzet e tre libra. Ka shumë biografë, të cilët janë marrë me jetën dhe veprimtarinë e tij. Ndër ta është Dauglas Hurd, Sekretari i Jashtëm britanik nga viti 1989 deri në vitin 1995.[16]

Robert Blake e ka trajtuar atë gjerësisht.[17] Në librin e yij Blake na jep një pamje të pakëndshme të këtij britaniku të madh me gjak hebre, i prirur për të qenë palë me pushtuesit dhe jo me të pushtuarit. Si njeri që do të merrte frenat e një shteti perandorak, ai në një moment të caktuar kërkon të renditet në radhët e forcave turke për të luftuar kundër shqiptarëve kryengritës ndaj Perandorisë Osmane, në fillimin e viteve 1830. Në të njëjtën mënyrë ai shprehu antipati ndaj grekëve, të cilët kërkonin shkëputjen nga osmanët. Atë e dominonte më shumë pikpamja e tij perandorake sesa ajo e krishterë, ndonëse vetë ai ishte një hebre i konvertuar i krishterë që në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare.

Si një nga figurat qëndrore të politikës britanike të shekullit të nëntëmbëdhjetë, është interesant të shihet se me çfarë syri i ka parë ai shqiptarët. Po ashtu është me mjaft interes të shohësh që dy vjet pas kthimit nga udhëtimi në Shqipëri ai shkruajti një vepër për Skënderbeun të quajtur "*The rise of Iskander*".[18] Kjo është një vepër letrare që ka në qendër Skënderbeun, por megjithatë ai nuk i jep identitetin e duhur atij, ndërsa ngjarjen e vendos në Athinë dhe në Hungari. Disraeli është njeriu që polemizoi më fort në parlamentin britanik dhe ka po ashtu numrin më të madh të thënieve të cituara në historinë e politikës britanike. Një ndër

[16] Me këtë autor kam patur rastin të bisedoj për librin e tij që sapo e kisha lexuar si dhe për Dizraelin dhe Shqipërinë. Dauglas Hurd ka luajtur një rol të rëndësishëm në rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike Shqipëri – Mbretëri e Bashkuar. Në një rast tjetër, gjatë takimit që Ministrja jonë e Integrimit pati me të z. David Lidington, Ministër i Zgjerimit Europian në Foreing Office, patëm rastin të flisnim për Dizraelin. Ai mbante në zyrën e tij portretin e Benjamin Dizraelit. Kur mbaruam takimin e pyeta:

- A është Dizraeli idhulli juaj politik?
- Po, më tha, - është.
- Nuk ka politikan më të sofistikuar se ai.

[17] Robert Blake, Dizraeli, faqe 60, 64-65, 579.

[18] Rise of Iskander – Benjamin Disraeli – University of Adelajde – botuar për herë të parë në vitin 1834.

thëniet e tij më cinike ndaj rivalit të jetës së tij Gladstone, po ashtu kryeministër i alternuar i laburistëve, ishte ndryshimi i inicialeve: GOM që do të thoshte, *Grand Old Man*, - Plaku i Madh në *"God's Only Mistake"*, ose i Vetmi Gabim i Zotit. Kjo fjalë ka mbetur si shenjë kulmore e debatit politik midis kryeministrit me atë të liderit të opozitës, në parlamentin britanik.

Në turin e tij në Shqipërinë e Jugut Dizraeli shoqërohet nga shqiptarët që e mbrojnë atë. Ai i përshkruan ata si më poshtë:

> *"Tërë këta shqiptarë janë të armatosur deri në dhëmbë, me kama, pistoleta dhe pushkë krejt të mbuluara me zbukurime të pasura, dhe nganjëherë tërësisht të lara në argjend deri tek qyta".*

Duhet pranuar se për shkak të mentalitetit të politikës perandorake Viktoriane, madje edhe një benjamin i saj, pra pikërisht ky politikan britanik, kur mund të kishte në dorë të ndihmonte Shqipërinë në Kongresin e Berlinit, pasi nuk tregoi ndonjë dëshirë për ta bërë këtë. Ai pranoi të linte në fuqi Traktatin e Shën Stefanit, i cili kishte shkëputur nga trungu shqiptar pjesë të rëndësishme të territorit shqiptar. Arsyet? Letra që shqiptarët i dërguan Benjamin Dizraelit, që është pjesë e këtij libri, mund të merret si një shembull konkret për këtë. Megjithatë, duhet thënë se pa kontributin e tij, lakmitë e fqinjëve për coptim edhe më të madh të trojeve shqiptare, mund të kishin rezultuar në humbje edhe më të mëdha të territoreve tona, se ato që kanë ndodhur.

1831

DAVID URQUHART


THE

SPIRIT OF THE EAST,

ILLUSTRATED IN A

JOURNAL OF TRAVELS

THROUGH ROUMELI

DURING AN EVENTFUL PERIOD.

BY

D. URQUHART, Esq.

AUTHOR OF

"TURKEY AND ITS RESOURCES," "ENGLAND, FRANCE, RUSSIA, AND TURKEY," &c.

"Men are not influenced by Facts, but by Opinions respecting Facts."—Edmund Burke.

IN TWO VOLUMES.

VOL. II.

LONDON:

HENRY COLBURN, PUBLISHER,

GREAT MARLBOROUGH STREET.

1838.

Një vajtim për shqiptarët: Shpirti i Lindjes

Në vitin 1831 një udhëtar tjetër i quajtur David Urquhart (1805–1877) vizitoi Shqipërinë. Ai ishte politikan skocez, dhe kishte shërbyer edhe si sekretar i ambasadës britanike në Stamboll. Nga viti 1847 deri në vitin 1952 shërbeu si anëtar i parlamentit britanik. Ai ka shkruar librin "*Shpirti i Lindjes*"[19]. Në vitin 1831 kaloi nga Korfuzi në Sarandë dhe vizitoi Sarandën, Gjirokastrën, Tepelenën, Beratin, Kavajën. Ai e humbi rrugën pranë lumit Erzen, por u shpëtua nga një çoban vllah, duke i mundësuar vazhdimin e rrugëtimit të tij drejt Durrësit dhe Shkodrës. Përshkrimet e tij tregojnë një Shqipëri të molisur nën peshën e një Perandorie Osmane të kalbur. Ai shkruan siç vijon:

> *"I pashë shqiptarët në gjendjen e tyre më të egër, dhe në ditët e tyre më të liga; Tani i shoh në një gjendje poshtërimi, e cila shpresoj se është kalimtare. Nëse do ta vizitoj ndonjëherë tjetër vendin e tyre të bukur, ndoshta do të kaloj sipër tarracave dhe rrugëve, në mes të paqes dhe qetësisë së një peizazhi të formuar me fusha dhe gardhe larg zhurmës së luftës dhe alarmeve, të zëvendësuara prej industrisë dhe prodhimit vendas nga pasuritë e këtij vendi. Është e vërtetë se tani ekziston një*

[19] David Ulquhart – The spirit of the East, Journal of Travelers through Roumeli during an eventful period, autor of the Turkey and its Resourcies – England, France, Russia, and Turkey. Volumi I, Henry Colburn Publisher, Great Mariborough Street, 1838.

qetësi, por kjo është qetësi e frikës; Siguria që gëzova ishte një siguri e blerë në një pazarllëk të bërë me sunduesit."

"Shpirti i shqiptarëve është i vrarë; çdo individ i këtij kombi është një qënie e transformuar dhe siç të thonë ata vetë: … "zemrat e tyre janë ftohur dhe buzët iu janë tharë."

Çfarë përshkrimi i dhimbshëm për kombin tonë në ato ditë të errëta osmane nga një udhëtar skocez! Por le të vazhdojmë më tej me përshkrimin e tij:

Në Kavajë ai vëren dallimin midis kostumeve të jugut dhe atyre të gegërisë.

"Gegët kanë kostume të ndryshme nga toskët. Ata veshin fustanella të gjera dhe të gjata ndërkohë që xhaketa e shkurtër e jugut është e zgjatur deri sa të mbulojë fustanellën…Unë kurrë nuk kam parë diçka më të bukur se fëmjiët e tyre kur bëhen së bashku. Këto krijesa të vogla veshin, në miniaturë, rrobat e më të rriturve të tyre dhe e kuqja e tyre e ëmbël e faqeve i shkon shumë për shtat ngjyrës, e cila tejkalon çdo gjë tjetër në kostumet e tyre".

Në udhëtimin e tij nga Kavaja në Durrës, David Urquant humbet rrugën, por ai nuk harron të kujtojë se kjo mund t'i kishte ndodhur edhe Perandorit Commene në atë natë që erdhi fill pas betejës së paharrueshme të Durrësit kur ushtaria perandorake e përbërë prej grekësh, turqish, çekrezësh dhe anglezësh ishte shpartalluar dhe shpërndarë nën valën e heshtave të Robert Guiscard – it dhe Normanëve të tij.

"Durrahium është qyteti më i lashtë dhe më i fuqishëm i qyteteve detare të Ilirisë, i fortifikuar prej natyrës dhe i pasqyruar si i pathyeshëm prej artit. Aty ka porta me hapësira më të mëdha dhe të sigurta – fusha të gjera nga më pjelloret. Këtu ka ndërtesa të shenjtëruara, tempuj madhështorë dhe të kushtueshëm – këtu mund të shihen imazhet e mbretërve dhe të perandorëve të princave të lashtë. Colossus (Colossus ingens) i Hadrianit (perandor romak – shënim) i metalit të hedhur qëndron në një pozicion kryelartë në Portën e Kavajës. Në perëndim gjëndet një arenë amfiteatri e ndërtuar me art dhe bukuri të mrekullueshme dhe mure të përforcuara dhe zbukuruara me kulla dhe të përshtatshme për tregëti. Ky është Durrësi që kishte pritur vetë senatin Romak. Çfarë qyteti i madhërishëm ka qenë ai – ipsa ruina docet" Por rrënojat e tij tani kanë pushuar së treguari atë madhështi".

Më tej David Urquhart na jep një përshkrim të Mehmet Ali Pashës, influencën shqiptare në shtetin e Egjyptit dhe në Siri dhe se me çfarë merrej diplomacia angleze. Ai e vazhdon udhëtimin për në Shkodër dhe shpjegon pashallëkun e Bushatllinjëve dhe përbërjen e popullsisë në atë qytet.

1834

ROBERT CURZON

Shqiptarët, njerëzit e dhënë pas armëve të zbukuruara

Nëpër Shqipëri në udhëtim për në Meteora.

Studiuesi dhe aristokrati Robert Curzon (1810–1873) në udhëtimet e tij kaloi edhe nëpër Shqipëri ku vizitoi Paramithinë dhe Janinën, të cilën, ashtu si udhëtarët e tjerë e quan kryeqytetin e Shqipërisë. Përshtypjet e tij janë botuar në librin "*Vizitat në Manastiret në Levant*".[20] Shumë prej udhëtarëve anglezë e nisin udhëtimin e tyre nga Korfuzi. Edhe Robert Curzon e nis aty dhe arrin më pas në Berat. Ai na ka dhënë përshkrime të mrekullueshme të oborrit të Vezirit, si dhe mjaft përshkrime të natyrës dhe njerëzve. Ajo që tërheq më së shumti vëmendjen e tij është armëmbajtja e shqiptarëve:

> *"Shqiptarët janë të dhënë shumë pas armëve të tyre. Këllëfi i jataganit të tyre dhe dorezat e pistoletave janë thuajse përherë prej argjendi sikundër që janë edhe tre ose katër vezmet e fishekëve, të cilat janë shpesh të praruara dhe nganjëherë edhe me korale".*[21]

[20] Title: Visits To Monasteries in the Levant

[21] *Robert Curzon:* Visits to Monasteries in the Levant, *London 1849, reprinted as:* Visits to Monasteries in the Levant. *Introduction by John Julius Norëich. London: Century 1983, p. 254 271.]*

1848

EDWARD LEAR

Artisti shumë dimensional që e fiksoi Shqipërinë në telajo

Është vështirë të mendohet se ka ndonjë shqiptar që mos të ketë dijeni për Edward Lear. Ai e vizitoi Shqipërinë në vitin 1848 dhe është i njohur për shqiptarët falë pikturave të tij të bukura që krijoi me subjekte të natyrës dhe jetës shqiptare. Shënimet e Edward Lear për Shqipërinë janë gjithashtu të njohura nga publiku shqiptar. Madje ato janë nga më të përmendurat. As shkrimet për Lirin nuk kanë munguar. Për figurën e Lirit ka shkruar akademiku ynë i njohur Ferit Hudhri.

Edward Lear arriti në Manastir me datën 20 shtator të vitit 1848 i shoqëruar prej një udhërrëfyesi të quajtur Giorgio. Prej aty ata vazhduan për në Ohër, Strugë, Elbasan, Tiranë, Krujë, Lezhë dhe Shkodër ku arritën aty me datën 2 tetor. Pas disa ditësh atje, ata u kthyen në Tiranë dhe vazhduan drejt jugut nëpër Kavajë, Berat, Ardenicë, Apolloni, Vlorë dhe drejt bregdetit himariot, Tepelenë, Gjirokastër dhe Janinë. Këto udhëtime janë botuar nga Bejtulla Destani dhe Robert Elsie në librin *"Eduard Lir në Shqipëri*" në Londër 2008. Në hyrjen e librit editorët na japin një pasqyrë të qartë të asaj që shkruan Edward Lear për Shqipërinë, duke iu referuar historianit britanik Edward Gibbon (1737-1794):

"Si etnitet gjeografik e kulturor, Shqipëria ka qenë gjithmonë diçka enigmatike dhe e keqkuptuar. Në shekullin e tetëmbëdhjetë ai e përshkruan atë si një tokë që shihet me sy nga Italia, por që është më pak e njohur se Afrika e brendshme."

"Unë po ikja mjaft i kënaqur dhe i lumtur nga Tirana. Në shtegkalimet e gjera të gjelbëra, ose rrugët që të çonin drejt veriut, nëpërmjet një lugine të gjerë poshtë vargut lindor të maleve madhështore, në njërin prej të cilëve, në një lartësi të madhe nga fusha qëndron madhështore Kruja. Ajo një herë e një kohë ishte prita Skënderbejane që iu bënte ballë turqëve pushtues. Pa dyshim për shkak të interesit tim rreth historisë, isha dyfish në ankth për ta vizituar atë, duke pritur që të shihja bukuri të pafund."

njihesh më shënimet e udhëtimit të Edward Lear është një ekskursion shumë i bukur ngjyrash dhe peisazhesh, por edhe një ekskursion intelektual për njohjen e vendit tonë. Në veçanti, përshkrimet e një zone të Shqipërisë që rrethon Himarën na japin sot përgjigjen e shumë pikëpyetjeve të ngritura nga qarqe të caktuara e që për diplomatët janë një burim i sigurtë, i pakontestueshëm, i vërtetë, i paanshëm dhe serioz njohjeje edhe historiografie. Por Edward Lear nuk është vetëm një prej atyre që i kanë dhënë përgjigje pyetjes se cfarë popullsie jeton në brigjet tona joniane por ka vërtetuar pikpyetje të tilla me fakte reale përmes tablove të tij natyraliste.[22]

[22] Ambasada shqiptare në Londër, në nderim të këtij udhëtari të famshëm dhe artisti të madh, organizoi një ngjarje memoriale ku në sallën e quajtur "*12 Yjet*" në Europe House në Londër hapi ekspozitën e piktorit tonë të njohur Bashkim Izano Ahmetaj me përmbajtje: "*Homazh kushtuar Eduard Learit*", më datën 28 maj 2015.

1848

JAMES HENRY SKEENE

"Ishte Ptolemeu, gjeografi i parë prej autorëve antikë që i ka përshkruar shqiparët antikë me emrin e veçantë, Ilirët".

Shqiptarët [23]

"Shqiptarët krahasohen me malësorët e Skocisë prej një shkrimtari (Urquhart), i cili është i njohur shumë mirë me gjendjen e tyre të sotme, me karakterin dhe zakonet, si dhe veshjen dhe pamjen e jashtme, dhe sigurisht kanë një ngjashmëri të dyanëshme shumë të fortë. Të gjallë dhe të guximshëm, të ashpër dhe të lirë ata mund të bëhen këmbësoria e lehtë më e mirë në botë; dhe në fakt rrangjet e ushtrisë turke janë thjesht të ndërvarura prej tyre për atë degë të ushtrisë së tyre."

Udhëtari skocez, Sir Xhejms Henry Skene ka shërbyer si konsull në Aleppo nga viti 1855, për më shumë se njëzet vjet, deri në vitin 1877. Ai ka treguar interes për shqiptarët, duke i botuar vlerësimet e tij në Edinburg, *"New Philosophical Journal"* në vitin 1849 dhe *"Journal of the Ethnological Society of London"* në vitin 1850. Këtu gjenden disa fragmente nga vlerësimet e tij për shqiptarët:

"Ka dallime kryesore midis banorëve të provincave greke, të cilat ende formojnë një pjesë të Perandorisë Turke. Të parët janë osmanët, me gjak të pastër aziatik; pastaj vijnë grekët të ndryshëm në racë dhe në fe; të tretët, të cilët përbëjnë kombin shqiptar janë krejt të ndryshëm si prej njerës ashtu edhe prej tjetrës, sa i takon origjinës dhe prejardhjes. Ndërkohë ajo është e ndarë midis dy sekteve fetare, të cilave ata i takojnë. Në zakone, pamje, karakter dhe gjuhë, shqiptarët janë gjithashtu përjashtimisht të ndryshëm si nga grekët ashtu edhe nga turqit. Nga ana fetare ata janë pjesërisht me të krishterët dhe pjesërisht me muhamedanët. Këto tri raca tani jetojnë në kontakte të afërta me njëra-tjetrën. Ata janë në mosmarrëveshje aq të mëdha në çdo gjë që ka të bëjë me interesa të vogla të përbashkëta, sa që një ndryshim i madh politik mund të sjellë një përafrim të ndjenjave midis tyre".

[23]Henry Skene: *The Albanians*: *Edinburgh New Philosophical Journal* (1849), p. 307-329, and in: *Journal of the Ethnological Society of London*, papers from vol. 1, 2 (1850), p. 159-181.

Sir James Henry Skeene i përcakton shqiptarët të ndarë në katër krahina kryesore: Gegët dhe mirditorët, toskët, çamët, labët. Gegët kanë gëzuar për një kohë të gjatë pavarësi më të madhe nën pashallëkun e Shkodrës, madje edhe më shumë se çdo fis tjetër shqiptar.

"Ata janë njësoj ushtarë të mirë dhe kanë ruajtur më shumë prej kokëfortësisë së tyre natyrore edhe prej faktit se kanë qenë më pak të arritshëm prej turqëve. Vendi i tyre shtrihet nga kufiri i territorit austriak i Kataros përreth Malit të Zi, i cili mund të konsiderohet një shtet i pavarur, me vijimin e kreshtave, të cilat bashkojnë Malin Scardus, arrin në Hercegovinë, ndërkohë që kufizohet në jug prej lumit Drini. Shkodra ose Scutari si qyteti kryesor, Dulqinjo (Ulqini), Alessio (Lezha) dhe Durazzo i takojnë atyre".

Më pas ai vazhdon me shpjegime për toskët, labët dhe çamët duke dhënë karakteristikat e secilit prej tyre. Por ajo që është interesante është historia e lashtë e shqiptarëve, siç e sheh ai atë:

"Përmendja e parë e shqiptarëve prej historianëve bizantinë, megjithëse në mënyrë të përciptë dhe jo perfekt, i tregon ata ashtu siç janë edhe sot. Është Ptolemeu, gjeografi, i cili është i pari prej autorëve antikë që i ka vënë re ata dhe i përshkruan me emrin e veçantë Illyria. Anna Comnena bën aluzionin tjetër për ta. Historia hesht për këtë popull gjatë dhjetë shekujve. Por na del se ata ishin të njohur në një periudhë shumë më të largët sepse Dion Cassino, kur rendit pushtimet romake lë të kuptohet që ai dinte shumë për një Shqipëri tjetër".

Prandaj, thotë ky autor, studimi i këtyre fiseve është më interesanti. Ky studim është pothuajse një nismë për të parë brenda zakoneve dhe kushteve të një kombi, të një kohe të kaluar, ndërkohë që mbetet shumë për të mësuar, madje edhe për pamjen e tyre të jashtme fizike. Kjo është mbështetur edhe prej anglezëve më të mësuar dhe intelegjent, i cili i ka parë këta njerëz me vëmendje.

Më pas, Sir James Henry Skeene citon Dr. Hughes:

"Tiparët e shqiptarit, balli i ngushtë, sytë e tij të mprehtë gri, goja e vogël, vetullat e holla harkore, mollëzat e ngritura, mjekra majuce, tregojnë fuqishëm një fizionomi skythiane".

Është e pamundur të vendoset krejt dhe plotësisht ajo çfarë Skeens shkruan për ne shqiptarët dhe historinë tonë. Por dy gjëra duhen nënvizuar: E para, ai na kushton një vëmendje të jashtëzakonshme, duke dhënë aq shumë teza dhe kundra teza dhe, së dyti, përmend aq shumë fakte, të cilat janë shumë pak të njohura për ne shqiptarët dhe akoma më pak për botën. Ja një prej tyre:

> *"Kjo, është thuajse krejt çfarë është e njohur rreth historisë së shqiptarëve dhe megjithëse ajo është aq e sigurtë dhe e paqartë, prapëseprapë shumë heronj të kësaj race janë ngjitur deri në atë pikë sa të stolisin faqet e historisë. Më i pari është Skënderbeu, e më pas vjen Balsha dhe Shpata. Aty gjendet Ali Pasha i vendit të sotëm dhe në të kaluarën Ghalil ose Patrona[24]. Ky i fundit papritmas drejtoi një revolucion, i cili tronditi kryeqytetin e perandorisë në vitin 1730, duke u bërë drejtuesi i padiskutueshëm i Konstandinopulit, siç na e tregon atë Lordi Sanduich".*

[24] Patrona Halil ka lindur në Manastir në vitin 1690 dhe ka vdekur më 25 nëntor 1730, në Stamboll. Ai udhëhoqi një kryengritje, e cila arriti të rrëzonte Sulltan Ahmetin e III–të dhe të sillte në fuqi Sulltan Mahmutin e I–rë. Ai kishte lindur në një familje shqiptare në Hurpisht, një fshat afër Manastirit. Ai u muar jeniçer dhe, duke qenë aty udhëhoqi një rrebelim që filloi në Nish në vitin 1720 dhe më pas përparoi drejt kryeqytetit osman. Ai njihej si Arnauti Horpeshteli, por bashkëvendasit e tij shqiptarë e thërrisnin Patrona, ose zëvendës admiral, për shkak të aktivitetit të tij si detar. Nën komandën e tij, 12000 jeniçerë, shumica shqiptarë, e morën kryeqytetin e perandorisë në duart e tyre për disa javë. Khani i Krimesë e ndihmoi Vezirin e Madh për të shtypur rebelimin. Patrona u ekzekutua në prani të sulltanit që vetë e kishte sjellë në fuqi bashkë me 7000 pasonjësit e tij shqiptarë. Sulltani u zëvendësua, por Patrona e pagoi me jetë të mirën që i bëri bashkë me mijëra shqiptarët e tij.

1850

EDMUND SPENCER


TRAVELS
IN
EUROPEAN TURKEY,
IN 1850,
THROUGH BOSNIA, SERVIA, BULGARIA, MACEDONIA, THRACE, ALBANIA, AND EPIRUS; WITH A VISIT TO GREECE AND THE IONIAN ISLES.
AND
A HOMEWARD TOUR THROUGH HUNGARY AND THE SLAVONIAN PROVINCES OF AUSTRIA ON THE LOWER DANUBE.
BY EDMUND SPENCER, ESQ.
IN TWO VOLUMES.
VOL. II.
LONDON:
COLBURN AND CO., PUBLISHERS,
13, GREAT MARLBOROUGH STREET.
1851.

"Mon lac est le premier lac du monde"[25]
Një udhëtim nga Ohri në Janinë

"Pavarësisht kryengritjeve të vazhdueshme të këtyre fiseve luftarake të Shqipërisë dhe trimërisë së tyre të dalldisur, ata rrallë ia kanë dalë të përfitojnë ndonjë përparësi të madhe ndaj armiqëve të tyre të vjetër, osmanllinjëve..."[26]

Kapiteni Edmund Spencer ka qenë një shkrimtar dhe udhëtar britanik i mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ai ka udhëtuar shumë nëpër vende të ndryshme si; Gjermania, Hungaria, Polonia, Zvicra, etj. Po kështu ky eksplorator ndërmori një udhëtim në Ballkanin Perëndimor në vitin 1850, të cilin e përshkroi në librin e tij "*Udhëtim në Turqinë Europiane, nëpër Bosnje, Serbi, Bullgari, Maqedoni Trakë, Shqipëri dhe Epir me një vizitë në*

[25] Volter: Poema daton atëherë kur Volteri jetonte në Zvicër në vitin 1755 dhe do të thotë:
– Liqeni im, është liqeni më i madh në botë. Spenseri e krahason Liqenin e Ohrit me atë të Gjenevës.
[26] *Edmund Spencer: Travels in European Turkey in 1850, through Bosnia, Serbia, Bulgaria, Macedonia, Thrace, Albania, and Epirus, with a visit to Greece and the Ionian Isles, and a homeward tour through Hungary and the Slavonian Provinces of Austria on the Lower Danube. Volume 2 (London: Colburn and Co., 1851), pp. 80-176.*

Greqi dhe Ishujt Jonianë". Ai e nisi udhëtimin nëpër Shqipëri nga Ohri me kalë ose në këmbë për në Mirditë, Elbasan, Krujë, Shkodër dhe deri në Kotorr. Më pas ai u kthye në Elbasan, duke vijuar drejt Beratit, Përmetit dhe Janinës.

Me të hyrë në Ohër Edmund Spenser habitet nga liqeni dhe thotë se po ta kishte parë Volteri Liqenin e Ohrit, nuk do të kishte shkruar atë që shkroi për Liqenin e Gjenevës: "*Mon lac est le premier lac du monde*". Kështu e fillon ai udhëtimin e tij, duke na dhënë përshkrime të mahnitëshme të natyrës, por edhe gjendjen e mjeruar në shumë zona të veri – lindjes së Shqipërisë, të cilat ai i sheh sikur i ka rrënuar tërmeti. Spenser kalon në Strugë dhe ndjek rrjedhën e Lumit Drini i Zi. Në përshkrimet e tij gjen kontraditat e kohës që ezkistonin midis shqiptarëve të asaj kohe. Për të kuptuar këtë le të ndjekim pasazhin e mëposhtëm kur ai kalon Shkumbinin, duke lënë prapa Gegërinë në Elbasan, për të kaluar në jugun e Shqipërisë.

> "*Pavarësisht kryengritjeve të vazhdueshme të këtyre fiseve luftarake të Shqipërisë dhe trimërisë së tyre të dalldisur, ata rrallë ia kanë dalë të përfitojnë ndonjë përparësi të madhe ndaj armiqve të tyre të vjetër, osmanëve. Por, edhe nëse do të emancipoheshin dot, kam frikë se vendi do të bëhet pre e tmerrit të një lufte civile, si rrjedhojë e rivalitetit të besimeve dhe armiqësive midis fiseve. Ne na duhet të lemë Elbasanin dhe të kalojmë nëpër njërin prej maleve drejt jugut, ku do të takojmë fiset e Toskërisë, njësoj të përçarë prej feve – një pjesë e tyre Muhamedanë dhe pjesa tjetër të dhënë pas ritualeve greke. E njëjta gjë mund të thuhet për fiset Çame që banojnë në pjesën e Epirit të lashtë dhe Labëve në malet e Acroceraunianeve në bregdet. Këto nuk janë të vetmet fise që e dinë Shqipërinë për shtëpi të tyre; Zanzarët mëndjemprehtë dhe bullgarët e ashpër po rriten në numër dhe ndikim; përveç këtyre gjejmë grekë helenikë, armenë, hebrej dhe evgjitë që formojnë një përzierje kaq të madhe gjuhësh sa po tua shtosh edhe rivalitetit midis fiseve dhe besimeve, pengojnë seriozisht perspektivën e ndonjë bashkimi të interesave në ditët e sotme".*

Vepra e Edmund Spenser jep pasqyrën më të qartë të kontradiktave midis shqiptarëve myslimanë, katolikë, ortodoksë, gegë, toskë, lab, çam në dekadat e para të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Qeverisja e osmanllinjve në Shqipëri sipas Spenser lehtësohej nga pranimi i një politike të njohur imperiale "*përça e sundo*", duke bërë përgjegjës më shumë se askënd tjetër pashallarët e pashallëqeve të mëdha, si ai i Shkodrës dhe i Janinës. Një ndër momentet më tragjike që Spenser përmend, është eleminimi i të gjithë krerëve të botës shqiptare të asaj kohe, të të gjitha rrangjeve, me përjashtim

atë të Shkodrës, në Masakrën e Manastirit[27]. Naiviteti, përçarja, dëshira për pushtet, tradhëtia, gatishmëria për ti shërbyer të huajve, solli në atë që është masakra më e pashembullt që ndonjë popull ka përjetuar, jo vetëm nën Perandorinë Osmane, por në të gjitha kohërat. A ka një shembull tjetër ku në një moment të historisë, në një ditë të vetme, të zhduket brenda një ore e tërë elita politike, tërë drejtuesit fisnorë, tërë njerëzit e pasur të një populli?! Në planin e njohurive të një diplomati, ato që shkruan Spenser, duhen parë si material, të cilat kanë ndikuar tek politika dhe diplomacia britanike ndaj nesh, në mënyrën se si ata na kanë parë, vlerësuar, dhe për pasojë përpiluar politikën e tyre ndaj nesh.

Analiza që Edmund Spencer i ka bërë shoqërisë shqiptare të asaj kohe, jo vetëm në nderim të vlerave të padiskutueshme të kombit tonë, por edhe në kritikën e ashpër ndaj qëndrimeve të përçara ndaj çështjes së madhe kombëtare, janë dokumente që na bëjnë të mendohemi se përse këto cilësi reflektohen edhe sot e kësaj dite. Pra në këtë aspekt ajo mbetet aktuale, e rëndësishme dhe, duhet parë me kujdes dhe vëmendje, si vërejtje e një njeriu që merr shënim për çdo gjë ka ndodhur pa paragjykuar, por me një gjykim, të cilin na e lë neve sipas këndeve tona të trajtimit të fakteve të shumta të parashtruara prej tij. Na e lë ne gjykimin, jo për veprën e tij, por për cilësitë tona shpeshherë vetëshkatërrimtare në të shkuarën, si dhe vijimësinë e vet trishtuese.

Dhe nëse pranojmë që vendimet e marra në ngjarje të mëdha siç ishte Kongresi i Berlinit, janë bazuar në vlerësime të njerëzve më të shquar të një kombi i cili flet me gjuhën e udhëheqësit të vet, atëherë Spenser, duhet marrë si njeriu që bashkë me udhëtarë të tjerë britanikë i dhanë kryeministrit anglez të kohës, materialin, faktik të terrenit për të mbështetur vendimet që mori ai Kongres. Për më tepër, duhet thënë se fill pas këtij libri, një patriot shqiptar Pashko Vasa, ose Vaso Pashë Shkodrani shkruajti dhe botoi veprën e tij monumentale rilindase të quajtur: *"O Moj Shqypni"*! Ajo është nga fjala e parë tek e fundit e përshkruar nën trysninë brengosëse të një gjendjeje, të cilën e gjejmë edhe tek Edmund Spenser, pra atë çfarë ai na jep për Shqipërinë e mesviteve të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

[27] Archive of, Yale University Divinity School Library, New England, Erickson collection group 26, series nr 1, box nr 2, folder nr 6.

1853

WILLIAN WINGFIELD


A TOUR IN DALMATIA,
ALBANIA, AND MONTENEGRO;
HISTORICAL SKETCH
THE REPUBLIC OF RAGUSA,
FROM THE EARLIEST TIMES DOWN TO ITS FINAL FALL.
BY W. F. WINGFIELD,
LONDON:
RICHARD BENTLEY, NEW BURLINGTON STREET,

Dr William Frederick Wingfield (1813-1874) ishte autor anglez, i cili gjatë mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe pikërisht në vitin 1853, udhëtoi përgjatë bregdetit lindor të Detit Adriatik. Ai "*zbriti*" nga Zagrebi përgjatë bregdetit Dalmat drejt Shqipërisë. Ky udhëtim është pasqyruar në librin e tij "*Një tur në Dalmaci, Shqipëri dhe Mal të Zi me një skeç historik të Republikës së Raguzës (Dubrovnik) që nga kohët më të herëshme deri në rënien e tij përfundimtare*",[28] botuar në vitin 1859, në Londër. Duke qenë se ishte një teolog katolik, ai u interesua shumë për gjendjen e bashkësisë katolike në Shkodër. Në shkrimet e tij për Tivarin dhe Shkodrën ky autor anglez na jep një përshkrim të hollësishëm të gjendjes së të krishterëve nën Perandorinë Osmane. Ai rrëfen harmoninë dhe qetësinë e vendosur në qytet por edhe gjendjen e vështirë që karakterizonte jetën e tyre njëkohësisht. Shkrimi i tij është një lloj treguesi i heshtjes që në atë periudhë kishte rënë në një qytet me një histori aq të madhe siç ishte rasti i Shkodrës.

[28]A Tour in Dalmatia, Albania, and Montenegro with an Historical Sketch of the Republic of Ragusa, from the Earliest Times Down to Its Final FallPaperback– April 1, 2007

1861

GEORGE FINLAY

HISTORY

OF THE

GREEK REVOLUTION

BY

GEORGE FINLAY, LL.D.

IN TWO VOLUMES

VOL. I.

WILLIAM BLACKWOOD AND SONS
EDINBURGH AND LONDON
MDCCCLXI

Shqiptarët, luftëtarët e mëdhenj të revolucionit grek
The Albanians

"Historia e Revolucionit Grek do të ishte shpesh tepër e mugët, nëse nuk i jepet rëndësia e duhur elementit shqiptar, i cili mbushte ushtrinë e perandorisë osmane. Nuk ishte diçka e pazakonshme në Greqi dhe në Maqedoni po të shihje fëmijët e osmanllijve tek vishnin me krenari fustanella, ose fundet e bardha të Toskëve. Ishte fama e shqiptarëve në jetën ushtarake që i shtyu grekët modernë të përshtasnin fustanellën shqiptare si kostumin e tyre kombëtar"

Studiuesi skocez George Finlay (1799-1875), ishte mbështetës i vendosur i pavarësisë së Greqisë nga otomanët. Ai shkoi në Greqi në vitin 1823, ku takoi edhe Lord Byron - nin. Pas pavarësisë së Greqisë ai jetoi në Atikë dhe më vonë në Rrugën Adrianou në rajonin Plaka të Athinës, i cili ishte i banuar në shumicë prej folësve të shqipes. Ai iu kushtua shkrimit të historisë së Greqisë dhe mendohet se kishte ndikim në politikën greke. Historinë e Greqisë ai e botoi në shtatë volume të quajtur *"Historia e Greqisë prej pushtimit të saj nga romakët, deri në kohët e sotme", (Oksford 1877).* Ai kishte lidhje me studiuesin gjerman Johan Georg Hahn, me të cilin kishte korrespondencë. Në librin e tij *"Historia e revolucionit Grek" (Edinburg & London 1861)* na jep një pamje të detajuar të pranisë shqiptare në Greqinë

Qendrore në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Po ashtu ai shpjegon mbi origjinën shqiptare të *"fustanellës"* si dhe fatin tragjik të suliotëve në kohën e Ali Pashës.

Merita më e madhe e këtij studiuesi qëndron tek paanësia e tij në pasqyrimin e saktë dhe të vërtetë të gjendjes së shqiptarëve në Greqi edhe pse ai vetë njihet si një dashamirës i Greqisë. Pikërisht kjo e bën shumë më të besueshëm atë dhe faktet që ai parashtron. Realisht ai në këtë libër parashtron konsiderata shumë interesante për ne shqiptarët. Ndoshta nganjëherë edhe mund të mos na pëlqejnë. Por fakti që ai nuk është një studiues lajkatar i një pale, por një pasqyrues i realitetit në çdo dimension, na bën të marrim për bazë ato që ai thotë dhe ti pohojmë në mënyrën më serioze. Një ndër konstatimet e tij të goditura është ky i mëposhtmi.

> *"Hydriatët e çdo rrangu shfaqin karakterin e veçantë të racës shqiptare. Ata janë krenarë, të rëndë në sjellje, të rrëmbyeshëm, dhe lakmiqarë. Krerët e tyre ishin xheloz dhe këmbëngulës, njerëz të vrazhdë dhe të dhunshëm. Por të dyja palët zotërojnë disa virtyte të sprovuara; ata dallohen prej grekëve, ndaj dashurisë që kanë për të vërtetën dhe prej ndershmërisë me të cilën ata përmbushin çdo zotim. Një pjesë e konsiderueshme e tregëtisë bregdetare në Arkipelag ishte në duart e shqiptarëve të Poros, Kastrit dhe Kranidit, të cilët zotëronin shumë anije të zbukuruara. Mbi këtë popullatë detare Hydriatët dhe Spetziotët shfaqin supermaci".*

E tillë ishte pozita e popullsisë shqiptare në Greqi, ku vendbanimet e tyre ishin relativisht moderne siç i përshkruan ky autor

> *"Në rajonet e veta amtare rëndësia e saj politike dhe ndikimi moral ishte në mënyrë konstante në rritje gjatë gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe kishte arritur në pikun e fuqisë së vet në fillimin e revolucionit Grek. Në Shqipëri një pjesë e konsiderueshme e popullsisë kishte përqafuar fenë muhamedane, por muslimanët shqiptarë ishin të padëshirueshëm për osmanët dhe të urryer prej grekërve. Feja vështirë të ishte një çështje ndërgjegje për shumicën. Ata ishin më pak fanatikë se turqit dhe më pak supersticiozë se grekët. Lakmia e tyre ishte e pakufi dhe për flori shqiptari musliman i shërbente me dëshirë një padroni të krishterë, ndërkohë që një i krishterë shqiptar, për flori i shërbente një padroni musliman, edhe nëse shërbimi duhej bërë me vepra të përgjakshme".*

> "*Është rrjedhojë e admirimit të shqiptarizmës që oborri i Mbretit Oto, i cili mori aspektin melodramatik dhe shkëlqimin në imitacionin e gjërave*

të pasura dhe të shkëlqyera që e kapi vëmendjen e Child Harroldit në galerinë e pallatit të Tepelenës".

Tek Finley të veçantat e shoqërisë shqiptare vihen re më së shumti në mënyrën e jetesës midis atyre, të cilët janë pronarë të tokave. E tërë kjo klasë konsiderohet nga ai...si më poshtë:

"Ka lindur për të mbajtur armët. Pronarët e mëdhenj të tokave janë kapitenët, zotëruesit fshatarë janë ushtarë ose kusarë. Pronarët e tokave, të mëdha ose të vogla kanë tufa bagëtish, të cilat furnizojnë me qumësht, djathë, lesh, pastaj vaj ulliri dhe pemë frutorë".

1861

GEORGINA MACKANZIE DHE PAULINA IRBY

Udhëtime në Krahinat Sllavonike të Turqisë në Europë[29]

Georgina Muir Mackenzie (1833-1874) dhe Adeline Paulina Irby (1831-1911) kanë udhëtuar shumë nëpër atë që më vonë u quajt Jugosllavi dhe në Shqipëri, në vitet (1861-1864). Georgina Mackenzie ishte e bija e një skocezi, ndërsa Paulina Irbyn, e bija e admiralit të prapavijës Baron Boston. Ato shkruan dhe botuan një libër prej 687 faqesh të titulluar *"Udhëtime në Krahinat Sllavonike të Turqisë në Europë",* Londër 1866.

Në udhëtimet e tyre përfshihet edhe kalimi nëpër Kaçanik, Graçanicë, Prishtinë, Vuçitern, Pejë, Deçan, Gjakovë dhe Prizren, përpara se të kalonin nëpër malet e veriut të Shqipërisë. Në fakt ato kishin simpati për sllavët e jugut, veçanërisht serbët, dhe nuk kishin ndonjë simpati për kauzën shqiptare. Prapëseprapë ato japin shumë informacion mbi shqiptarët e Kosovës dhe të veriut të Shqipërisë.

> *"Turqishtja, e cila nuk përfillet në Pejë dhe Gjakovë, formon një prej tre gjuhëve të Prizrenit. Ajo serbe prapëseprapë, duhet konsideruar si gjuha kryesore, megjithëse banorët e krishterë janë në minorancë, kjo vjen për shkak të karakterit të patjetërsueshëm të serbëve dhe lidhjet e tyre me qytetin. Pjesërisht, gjithashtu, edhe pse thuhet se disa prej muslimanëve janë me origjinë serbe – shumica janë arnautë".*

[29] *Travels in the Slavonic provinces of Turkey-in-Europe, By Sebright, Georgina Mary Muir (Mackenzie),* Sebright, Georgina Mary Muir (Mackenzie), Lady, d. 1874-, Irby, Adelina Paulina, joint author. London: Daldy, Isbister & co., 1877.

Përshkrimet e këtyre dy zonjave janë shumë interesante në raportet midis popullsisë së asaj kohe. Ato në veçanti e përshkruajnë qytetin e Prizrenit, influencën austriake në atë vend si dhe atë të kishës katolike, pastaj vijnë tuqit dhe administrata e tyre tërësisht e korruptuar dhe, natyrisht serbët. Shënimet e tyre vlejnë shumë për të krijuar një përfytyrim të qartë të Kosovës së asaj kohe. Interesant mbetet fakti që shumë gjëra janë trashëguar edhe sot në Kosovë siç është gjuha turke e folur nga banorët shqiptar të Prizrenit, gjë që nuk ndodh në Gjakovë.

1865

HENRY FANZHAWE TOZER

...Ka një provë të konsiderueshme që tregon se shqiptarët janë një komb i një lashtësie të hershme.

"Heronjtë e shqiptarëve janë Aleksandri i Madh, Pirro dhe Skënderbeu dhe në kohët moderne mund të përmendet edhe Ali Pasha. Aleksandri lidhej me Shqipërinë nëpërmjet nënës, Olimpisë, e cila ishte princeshë epiriote"[30].

Henry Fanshawe Tozer (1829-1916) ishte një shkrimtar britanik, mësues dhe udhëtar i famshëm. Ai ka udhëtuar nëpër Greqi dhe në Perandorinë Osmane. Në vitin 1850 ai kishte kryer Kolegjin Exeter në Oksford. Ai ka udhëtuar dhe shkruar për Malin Athos, Olimpin, por edhe për mirditorët shqiptarë, të cilët i paraqit në librin e tij të botuar në vitin 1865.

Tozer e fillon udhëtimin e tij, ashtu si edhe Finley nga Struga dhe pikërisht tek dalja e Drinit të Zi, i cili rend drejt bashkimit me atë të Bardhin për t'u derdhur në Lezhë dhe në detin Adriatik.

"Pamja e kësaj pjese të Liqenit të Ohrit, - thotë ai, është jashtëzakonisht e bukur, por është më e lehtë për udhëtarin të kënaqet pranë liqeneve

[30] *Henry Fanshawe Tozer,* Researches in the Highlands of Turkey, Including Visits to Mounts Ida, Athos, Olympus, and Pelion, to the Mirdite Albanians, and Other Remote Tribes, *London: John Murray 1869, Volume 1, Chapter IX, pp. 195-217*

italiane sesa në mesin e rajoneve të egra, të ashpra të Turqisë Europiane. Një prej udhëtarëve mesjetar e ka krahasuar atë me liqenin Gennesaret, Liqeni, tek i cili Jesus kishte bërë vepra shëruese e që mban një emër hebraik të greqizuar me kuptimin e Liqenit të Luleve".

Më pas ai përmend faktin që trofta (korani) e liqenit është e rrallë dhe peshkimi ushtrohet në masë të gjerë, ndërsa peshku i thatë eksportohet në të gjitha anët e Turqisë. Peshkimi ushtrohej që në kohët e Strabosë, i cili përmend:

"Vendi i tharjes së peshkut gjendej pranë Liqenit afër Lychnidus, (emri latin i Ohrit të sotëm). Anna Comnena flet me admirim të madh për qindra kanalet nga të cilat merrej ujë me argjinaturat dhe kalimet e mbuluara të ujit që komunikonin me njëri-tjetrin, prej nga ishte formuar lumi Drin. Aty kalon Via Egnatia e kohës romake, të cilën Strabo e quan si "e matur me milje dhe e shënuar me piketa".

Ai jep një listë emërore njerëzish të shquar të kohës romake, të cilët shkruheshin në latinisht në ato piketa të kësaj rruge historike që lidhte Romën me Kostandinopulin. Henry Tozer e vijon udhëtimin drejt Qukësit, ku kalon një natë në një han të vjetër. Pastaj kalojnë në Xhyrë e më pas thotë se zbritëm nga një shpat në *Scampa*, emër i vënë nga *Via Egnatia*. Elbasanin ai e përshkruan si një qytet me dhjetë mijë banorë, shumica e të cilëve janë gegë. Të krishterët ishin katolikë, por ata ishin aq të persekutuar sa detyroheshin të shndërroheshin sipas parimit "*Aty ku vringëllon shpata, aty është edhe besimi*". Autori përmend kullën e sahatit të Elbasanit, çka vërteton, sesa e vjetër është ajo. Më tej ai përshkruan Malin e Tomorrit në jugperëndim dhe malet që e ndajnë qytetin me Tiranën. Midis përshkrimeve të tij është dhe ky fragment për natyrën fizike të gegëve në Elbasan:

"Shumica e gegëve janë burra të imët. Ajo që vihet re në karakteristikat e tyre është qafa e gjatë, fytyra e zgjatur dhe e ngushtë me forma të prera shpesh në formë shqiponje me pak flokë. Ata kanë një vështrim të sertë, prej guximtarësh të pamëshirshëm".

Ai nuk harron të shënojë se në këtë qytet kaq të fjetur nën otomanët, ka arritur teknologjia e kohës, - telegrafi, i cili lidhte Selanikun me Shkodrën. Henry Tozer ndalon në një fshat që ndan Gegërinë me Toskërinë dhe që këtu, ai ndalet tek çështjet e identitetit shqiptar:

"Shqiptarët e quajnë vetveten Shqiptarë dhe ka një provë të konsiderueshme që tregon se ata janë një komb i një lashtësie të hershme. Emri Arnaut, i cili iu është dhënë prej turqve, është në të vërtetë vetëm një emër i korruptuar i emrit "Albanian". Procesi i ndryshimit është dukshëm i gjurmueshëm në greqishten moderne, ku emri Albanitës (Alvanitës) prej një ndryshimi të butë bëhet Arvanitës dhe që aty prej një gërme të shndërruar merr trajtën Arvanitës nga pasazhi i të cilit kalohet lehtë në Arnaut. Gjuha e tyre, e cila ka qenë për shumë kohë një enigmë për filologët, është ekzaminuar me kujdes prej professor Bopp,[31]*i cili pohon se ajo është një degë e pavarur e familjes indo – europiane. Shumë prej sistemeve të lakimit dhe disa fjalë janë krejt të ngjashme me greqishten dhe latinishten, por jo deri në atë shkallë, sa të besohet se ato janë huazuar, as prej njërës dhe as prej tjetrës. Në shumicën e sajë, sipas Bopp, ajo mund të shpjegohet më lehtë prej Sankrishtes sesa prej atyre gjuhëve. Dr. Von Han, i cili jetoi shumë vite mes shqiptarëve në veprën e tij "Albanesische Studien" beson se ata janë përfaqësuesit ekzistues më të afërt të Pellazgëve".*

Autori duhet të jetë shumë i kulturuar dhe me dije të gjera. Ai jo vetëm komenton në ato që thotë Von Hann, por shton:

"Bazuar nga ato që thonë autorët e vjetër duket se banorët e sotëm janë të së njejtës race, e cila e populloi vendin në kohët klasike dhe le të kuptohet një lidhje e afërt midis fiseve epirote dhe ilire me ato të Maqedonisë. Këto deklarime të marra së bashku me ekzistencën e Orakullit pellazg të Dodonës në këtë vend dhe fakte të tjera të kësaj natyre, duket se e mbështesin këtë teori. Aty ekziston një alfabet dukshëm i vjetër, i cili siç beson Han trashëgohet prej pellazgëve në Fenikas, - ndoshta nga vendbanimet Fenikase në Egjeun verior. Por ajo që them unë është se një studim i kujdesshëm i gjuhës mund të hedhë dritë të konsiderueshme mbi gjuhët klasike".

Henry Tozer vijon:

"Numri i përgjithshëm i shqiptarëve në Turqi është rreth një milion frymë. Atyre u duhet shtuar edhe një numër prej 200.000 në Greqi, 85.000 tjerëve, të cilët janë vendosur në Italinë Jugore dhe në Siçili. Vendi ka dy grupe të mëdha, Toskët në Jug dhe Gegët në Veri dhe i përkasin të parët epirotëve dhe të dytët ilirëve; ndërkohë gjuha e tyre

[31]*Bopp është filologu i pare, i cili ka provuar se gjuha shqipe është një* degë e ve*çantë e gjuhëve indo-europiane*. Teoria e tij nuk është hedhur poshtë asnjëherë.

ndryshon aq sa gjermanishtja nga danishtja. Dallimet në fe janë të tilla që, ndërsa ata të krishterë të pashndërruar në muhamedanë kanë mbetur katolikë romakë, ata të jugut janë ortodoksë të lindjes".

Më pas autori paraqet një histori të Skënderbut, e cila nuk ndryshon dhe aq nga ato variante që kemi dhe, ndoshta ka qenë edhe baza e Historisë së Skënderbut të shkruar nga Fan Noli, poema e shkruar nga Naim Frashëri, apo ajo e Longfellout.

Ky autor britanik ka vizituar Beratin, Malin e Tomorrit, si dhe zona të tjera të jugut. Henry Tozer ndalet tek studimet e John Jozef Shafarik[32], në lidhje me emrin e Beratit. Ai thotë se Berati është një emër i thjeshtuar i emrit Belgrade që do të thotë Kështjelle e Bardhë ose "*i bukur*". Kjo sipas Shafarik nuk është asgjë tjetër përveçse përkthim i emrit bizantin Pulcheriopolis. Në përshkrimet e tij, ai ndalet tek Beteja e Skënderbut në atë kështjellë. Përshkrimet për këtë qytet janë vërtetë të bukura dhe bëjnë kureshtar jo vetëm studiuesit, por edhe njeriun e thjeshtë që dëshiron të dijë për Shqipërinë. Ndërkohë ai e vijon udhëtimin e tij drejt jugut, duke sjellë kujtimet e kohës së Ali Pashë Tepelenës, të cilat ishin ende të freskëta në atë kohë të udhëtimit të tij, duke mundur të sjellin deri në ditët tona freskinë e vlerës së atyre përshkrimeve.

Tregimet e Henry Tozer japin po ashtu një pamje historike të Shkodrës, Mirditës. Aty do të gjejmë rezistencën ndaj turqve, ndarjet fetare, popullsinë (psh Shkodra kishte 27.000 banorë në atë kohë). Ai viziton Konsullin Britanik në Shkodër, z. Read, i cili i jep një informacion të gjerë rreth saj. Po ashtu ai takon konsullin M. Hecquard. Në librin e tij ai pasqyron mjaft nga kontraditat dhe interesat franceze, italiane, austriake, malazeze në atë qytet. Në Mal të Zi ai takon edhe një konsull rus. Nuk kursen të na përshkruajë edhe muzikën e luajtur nga një bandë muzikore, e cila luante më shumë motive orientale që i kujtonin marshin turk "*Ruins of Athens*"[33].

Në Shkodër ai na përshkruan historinë e Gentit dhe rrethimin e saj prej Romës, e cila humbi pavarësinë dhe u bë provincë romake në vitin 168 p.e.re. Më pas Henry Tozer shkruan historinë e Mirditës, duke i quajtur mirditorët luftëtarët më të paepur kundër Turqisë. Këtë udhëtim e ka bërë

[32]Paul Josef Shafarik është studjues i madh i gjuhëve sllavonike. Ai ka lindur në veri të Hungarisë në Kobelarova në vitin 1795. Shih Academy and Literature Vol I.

[33]Marshi Turk (Marcia alla turca) është një marsh shumë i njohur klasik i kompozuar nga Ludwig van Beethoven. Ai është shkruar në stilin e muzikës popullore turke të kohës. (Këtu nuk është fjala për Marshin Turk të Moxartit.

edhe Dr. Grisebach[34]. Ai përmend Oroshin dhe kullën e Preng Bib Dodës, përmend Zadrimën dhe Kallmetin, Lezhën dhe Shën Gjinin, Kashnjetin (emër i dhënë sipas gështenjës), Shën Gjergjin, Fanin dhe Shpërdhazën, Matin dhe zona tjera. Ai flet për kanunin dhe gjakmarrjen. Një gjë interesante është edhe përshkrimi i asaj që ne e quajme "*Vëllam*", vëlla i adaptuar apo "*probatim*" që është një gjë që ushtrohet në Mirditë si edhe në zona të tjera shqiptare. Këtë ai e krahason me vëllazërimin e Davidit dhe Jonathanit ose të Akilit dhe Patroklit.

[34] *August Grisebach (1814-1879) ishte një botanist dhe professor gjerman i lindur në Hanovër. Ai ka shkruar librin "Udhëtim nga Prizreni në Shkodër". Ai doktoroi në Berlin në vitin 1836, dhe u bë profesor në Universitetin e* Göttingenit. Në vitin 1839, ndërmori një tur të gjerë nga Gjermania në Bursë të Turqisë dhe më pas në Ballkan. Ai kaloi nga Shkupi në Prizren.

1865
ARTHUR MACMURROUGH KAVANAGH

Udhëtari më i habitshëm që ka njohur njerëzimi, pa duar e pa këmbë, viziton Shqipërinë

Arthur Kavanagh, nga të gjithë udhëtarët që kanë kaluar nëpër Shqipëri është më interesanti, më i habitshmi, më mbresëlënësi. I lindur pa këmbë dhe pa duar, Arthur MacMorrough Kavanagh arriti të bëhej një politikan i suksesshëm. Trashgimtar i mbretit të Leinsterit, ai vinte nga një familje e fuqishme dhe është vlerësuar si gjeni i kohës së tij. Ai shërbeu 14 vjet si anëtar i parlamentit dhe udhëheqës i unionistëve nga Irlanda. Kompensimi i shqisave nuk ka gjetur ndonjëherë shpjegim më të mirë sesa në rastin e këtij njeriu. Ai ka shkruar një libër rreth gjuetisë dhe pikturave në kufijtë midis Greqisë dhe Shqipërisë.[35] Pa këmbë dhe pa duar, ai nuk ishte vetëm një udhëtar që nuk e njihte frikën, por edhe një gjahtar i apasionuar, një marinar i zoti, një peshkatar i mirë, një fotograf amator, një vizatues i talentuar, autor librash nga më të shiturit dhe babai i shtatë fëmijëve. Ai është një ndër njerëzit që ka udhëtuar më shumë dhe bën pjesë tek ata që njihen si '*Long Riders*' Guild (udhëtarët e largësive të mëdha me kalë) Ai është quajtur "*kalorësi zbulues më i habitshëm i shekullit të nëntëmbëdhjetë*". Në librin e tij ai jep mjaft pamje të bukurisë shqiptare sidomos gjatë gjuetisë në zona të tilla si Butrinti.

[35]*Mrs. Steele's Arthur MacMorrough Kavanagh, London, 1891, 8vo; The Lancet, 14 March 1891; Blackwood, cxlix. 429 et seq.; Dublin Gazette, 1886.*

1877

ARTHUR EVANS

Shqipëria Çelësi Lindor i Adriatikut

***"Gjenia e hollë e shqiptarit di si të vendosë interesat e tij përpara fesë"*[36]**

Sir Arthur Evans (1851-1941) është një arkeolog britanik i njohur për zbulimin në vitin (1900–1903) të rrënojave të Pallatit të Knosos në ishullin e Kretës. Ai ka shkruar librin "*Kërkime Antikuaresh në Iliri*", dhe e ka botuar në Londër në vitin 1885. Veprat e tij për Ballkanin janë botuar të përmbledhura në "*Ancient Illyria: An Archeological Exploration*", London I.B Tauris 2008 dhe në "*Albanian Letters: Nationalism, Independence and the Albanian League*", London I.B Tauris 2008. Një prej atyre letrave është edhe kjo për Durrësin, e shkruar në vitin 1877.

> *"Me gjithë frymën e çorientuar që ka administrata osmane, nuk duket se ka prekur karakterin e racës së njerëzve të Durrësit dhe rrethinës së tij, duke e cilësuar ..."I shpejtë në ecje, i gjallë, me qëndrim të fortë, sy të mprehtë që i shkëlqejnë, tipare të rënda e përsëri të prera bukur e delikate, ashtu siç më duket mua, ai është në kontrast me tipin e pastër*

[36]*Arthur J. Evans:* Illyrian letters, a revised selection of correspondence from the Illyrian provinces of Bosnia, Herzegovina, Montenegro, Albania, Dalmatia, Croatia and Slavonia, addressed to the Manchester Guardian during the year 1877*, London: Longmans, Green and Co. 1878, p. 131 142.*

helenik sesa me atë të ndonjë race tjetër, përfshirë edhe grekët modernë; fustanella e bardhë, valavitëse, që të kujton atë, që një herë e një kohë i ngjasonte asaj të luftëtarëve romakë, jelekun ngjyrë karafil, - një kostum burri kokë e këmbë më i mrekullueshmi në Europë – çdo gjë më kujton se jam midis njerëzve të cilët nuk kanë lidhje, as me turqit, as me sllavët. Këta janë patriotët që vijojnë lidhjen me Skënderbeun dhe Ali Pashë Janinën, janë shqiptarët, "Fëmijët e Gurit" malsorët e Turqisë, luftëtarët më të fortë dhe raca më e pathyeshme që zotëron besnikërinë dhe besimin e sulltanit.

Shqipëria është si Bosnja në këtë aspekt ku popullsia muslimane nuk është turke, as në racë, as në gjuhë, as në simpatitë që ka. Këtu gjithashtu ekziston ende një aristokraci feudale dhe çdo Beg shqiptar ka mbështetësit e vet fisnor që e pasojnë dhe i ngjet një prijësi malësor të një ose dy shekujve më parë. Organizimi fisnor është shumë më i zhvilluar se në Bosnjë dhe bejlerët janë proporcionalisht më të fuqishëm.

Por ajo që e dallon kryesisht Shqipërinë nga provincat e tjera ka të bëjë me karakteristikat e veçanta të racës. Prej natyre, i shpejtë, energjik, intolerant, skeptik, mosbesues dhe i paqëndrueshëm, shqiptari, ndryshe nga sllavi, e ka vlerësuar lirinë si gjithçka dhe fenë si diçka të dorës së dytë. "Feja e shpata bashkëudhëtojnë"- thotë një proverb shqiptar. Dhe kudo ku feja qëndron në anën e interesave të tij, arnauti i vërtetë nuk ngurron, të paktën jo në dukje, të përshtatet me një besim më të rehatshëm për të. Kështu rreth Prizrenit dhe gjetiu ka mijëra katolikë romakë (kripto – katolikë, siç thirren), të cilët e kanë bërë fe publike islamizmin në mënyrë që të shmangin bezdisjen që iu shkakton të qenurit raja. Një shqiptar mund të shkojë në xhami në drekë dhe në kishë në mbrëmje po me të njejtën lehtësi. Kujtimet e Skënderbeut – i fundit dhe më i forti kampion i shqiptarit të krishterë kundër turqve – mbahen dhe vlerësohen prej muhamedanëve të provincës me një devocion fanatik, i cili çuditërisht ndryshon në respektin e ftohtë që ata denjojnë ti japin themeluesit të fesë së tyre. (Gjenia e hollë e shqiptarit di si të vendosë interesat e tij përpara fesë".

"Shqiptarët e këtyre anëve janë më të ashpër dhe më fanatikë sesa ata të brigjeve të Adriatikut dhe t'i japësh atyre autonomi të plotë lokale do të ishte thjesht t'ju japësh atyre dorë të lirë që të tiranizojnë, madje edhe më shumë se në kohën e tashme, mbi popullsinë e fuqishme kristiane të tokave të ulta të Dardanëve. E përdor termin "dardanas" sepse rajonet në të cilat unë po flas (këto të përqafuara me emra në Vilajetin

e sotëm të Kosovës dhe rrypin verior të Vilajetit të Manastirit), duke përfshirë Kalkandelën (Tetovën) dhe Prizrenin, e cila shtrihet midis Shqipërisë së vertëtë dhe Serbisë, i përgjigjen pothuajse ekzaktësisht Mbretërisë së vjetër Ilire dhe më vonë Provincës Romake të Dardanisë. Megjithëse, duke i pasur borxh eksodit të madh serb nën Arsenius Tzernojevich, ka patur një shpërngulje të madhe shqiptare në këtë rajon Dardanian gjatë tre shekujve të fundit, është e sigurtë që, të paktën në rajonet jugore, elementi sllav, edhe pse jo aq i sigurtë në vetvete prapëseprapë kishte epërsi. Fushat e pasura të rrethinës së Shkupit janë punuar thuajse ekskluzivisht prej fshatarëve sllavë (të quajtur gabimisht bullgarë – pasi gjuha e tyre tregon se kishin gjak të pastër serb) dhe serbishtja është gjuha e tyre e tregut. Edhe rreth e rreth Prizrenit ku elementi shqiptar është më i madh në numër i ashtuquajtur Arnaut ende flet serbisht. Ndërkohë që në Novi Pazar gjuha serbe mbizotëron, vetëm në vargmale mund të thuhet pa frikë se popullsia është shqiptare.

Vëzhgimet e mia në rastin e tashëm kanë qenë deri këtu kryesisht të mbyllura në pjesën e Dardanisë, në të cilën Shkupi është qendra kryesore. Ai, megjithatë, ka qenë shumë i plotë pasi kam mundur të vizitoj pesëdhjetë fshatra. Ky është një rajon shumë më i qetë dhe i rrregullt i Vilajetit të Kosovës dhe e gjeta atë tërësisht të lirë nga çfarëdo lloj kusarie. Banditët më të afërt në këtë kohë janë në Prilepin fqinj dhe, duket se janë nën drejtimin e një farë Nikos së famshëm. Ata nuk kanë rëndësi politike dhe janë njësoj të neveritshëm, si për turqit edhe për të krishterët. Po ashtu nuk gjeta dot ndonjë gjurmë të ndonjë konspiracioni politik ose lëvizjeje midis popullsisë Raja të Shkupit dhe rajoneve fqinjë".

1878

Edward Frederick Knight


ALBANIA:

A NARRATIVE OF RECENT TRAVEL.

By E. F. KNIGHT,

WITH ILLUSTRATIONS.

Aventurat e hershme të turistëve anglezë në Malet Veriore të Shqipërisë

Avokati anglez, udhëtar dhe shkrimtar Edward Frederick Knight (1852 – 1925) kreu studimet në Kolegjin Caius në Cambrigde. Ai ishte një udhëtar i madh dhe ka shkruar njëzet libra. Në vitin 1878, në kohën e Lidhjes së Prizrenit, ai bashkë me një grup shokësh bëri një udhëtim në Mal të Zi dhe Shqipëri. Qëllimi i tij në Shqipëri ishte të kalonte nëpër territorin e Kelmendit për të vizituar qytetin e Gusijës, sot pjesë e Malit të Zi. Udhëtimi doli të ishte një aventurë më e madhe nga ç'e priste ai. Ai shkroi librin "*Shqipëria – një Rrëfim i Udhëtimit të fundit* [37]. Ai rrëfen:

> *"Ishte Ahmet Aga që më tha: "Qëllimi ynë, është të mbrojmë vendet tona kundër armiqëve që na rrethojnë. […] Shqiptarët janë të guximshëm, dhe armët edhe municioni nuk mungojnë."*
> *Dukej se dyshonte për ne prandaj më pyeti: - Kush jeni e nga vini? Përse dëshironi të shkoni në Gusijë? Unë iu përgjigja: -"Do shkoj atje se dua të shkruaj një libër për ju që ta lexojnë në Angli. Anglezët duan të dinë çfarë do të thotë Lidhja Shqiptare dhe se a është diçka e mirë apo jo. Ja pse duam të shkojmë në Gusijë që ta shohim dhe tu tregojmë njerëzve tanë të vërtetën". "Ah, më tha ai, "Krajli juaj" udhëheqësat tuaj iu kanë dërguar këtu për këtë? Mir, mir – në rregull".*

[37]Albania A Narrative of recent Travel , by E.F Knight, barrister at law, with illustrations, London, Sampson Law, Marston, Searle & Rivington, Crown Building, 188 Fleet Street, 1880.

"Gusija është një lloj vendi kurioz, por pa ndonjë emër të njohur. Si në të gjitha pjesët e Shqipërisë Veriore njerëzit bëjnë pothuajse atë që iu pëlqen, dhe nuk e ndjejnë aq shumë zgjedhën turke. E vendosur siç është në kufi, Gusija është bërë strehë e mijëra njerëzve. Renegatët malazezë, vendi i të cilëve është bërë shumë i vështirë për ta, refugjatët muslimanë boshnjakë si dhe vagabondë të të gjitha markave janë dyndur aty. Është pikërisht në këtë qytet të Gusijës që drejtuesit e Ligës Shqiptare i kanë përqëndruar forcat e tyre të vendosur të luftojnë deri në pikën e fundit, përkundër trupave austriake në Bosnjë e deri në veri të tyre. Aty gjenden trupat turke në prapavijën e tyre, malazezët përpara mureve dhe padyshim, arnautët e krishterë, të cilët janë të gjithë rreth e rreth nëpër male, në prita për të vrarë ndokënd nga ana tjetër. Kjo është ajo çfarë quhet pa-asnjanësi midis këtyre njerëzve, një pa-asnjanësi e armatosur për hakmarrje. Tridhjetë e pesë mijë shqiptarë, na thanë, kanë zënë Gusijën, në krye të të cilëve është Ali Beu. (Ali Pashë Gusija - MB)"

"Ali Pasha, siç e ka quajtur ai vetveten, është një burrë Gusije, i një rrangu të lartë, pronar tokash dhe shtëpish, në qytet dhe në rrethinë, një burrë jashtëzakonisht i zgjuar, dhe një musliman i devotshëm. Ai mori pjesë në vrasjen e Mehmet Ali Pashës në Gjakovë.

Ka diçka të veçantë, të këndshme dhe të bukur në mënyrat sesi sillet kasta e lartë e shqiptarëve. Mirësjellja e tyre është e hijshme, ata pranojnë çdo kërkesë të mikut; lëvizjet e tyre kanë një butësi si të maces, pa zhurmë. Ata janë të përkushtuar dhe mahnitës, që është diçka e mrekullueshme. Shqiptarët janë shumë krenarë. Do të ishte një ofezë shumë e madhe për ta, nëse do tu ofroje para në këmbim të mikëpritjes së tyre. Ndoshta gjëja e duhur që mund të bëjë miku është tu japë diçka fëmijëve, të cilën pastaj e mbledh mëma e tyre për t'i përdorur për ditën e pazarit në Shkodër".

Shkrimtari Knight nuk e anashkalon veprimtarinë e Mark Milanit, një shqiptar i lindur në rrethinat e Gusinjës, i cili i inatosur nga paudhësitë e turqve, iu bashkohet malazezëve dhe bashkë me ta bën shumë zullume ndaj shqiptarëve. Kështu ai përfaqëson rrenegatin shqiptar, i cili i bën dëm popullit të vet.

1878

FANNY JANET BLUNT

***Shqiptarët*[38]**

Fanny Janet Blunt (1839-1926) është lindur në Therapia, në rrethinat e Konstandinopulit. Babai i saj, Donald Sandison, kishte shkuar në Turqi si përfaqësues i Kompanisë Britanike India Lindore dhe pas kryengritjeve të jeniçerëve u bë konsull i Britanisë në Bursa. Në Manastir ajo takoi bashkëshortin e ardhshëm të saj John Elijah Blunt, i cili ishte zëvendës konsull britanik në Shkup. Në vitin 1858 ata ishin martuar dhe vendosur në Shkup. Në vitin 1902 u vendos në Maltë ku edhe vdiq në vitin 1926. Zonja Blunt mbahet mend për dy volume *"Njerëzit e Turqisë",* Londër 1878. Kapitulli për shqiptarët jep disa informacione interesante, të cilat ndihmojnë në plotësimin e kuadrit të interesit të britanikëve mbi Shqipërinë.[39]

"Shqiptarët sikundër tërë racat e rëndësisë së vogël që popullojnë Turqinë europiane janë pak të njohur për botën e qytetëruar. Shqipëria me malet e saj të pakalueshme me luginat e thella, shtigjet këmbësore të përrenjëve është vizituar prej atyre udhëtarëve, të cilët kanë patur

[38] Fanny Janet Blunt: *The People of Turkey, Twenty Years' Residence among Bulgarians, Greeks, Albanians, Turks and Armenians, by a Consul's Daughter and Wife.* Edited by Stanley Lane Poole (London: John Murray, 1878), vol. 1, p. 62-87.
[39]Robert Elsie,

shpirtin e nevojshëm guximtar dhe aventurier për të penetruar në të tilla vise. Vendi shtrihet mbi Ilirinë antike."

Autorja ndalet tek cilësitë shqiptare si mikëpritja, respekti ndaj mikut, respekti ndaj gruas, ndarja krahinore, kostumet, etj. Duhet thënë se kjo autore ka vënë në pah shumë dobësi tonat; përfshirjen në gjakmarrje, vrasje e fenomene të tjera. Por ajo tregon edhe raste të veçanta dhe të rralla se si shqiptari i respekton kodet e veta.

1903

HENRY N. BRAILSFORD

***Shqiptarët, racë që është zgjuar shumë vonë*[40]**

"E ardhmja e Shqipërisë është e vështirë të përshkruhet me siguri të plotë. Kjo racë interesante me të dhëna të veçanta nga zoti është zgjuar shumë vonë".

Henry Noel Brailsford (1873-1958) ka qenë një gazetar britanik shumë i njohur në kohën e tij. Ai ka shkruar për Manchester Guardian në Francë, Egjypt, dhe në Ballkan si korrespondent i huaj. Në vitin 1903, ai bashkë me Edith Durham nisen për një mision ndihmash në Maqedoni. Ndër librat e shumtë që ai ka botuar është edhe ai me titull: *"Maqedonia: "Racat dhe e ardhmja e saj",* Londër 1906, i cili përmban një pjesë të rëndësishme për shqiptarët. Ai e jep perspektivën e Shqipërisë, parë nga viti 1903:

> *"Një historian, i cili vihet në kërkim të ironive dhe anomalive nuk mund të gjejë një kontrast më të habitshëm se ai i turqve dhe shqiptarëve: Njëra, racë aziatike me gjak mongol, më i varfëri në atë e cila quhet dhuratë intelektuale, e prapësepraprë falë ndikimit arab, zotërues i një kodi ligjor mjaft human dhe të përpunuar; Tjetri një popull europian me trung arjan, krenar për një pjesë të mirë të krishtërimit të njohur midis tyre, popull i shkathët, i zgjuar dhe me cilësi të dhuruara nga zoti dhe ndër shekuj në kontakt me civilizimet greke dhe italiane, e prapësprapë*

[40]H. N. Brailsford, *Macedonia: its Races and their Future* (London: Methuen & Co. 1906, p. 262-280.]

edhe tani në shekullin e njëzetë me një seri institucionesh, të cilat kanë mbetur të pandryshuara që në ditët e para të migracionit arjan. […]

Në fund të fundit, lëvizja shqiptare si çdo lëvizje ballkanike është e frymëzuar nga një ideal kombëtar dhe dëshira për tu çliruar prej sundimit turk dhe, nëse ajo mban në pamje një farë armiqësie ndaj Europës, kjo vjen vetëm se Europa e injoroi Shqipërinë në Traktatin e Berlinit dhe se praktikisht ajo u bë një mbrojtëse e sllavëve me të cilët shqiptarët kanë një hesap tradicional për të larë. Jam përpjekur shpesh herë në biseda me shqiptarët të kuptoj qëndrimin e tyre. Gegët, si rregull, me aq pak arsimim sa kanë, të shpjegojnë qartazi se çfarë kërkojnë dhe çfarë duan. Kryengritja ishte një shpërthim instiktiv. Por nëse e imagjinon një geg të pazhvilluar atë që të shpjegon idetë e Boletinit dhe ato fisnore, dhe pse i edukuar mjaftueshëm është në gjendje sa për të deklaruar qartë dhe prerazi. Ai do të shpjegojë qëndrimin kombëtar në këtë mënyrë: "Ne shqiptarët jemi raca origjinale dhe autoktone e Ballkanit. Sllavët janë pushtues dhe emigrantë, të cilët kanë ardhur dje nga Azia. […]

"Programi ynë është Shqipëria për shqiptarët dhe ne nuk kemi nge t'i nënshtrohemi asnjë sundimi të huaj, dhe për më tepër atij sllav jo se jo. Nëse turqit nuk na mbrojnë dot nga pansllavizimi, atëherë ne jemi të përgatitur mirë të luftojmë kundër turqve. Ne asnjëherë nuk e kemi pranuar zgjedhën e tyre. Kemi ruajtur zakonet tona, gjuhën dhe pavarësinë lokale. Asnjëherë nuk iu paguam taksa. Ne kemi luftuar si vullnetarë për Sulltanin në çdo luftë turke nga Plevna tek Domokos – por asnjëherë nuk kemi veshur uniformën turke apo pranuar skllavërinë e kazermave. Pse dëshironi të impononi zgjedhën turke ndaj nesh? Unë mendoj se kjo vjen ngaqë nuk jemi sllavë, ose për shkak se shumë prej nesh janë muslimanë. Kjo është toleranca juaj? Jo, ne nuk duam reforma, Ne duam Liri. […]

E ardhmja e Shqipërisë është e vështirë të përshkruhet me siguri të plotë. Kjo racë interesante me të dhëna të veçanta nga zoti është zgjuar shumë vonë. Frika është se kriza bash në kohën kur duhej të vinte fati i saj po vjen më përpara se ajo të ketë pasur kohën e duhur për ta përgatitur veten për lirinë. Ajo nuk ka gjetur njohje nga diplomacia, ndërsa shtetet e reja të cilat e rrethojnë atë e konsiderojnë si trashëgiminë e tyre të ligjëshme. Greqia ngre pretendime ndaj Epirit ndërsa Serbia kërkon Fushën e Kosovës, deri aty ku ngrihen malet prapa Prizrenit; ndërkohë Mali i Zi, i përkëdheluri i veçantë i Carit, shfaq pandarë ambicjet e veta. Shqipëria mund të marrë rrugën e Polonisë

dhe ëndrra e saj e ekzistencës kombëtare do të ketë marrë fund pothuajse përpara se ajo të ketë filluar të frymëzohet. Përtej këtyre konkurentëve më të vegjël qëndron Italia dhe Austria, secila në ankth për të përftuar një pjesë nëse jo të tërën. Në fakt e vetmja shpresë që duket e lejueshme, është që midis kaq shumë mëtonjësve, zgjidhja më e lehtë dhe më pak e rrezikshme mundet që në fund të fundit të provohet të jetë një autonomi e shtrirë në linja kombëtare".

EDITH DURHAM

Krajlica e Maleve

Mary Edith Durham, figurë mjaft e njohur për shqiptarët për kontributin e saj për çështjen shqiptare, shkrimtare britanike dhe udhëtare, vinte nga një familje e madhe dhe e begatë e Londrës Veriore. Babai i saj, Arthur Eduard Durham (1834-1895), ishte kirurg në Spitalin Gaj. Edith Durham ishte fëmija i madh i tetë vëllezërve dhe dy motrave, të cilët ishin të suksesshme në karrierën e tyre respektive në mjekësi dhe inxhinieri. Edith Durham udhëtoi dhe punoi në Ballkan. Ajo punoi për një shumëllojshmëri organizatash humanitare, pikturonte, shkruante si dhe ka mbledhur mjaft nga arti dhe folklori popullor. Puna e saj ka një rëndësi të mirëfilltë në fushën e antropologjisë. Durham shkroi shtatë libra mbi çështjet e Ballkanit, prej të cilave "*Shqipëria Malore*" (1909) që është më i njohuri. Ajo është dhe autore artikujsh të panumërt mbi folklorin shqiptar. Vizita e fundit e Edith Durham në Shqipëri ishte në vitin 1921. Më pas nuk ishte në gjendje të udhëtonte për arsye shëndetësore, megjithatë vazhdoi të punojë në emër të Shqipërisë për dy dekada të tjera. Ajo ishte një nga themelueset e Shoqatës Anglo-Shqiptare dhe shkruajti shumë artikuj për shtyp dhe letra të panumërta për të përqëndruar vëmendjen e publikut në Shqipëri. Në vitet e mëvonshme shtëpia e saj në Londër u bë qendër për miqtë e Shqipërisë dhe për shqiptarët në mërgim.

1912

SIR ROBERT GRAVES

Një mision otoman në tokën e pa zot të Turqisë Europiane

Sir Robert Windham Graves (1858-1934) ka qenë një diplomat britanik i lindur në Irlandë. Ai e filloi karrierën si përkthyes në Stamboll në vitin 1879. Ai hyri në shërbimin konsullor britanik, duke shërbyer në Perandorinë Osmane. Në vitin 1912, u bë këshilltar financiar i qeverisë turke dhe në atë cilësi në muajin e fundit të qeverisjes osmane shërbeu në Shqipëri. Ai shkruajti librin "Qendrat e Furtunës së Lindjes së Afërt", botuar në Londër n*ë vitin*1933.

Graves e ka kaluar në këmbë tërë Kosovën, Prizrenin, Gjakovën dhe qytete të tjera dhe na ka dhënë një pamje shumë interesante të periudhës përfundimtare të sundimit osman në Shqipëri. Në përshkrimet e tij vihen në pah vlerat dhe virtytet shqiptare, por për fat të keq edhe prapambetja e jashtëzakonshme, madje aq prapambetje sa nganjëherë ai e konsideron Shipërinë si një vend me "orë të ngecur" prej shumë shekujsh.

1912

AUBREY HERBERT

Anglezi që i hapi dyert e qeverisë britanike për shqiptarët

Diplomati dhe shkrimtari Aubrey Herbert (1880-1923) ka qenë vëlla me Lordin Carnarvon of Tutenkhamen. I lindur në një familje artistrokrate, ai kreu Universitetin Eton, e më pas studioi Histori në Balliol College në Oxford. Ai punoi atashe nderi në Ambasadën Britanike në Tokio (1902) dhe Konstandinopul (1904), si dhe udhëtoi jashtëzakonisht shumë nëpër viset e Perandorisë Osmane.

Si kandidat konservator, Herberti u zgjodh në Parlamentin Britanik në vitin 1911 dhe ndihmoi të bënte çështjen shqiptare të njohur gjatë periudhës pas pavarësisë. Në vitet 1912 dhe 1913 ai udhëtoi nëpër Ballkan. Në atë kohë u mbajt edhe Konferenca e Ambasadorëve në Londër, ku u përcaktuan kufijtë e Shqipërisë, në vitin 1913. Në kohën e Konferencës së Ambasadorëve ai themeloi Komitetin Shqiptar me qëllim për të ndihmuar delegacionin shqiptar në bisedimet e veta me Fuqitë e Mëdha dhe për të vepruar si një grup ndihmës, si dhe për të mbledhur fonde dhe tërhequr vëmendjen ndaj situatës së tmerrshme që sundonte në Shqipëri. Ky komitet shqiptar u kthye në atë që njihet si Shoqata Anglo-Shqiptare në vitin 1918 dhe Herbert u bë Presidenti i saj dhe më në fund mori emrin që

ka edhe sot "*Anglo Albanian Asociation*". Në vitin 1913 takoi Edith Durhamin dhe bashkëpunoi me të për të organizuar ndihmat humanitare. Ai ishte mik i Isa Boletinit dhe u kthye në një hero për shqiptarët. Ai i hapi dyert e FCO Isa Boletinit dhe Ismail Qemalit në vitin 1913, në atë takim historik ku Isa Buletini u quajt Robin Hudi shqiptar i armatosur me dy revole në Foreign Office në takimin me Sekretarin e Jashtëm Britanik Eduard Grey.

Në një moment të jetës së atij ju ofrua kurora mbretërore e Shqipërisë. Oferta për këtë post është përshkruar shumë bukur nga Charles Telford Ercikson[41] në një shkrim të posaçëm në veprën e tij "*Shqipëria Enigma e Ballkanit*". Ai thotë se i autorizuar nga Zogu dhe Noli, ai vajti në Londër të takonte Herbertin. Ai e gjeti atë në Parlament në seancë dhe e priti derisa mbaroi. Pinë një kafe dhe i tha se ai ishte autorizuar ti ofronte kurorën e Mbretit të Shqipërisë. Herberti pasi u mendua e ftoi Eriksonin të shkonin në çiflikun e tij në Pixton Park Dulverton, Sommerset County. Pas dy ditësh bisedime Herberti e ftoi Eriksonin në hollin e katit të parë të ndërtesës. Herbert pranoi të merrte kurorën e mbretit shqiptar por i tha Ericksonit se do ta pranonte atë, nëse operacioni që do të bënte do të shkonte mirë, pasi mjekët i kishin dhënë vetëm pesëdhjetë përqind siguri. Ericksoni iku me shpresë, por me të arritur në Amerikë, ai mësoi për vdekjen e Herbertit[42].

Kontributi i Herbertit është i jashtëzakonshëm dhe është pasqyruar në librin e Bejtullah Destanit "*Aubrey Herbert, Albania's Greatest Friend"*[43].

[41] Jeta e jashtëzakonëshme e amerikanit Charles Telford Erickson kushtuar Shqipërisë, botim i EduAlba, Tiranë 2012, faqe 223-228

[42] Bashkë me studiuesin Bejtullah Destani, themelues dhe drejtor i Institutit të Studimeve Albanologjike në Londër, e kemi vizituar atë shtëpi dhe kemi regjistruar pikërisht në atë vend ku Herbert dhe Erickson biseduan bashkë për këtë çështje. Aty erdhi edhe mbesa e Herbertit. Ndërkohë që stërnipi i tij Eduard Melone, oficer i ushtrisë britanike ishte i pari që hyri me forcat e NATO–s në Kosovë më 12 qershor 1999. Ai, hipur mbi një tank e kaloi kufirin në Vermicë duke thirrur: "*Unë jam nipi i mikut të shqiptarëve, Aubrey Herbert dhe kam ardhur të çliroj vendin e shqiponjave*".

[43]Aubrey Herbert and the Making of Modern Albania: Diaries and Papers 1904-1923

1948

MARGARET HASLUCK



Dhuruesja dhe themeluesja e bibliotekës Kombëtare Shqiptare

Margaret Masson Hasluck, e njohur gjithashtu si Peggy Hasluck, ishte dijetare dhe antropologe skoceze, lindur në një familje me besim të fortë kristian në Chapelton, në veri të Skocisë. Më e madhja nga nëntë fëmijët e asaj familjeje, ajo ka studjuar në Akademinë Elgin, në Universitetin e Aberdeen dhe pastaj në Neuham College, Cambridge, ku përfundoi me një diplomë në historinë dhe letërsinë klasike. Në vitin 1910, ishte femra e parë që fitoi një bursë për të studjuar në Shkollën Britanike të Arkeologjisë në Athinë dhe mori pjesë në gërmimet arkeologjike në Anadoll bashkë me Sir William Ramsy. Margaret Hasluck mori më pas dy bursa nga Universiteti Aberdeen që i dhanë mundësi për të udhëtuar dhe punuar në Ballkan, fillimisht për të mbledhur përralla popullore në Maqedoni. Nga viti 1923 e tutje, ajo kaloi pjesën më të madhe të viteve të saj në Shqipëri dhe banoi në qytetin e Elbasanit për 13 vjet. Hasluck botoi artikuj të shumtë, duke përfshirë edhe gramatikën e parë anglisht-shqip. Për shkak të punës së saj për zbulimin britanik gjatë Luftës së Parë Botërore, ajo u detyrua të largohet nga Shqipëria për në Athinë kur italianët aneksuan vendin në vitin 1939. Kur Athina u bë e pasigurt, ajo shkoi në Stamboll si vëzhguese, ku këshillonte zbulimin britanik dhe qeverinë mbi situatën në Shqipëri. Më vonë shkoi në Kajro, dhe në vitin 1945 u diagnostikua me leuçemi. Shkoi në Qipro dhe më pas në Dublin, ku vdiq më 18 tetor 1948. Bashkia e Elbasanit, në qershor 2010, ka përkujtuar 125-vjetorin e lindjes së saj dhe

ka përuruar një pllakatë përkujtimore në pronën e saj në Elbasan. Margaret Hasluck mban titullin *'Qytetare Nderi*', për *'kontributin e saj të shquar në sferën publike të qytetit të Elbasanit'*[44].

[44] Në muajin qershor 2015, Ambasada Shqiptare në Londër në bashkëpunim me AAA, kanë organizuar një veprimtari përkujtimore në nderim të kësaj gruaje të shquar që i kushtoi jetën Shqipërisë.

1913

ADHAM PEACOCK

The Wild Albanian[45]

Adham Peacock ka qenë një historian britanik, i cili ka studjuar në Cambridge dhe ka punuar si sekretar privat i Konsullit të Përgjithshëm Britanik në Shkodër, Sir William Kirby Greene. Ai ka shkruar librin: "*Shqipëria – Shteti i braktisur i Europës*", botuar në vitin 1914 në Londër.

Në librin e tij lexuesi gjen tituj si "*Në Europë dhe prapë ende jo në të*", "*Porta e Veriut të Shqipërisë*", "*Shkodra, lakmia e Malit të Zi*", "*Bulevardi Diplomatik*", "*Katolikët e Shkodrës*", "*Historia e Shqipërisë*", "*E ardhmja e Shqipërisë*". Ai ndalet tek shumë gjëra të historisë së Shqipërisë, kontributin për fqinjët, Italinë dhe Greqinë por edhe Perandorinë Osmane. Por më interesante është ajo që ai i atribuon shqiptarëve: Prejardhjen Ilire, gjuhën, faktin që janë të pamposhtur, madje kur flet për armët ai përmend që në vitin 1851 një armëtar shqiptar kishte hapur një ekspozitë armësh të zbukuruara në Hyde Park në Londër…[46]

Ky autor ka dhënë një perspektivë të Shqipërisë, duke përmendur fakte historike shpesh herë të përmendura edhe më parë, por jo aq të qarta:

> *"Në Durrës, pasi Shqipëria ishte bërë Provincë Romake prej Augustit, në vitin 58, kishte gjithësej 70 familje të krishtera dhe një prift me emrin Appollonius. Shqipëria Veriore zotëron një prej peshkopatave më të vjetra në botë dhe se ajo e Durrësit thuhet të jetë themeluar prej Shën Palit, i cili predikoi në Iliri dhe në Epir.[47] Është e sigurt se në Shqipëri kishte të krishterë pas përndjekjeve të Galerius-it. Në vitin 387 në Shkodër ishte një peshkop dhe në vitin 431 peshkopi Senecius i Shkodrës mori pjesë në Këshillin e Efesit".*

Historia e krishtërimit, atij katolik romak dhe ortodoks lindor është përshkruar nga ky autor në një mënyrë që ndoshta askush nuk e ka bërë më parë. Ndarja midis dy kishave, roli i Papës dhe i patriarkanës,

---

[45] *The Fortnightly Review*, London, May 1913. Reprinted by the Centre for Albanian Studies, London, October 2000.

[46] Ekspozita e Madhe Industriale ku morën pjesë tërë kombet, e cila njihet edhe si Ekspozita e Pallatit të Kristaltë u mbajt në Hyde Park, në Londër, nga data 1 Maj deri me datën 11 Tetor 1851. Ajo u organizua nga Princi Albert dhe Mbretëresha Viktoria dhe mbahet si një ndër panairet më të mëdha të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

[47] Wadham Peackok - Albania – The foundling state of Europe, New York, Dr Appleton and Company, 1914, Page 238

shndërrimi i shqiptarëve në fetë e ndryshme e dhënë me aq shumë fakte dhe i shpjeguar në detaje aq mirë, përbën një vlerë të padiskutueshme në literaturën historike për kombin tonë. Serbët, venecianët, turqit, Llazari dhe Dushani, shqiptarët e Tivarit e Ulqinit, Shkodrës e Raguzës të gjitha janë përshkruar me aq hollësi me data, emra dhe ngjarje. Evolucioni i krishtërimit që me Shën Palin, me Këshillin e Nikeas e të Efesit, varja e tridhjetë e tetë peshkopëve të Jubanit në Shkodër prej turqëve, themelimi i kolegjit të jezuitëve në vitin 1843, janë dhënë me aq shumë përpikmëri në librin e tij, duke përbërë kështu një burim reference me vlera të ralla. Historia e krishtërimit e shkruar prej Peacock shtrihet edhe në Shqipërinë e Mesme dhe më në jug të saj. Aty flitet për Peshkopatën e Arbanës të vitit 1166, e cila përfshinte Krujën dhe Mirditën. Pastaj mësojmë se i njëzetegjashti dhe i fundit i peshkopëve ishte Mark Skura. Më tej ai përshkruan Shkupin e përbërë prej shqiptarësh të krishterë, peshkopi i të cilëve gjendej në Prizren. Katolicizmi romak në Shqipëri sipas tij shtrihej në Orosh, Shkodër, Prizren Shkup etj.[48]

> *"Bismarku, me mospërfilljen e tij brutale të fakteve të cilat nuk i pëlqenin atyre pohoi, në Kongresin e Berlinit në vitin 1878, "Nuk ka nacionalitet shqiptar". Por Lidhja Shqiptare e Prizrenit provoi se ai ishte gabim bash në atë kohë kur ai po fliste për këtë çështje. Kombi shqiptar ofron një prej çështjeve më serioze që mbetet të zgjidhen prej Fuqive të Mëdha. Fatmirësisht për Europën, marrëveshja e Fuqive është aq e plotë në njëzëshmërinë e vet saqë Serbia, ai shteti Ballkanik, i cili kuturisi guximshëm të vijonte në linjat e diktimit të gabuar të Bismarkut, është detyruar me forcë të heqë dorë nga pretendimet e saj."*
>
> *Në të vërtetë shqiptarët përfaqësojnë pronarët e vërtetë të gadishullit, sepse serbët nuk e kishin kaluar Danubin, deri në vitin 550 të erës së re dhe, as bullgarët deri në vitin 679 kur shqiptarët i gëzoheshin njëmijë e njëqind vjetorit të zotërimit të tokës së gjallëruar prej luftërave të fiseve të vogla, betejave kundër ose nën mbretërit maqedon dhe luftërave me Romën. Në çdo qytet në çdo rajon, në të cilët sllavët mund të pretendojnë me të drejtën e pushtuesit nën disa perandori të mjegullta dhe tranzitore, shqiptarët mund t'i kundërshtojnë titullin e pronësisë origjinale të tokës që nga kohërat kur historia nuk i njihte sllavët si banorë të Ballkanit. Romakët, ndryshe nga shumë pushtues, të cilët erdhën pas tyre ishin administrator dhe, provinca ishte zakonisht më mirë nën sudimin e tyre".*

[48] Po aty faqe 256

Pastaj ai ndalet tek emërtimi "*shqiptar*", të cilin ia dedikon Pirros, gjeneralit, i cili kur i pa shtizat në ajër të hedhura prej bashkë-kombasve të tij, i quajti ata "*shqiptar*". Ndërkohë, emri "*Albanian*" vjen aty nga shekulli i XI–të, kur përmendet nga Robert Guiscard, i cili, pasi mposhti Perandorin Alexius Comnenus në Durrës marshoi drejt Elbasanit, i njohur me emrin Albanopolis. Ai e gjeti emrin vendas tepër të vështirë për gjuhën e vet e kështu e thirrën vendin me një emër më të lehtë, "*Albania*", thotë ky autor. Më tej ai vazhdon:

> *"Nuk ka të ngjarë që çlirimi i Greqisë të kishte ndodhur po mos të ishin luftëtarët shqiptarë, të cilët i dhanë shpirtin më të mirë luftarak asaj kryengritje. Admirali Miaoulis[49], Voulgaris, Boçari dhe shumë heronj të tjerë të fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë ishin shqiptarë ose me prejardhje shqiptare. Greku modern jeton me pasurinë letrare të helenëve të lashtë, ndërkohë që burrat e fortë të Shqipërisë, ashtu si dhe stërgjyshërit e tyre, të cilët jetuan përpara Agamenonit, janë hedhur në errësirë pasi ata nuk kanë askënd ti ndihmojë që të shihen më me vëmendje në Europë".*

[49]Miaoulis u lind në Euboea në një familje arvanitase dhe u vendos në ishullin Hydra në lindje të Moresë dhe njihej midis banorëve të ishujve si një tregtar drithërash shumë i pasur.

1914

DUNKAN HEATON – ARMSTRONG



Kryengritja në Mbretërinë gjashtëmuajshe

I lindur nw vitin në vitin 1886 në shtëpinë e mëmës së tij në Velden të Austrisë afër kufirit me Sllovenínë dhe Italinë, Dunkan Heaton–Armstrong ka qenë një kapiten irlandez, i cili shërbeu si sekretari privat i Mbretit Wiliam Widi në vitin 1914, në Shqipëri. Ai ishte i biri i Wiliam Charles Heaton- Armstrong dhe zonjës së tij Bertha e bija e Baronit Zois-Edelstein of Chateau d'Egg, Velden Austria. Me datën 7 janar 1914, ai zbriti bashkë me Widi-n në Durrës, pa ditur asgjë rreth Shqipërisë. Atë e shtyu të aplikonte thjesht prirja për aventura për të shërbyer në Shqipëri dhe fitoi midis 500 kandidatëve. Ai vetë thotë se, e mori atë detyrë thjesht, sepse po kërkonte diçka për karrierën e tij. Ai ishte protestant nga feja, fliste gjermanisht shkëlqyeshëm dhe ishte përkthyes i klasit të parë në frengjisht dhe italisht.

Në librin "*6 Muaj Mbretëri*" të botuar nga Instituti i Studimeve Shqiptare në Londër ai na jep të plotë dhe të qartë jetën e shkurtër të kësaj mbretërie fallco të ngritur nga Fuqitë e Europës pas shpalljes së pavarësisë dhe Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Në librin e tij jepet një pasqyrë e dhimbshme e asaj kohe kaotike që çdo ditë e më shumë e vinte në dyshim jo qeverisjen, por vetë ekzistencën e shtetit shqiptar.

1915

NORMAN DOUGLAS



Rrëfimtari i famshëm britanik që i përshkroi arbëreshët e Kalabrisë së Vjetër[50]

Norman Douglas (1868-1952) ka lindur në një fshat austriak të quajtur Thüringen afër Bludenz me nënë austriake dhe baba skocez. Ai ka marrë mësime në Skoci, Angli, Gjermani dhe Francë. Shërbeu si diplomat për një periudhë të shkurtër por karriera e tij u ndërpre për shkak të një skandali në vitin 1886. Më pas emigroi dhe u vendos në Napoli të Italisë. Ai ka shkruar një seri veprash interesante, por veprat e tij më të vlerësuara janë "*Era e Jugut*" dhe "*Kalabria e Vjetër*" Në këtë vepër ai jep një përshkrim tepër interesant të arbëreshëve të Italisë, fenë e tyre të krishterë, të dyjëzuar, gjuhën shqipe me tridhjetë alfabete, fshatrat dhe, ajo që bie në sy, për fat të keq, ruajtja e sjelljes ndaj natyrës e shqiptarëve arbëreshë, njësoj si shqiptarët e vendit të origjinës, siç është çpyllëzimi, çrregullsia në ndërtime dhe mënyra e mbajtjes së mjediseve të brendëshme në shtëpia si dhe në rrugët me kalldrëm.

Norman Douglas mendohet të jetë i pari udhëtar britanik që shkel dhe shkruan për zonat arbëreshe të Italisë së Jugut. Ai, me gjuhën e tij të mrekullueshme në fakt i ka dhënë një njohje të jashtëzakonshme kulturës shqiptare në Itali, figurave si Francesco Crispi, ndihmesën e dhënë Garibaldit prej arbëreshëve. Por ajo që bie më shumë në sy është studimi

[50] Old Calabria

që ai i ka bërë Jeronim De Radës. Më poshtë disa nga vlerësimet e tij për ato vise të populluara me shqiptarët e Italisë:

"Këto fshatra jo-italiane datojnë nga shekujt pas vdekjes së Skënderbeut kur Sulltani (The Grand Signor) e përforcoi pushtetin e tij. Refugjatët arritën grumbuj – grumbuj nga deti. Atyre iu dhanë toka të egra ku do të vendoseshin. Të ardhurit e rinj u morën për bizantinë. Kolonitë e shqiptarëve u shpërndanë nëpër tërë Italinë e Jugut më së shumti në Apulia, Calabri dhe Sicili. Disa u vendosën dhe në veri edhe në qendër. Ishte edhe një vendbanim në Lumin Po, por që është reduktuar në 200 banorë; shumica e tyre më vonë janë absorbuar dhe shkrirë brenda elementit italian. Sipas Angelo Masci [51] (1846) ai thotë se janë 59 fshatra të tyre, me 83 mijë banorë – veçanërisht në Siçili; Morelli (1842) ku numri i përgjithshëm i arbëreshëve për Italinë dhe Siçilinë është tek 103.466. Nëse ky numër është i vërtetë, atëherë kjo shumë tani duhet të kalojë të dyqindmijët. Unë mora vesh se tani gjenden 80 fshatra të populluara prej arbëreshëve me nga 2.500 banorë secili po të llogarisim edhe ata që kanë emigruar në ShBA.

Gjuha shqipe tashmë zotëron më shumë se tridhjetë alfabete të ndryshme, secili me më shumë se tridhjetë germa. Gjithsesi, në këto katërqind vjetë ata nuk e kanë ndarë mendjen se cilin do të mbajnë."

Më pas Norman Duauglas ndalet tek themeluesi i vërtetë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Jeronim De Rada. Ai pasi përshkruan jetën e tij, vështirësitë, dramat e tmerrshme familjare, faktin që ai nuk kishte udhëtuar kurrë jashtë, madje as në vise të tjera arbëreshe brenda Italisë, ai thotë:

"*Lamartini në vitin 1844 shkruante:*
Shkrimet e tij të shumëllojshme – dhe padyshim risia e temës së tij qendrore – tërhoqën vëmendjen e gjuhëtarëve dhe filologëve gjermanë të kohës, të tërë të dashuruar pas lirisë, folklorit dhe poezisë. Shkrimtari i njohur italian Cantù, e vlerësoi atë shumë lart kur tha: ''Unë jam i lumtur për vëllazërinë poetike dhe politike që ekziston midis teje dhe meje. Poezia erdhi nga brigjet tuaja dhe duhet të kthehet andej nga erdhi''. Herman Buchholtz zbulon tek ai skena të denja për shkrimet e Shekspirit dhe pasazhe madhështore të denja për skena

[51] I lindur në Santa Sofia d'Epiro më datën 7 dhjetor, 1758, ai lëvizi që aty për në Napoli, për të vijuar studimet e Xhuzepe Bugliarit në Batalionin Mbretëror Maqedon të Napolit. Në vitin 1810, ai arriti të bëhej komisioner i Kalabrisë veriore dhe Bazilikatës.

eskiliane në tragjedinë e tij Sofonisba. Dijetari i madh Gladstone thuhet se i shkruajti një kartolinë ku e lavdëronte për përpjekjet e tij në emër të vendit të vet.[52]

Ishte ai që krijoi gjuhën letrare të vendit të tij, që hyjnizoi lidhjet midis Shqipërisë dhe Pellazgëve dhe që formuloi ambiciet e saj politike. Deri në atë kohë ajo ishte thjesht një mit".

[52]Old Calabria, faqe 191

GEORGE PHILLIPS

George Fraser Phillips, figurë ushtarake britanike, arsimuar në Shkollën e Uppingham në Rutland (Angli), u bashkua me Regjimentin e Yorkshire West në vitin 1885, duke shërbyer nga 1897 si komandant i batalionit të dytë. Kur Shkodra u vu nën administrimin ndërkombëtar në vitin 1913, Kolonel Phillips u zhvendos në Shkodër bashkë me batalionin e tij, për të përforcuar kontingjentin britanik në verën e atij viti. Në vjeshtën e vitit 1913 ai zëvendësoi Sir Cecil Burney si kreu i administratës ndërkombëtare, duke u bërë kështu guvernator virtual i Shkodrës, derisa forcat u tërhoqën në vitin 1914. Gjatë vitieve 1915-1916, Phillips shërbeu si Atashe Ushtarak në Beograd dhe gjatë 1916-1918 ishte kreu i Komisionit të Kontrollit Ushtarak të Forcave Aleate në Greqi. Nga viti 1918 deri në daljen në pension në vitin 1920, ai kryesoi Misionin Ushtarak Britanik në Shqipëri dhe në Mal të Zi. Gjeneral Phillips ishte autor i një memorandumi mjaft të njohur mbi situatën e përgjithshme në Shqipëri, datuar më 31 dhjetor 1918.

HARRY HODGKINSON

Harry Hodgkinson (1913-1994), gazetar britanik dhe shkrimtar, u lind në Kirkham, Lancashire, dhe filloi të shkruajë për gazeta në një moshë të herëshme. Hodgkinson vizitoi Shqipërinë në vitin 1937, u dashurua pas vendit dhe u bë anëtar i Shoqatës Anglo-Shqiptare menjëherë pas kthimit të tij në Angli. Ai korrespondon për shumë vite me rradhë me Edith Durhamin. Hodgkinson shërbeu si sekretari privat i Sir Archibald Sinctair, kreu i partisë Liberale Britanike. Ai iu bashkua Marinës Mbretërore në vitin 1942 si oficer i zbulimit me përgjegjësi të veçanta për Shqipërinë. Me rënien e regjimit të Musolinit në Itali, u transferua në Speciale Operations Ekzekutive (SOE) në Bari. Ai mbulonte Shqipërinë dhe Jugosllavinë gjatë dhe pas pushtimit gjerman. Pas luftës, Hodgkinson vazhdoi të punonte për marinën, duke qenë i përfshirë ngushtë edhe në çështjen e incidentit të kanalit të Korfuzit në vitin 1946. Në vitin 1955, ai u largua nga marina për të punuar në industrinë e naftës deri në daljen në pension, në vitin 1972. Më pas, Hodgkinson i kushtoi shumicën e kohës së tij Shoqatës Anglo-Shqiptare dhe u bë president i saj në vitin 1985. Hodgkinson është autor i librit "*Deti Adriatik*", Londër 1955, dhe i një biografie për Skënderbeun, botuar në Londër në vitin 1999. Dorëshkrime të tjera me interes për çështjen Shqiptare janë ende të pabotuara.

2015
AGJENTËT PERANDORISË



'Nëse dikush dëshironte të bënte tregti me Perandorinë Osmane ishte shumë e rëndësishme të njihte një shqiptar'.

Në verën e vitit 2015, Sir Noel Malcolm, profesor i kolegjit All Souls College Oxford botoi librin "Agjentët e Perandorisë". Ky libër, pas atij, "Kosova – Një Histori e Shkurtër" i po këtij autori jep një përshkrim nga më interesantët mbi shqiptarët në Ballkan. Ai shpalos në këtë vepër aftësitë drejtuese të shqiptarëve në elitën veneciane dhe në atë osmane. Noel Malcolm, na tregon një histori të panjohur të vendit tonë, deri më sot. Pas njëzet vjet hulumtimesh në dokumentat më të pluhërosura të arkivave më të mëdha si ato të Vatikanit, Vjenës, Stambollit, Venedikut, Raguzës, Varshavës, Maltës, ai vjen me një histori sa interesante aq edhe intriguese të një familje shqiptare në Ulqinin e shekullit të XVI - të, aty ku ndahej kufiri lindje – perëndim.

Familja e madhe shqiptare ndahet në dy pjesë, Bruni dhe Bruti. Njëri i shërben Perandorisë së Venecias tjetri asaj Osmane. Dhe vjen një ditë që ata do të ndesheshin midis tyre në krye të ushtrive të dy Perandorive në Betejën e Lepantos[53]. Në atë betejë ku vritet njëri prej tyre, tjetri mund të ketë qenë 100 metra larg duke luftuar në anën tjetër të frontit.

Revista "The Economist"[54] shkruan:

[53] Beteja e Lepantos është zhvilluar me datën 7 tetor 1571 midis Flotës së Lidhjes së Shenjtë, një koalicion i marinës së shteteve katolike të Europës Jugore të drejtuar nga Spanja dhe flotës së Perandorisë Osmane në Gjirin e Korinthit, në Greqi dhe u fitua prej të parëve duke ndaluar zgjerimin e Perandrosë Osmane drejt pjesës europiane të Mesdheut.

[54] The Economist, Politics in the 16th century, Mediterranean and its relevance to the modern Balkans, 23.05.2015

"Libri i Noel Malcolm tregon në mënyrë gjeniale ekuilibrin ndryshues të forcave midis Perandorive Veneciane dhe asaj Osmane, ku fuqitë detare ishin në konkurrencë se kush do të zotëronte Mesdheun Lindor dhe se si disa të krishterë jetonin mirë duke i shërbyer Perandorisë Osmane ndërsa disa myslimanë depërtonin brenda Perandorisë Veneciane".

Gazeta tjetër "The Telegraph[55],[56]" e quan librin:

"Një arritje të mrekullueshme të gërshetimit të historive të fituesve dhe humbësve të shekullit të XVI – të, me ndërmjetësuesit, kalorësit, piratët, priftërinjtë dhe spiunët".

Gazeta "The Guardian"[57] thotë:

"Kjo vepër e mrekullueshme e Noel Malcolmit i përdor historitë e ndërthurua të dy familjeve shqiptare Brunit dhe Brutit – si një prizm nëpërmjet të cilit të shohim kontaktet dhe konfliktet që e karakterizojnë Mesdheun në fazën e tij të hershme të periudhës moderne. Si diplomatë, spiunë, priftërinj, ushtarë, tregtarë dhe përkthyes, ata janë të levizshëm dhe flasin shumë gjuhë. Prej rrënjeve të tyre shqiptare, lidhjeve farefisnore dhe kontakteve të shtrira gjithandej, ata i tejkalojnë barrierat e fesë dhe kombësise. Më tej shton se rezultati i kësaj vepre është mahnitës (dhe do të duhet kohë që të tejkalohet për nga rëndësia). E pasur dhe e detajuar; aty gjëndet ndërthurja e hollësishme e historisë mesdhetare që përfshin "tërë shqiptarët, kaq të neglixhuar, që enden brenda historisë së Europës së shekullit të 16 – të".

Në lidhje me këtë libër të tij të radhës, vetë Sir Noel Malcolm thotë se në shekullin e 16 kishte shumë mënyra për të qenë shqiptar:

"Ata luajnë rol të rëndësishëm për fuqitë e mëdha në Perëndim dhe nga ana tjetër kanë pozicione kyçe në Perandorinë Osmane. Në librin tim kemi një pjesëtar të familjes që është krypeshkop shumë i rëndësishëm i Kishës Katolike, ndërkohë që një tjetër punon për Papën si oficer i lartë ushtarak. Ata gjënden në ushtrinë e Mbretit të Spanjës dhe janë kalorësit më të shquar. Në

[55] Daily Telegraph, Christopher House 23.05.2015
[56] Daily Telegraph, Jerry Brotton, 13.06.2015.
[57] The Gardian - John Gallagher 10.06.2015

anën tjetër një kushëri i tyre bëhet një nga pashallarët më të rëndësishëm në Stamboll dhe arrin të bëhet Vezir i Madh. Më në veri, në Moldavi, një tjetër shqiptar luan një rol të jashtëzakonshëm. Është e vështirë të përgjithësosh rolin e shqiptarëve në atë periudhë, por kur sheh pozicionet e rëndësishme që ata kanë mbajtur në politikë, shoqëri dhe ushtri, vjen në përfundimin se ata gjëndeshin kudo. Madje shumë prej shqiptarëve janë kaq të talentuar, sa kapin bash majat e pushtetit. Nuk dihet saktësisht numri i tyre, pasi përkatësia etnike e pashallarëve mbetet ende një çështje e paqartë, por në Perandorinë Osmane ka patur dyzet vezirë të mëdhenj shqiptarë. Mendoj, se periudha për të cilën bëhet fjalë në librin tim është periudha më e mirë e shqiptarëve në postet më të larta të qeverisë osmane. Unë ndalem te Sinan Pasha Topojani që ishte Vezir i Madh, pesë herë. Gjatë qeverisjes së tij, gjëndeashin edhe dy tre shqiptarë të tjerë në Divan, që ishte Këshilli i Ministrave i asaj kohe. Unë i jam referuar një raporti të një diplomati austriak, që thoshte: 'Nëse dikush dëshironte të bënte tregti me Perandorinë Osmane ishte shumë e rëndësishme që të njihte një shqiptar".

Ky libër ka patur vlerësime shumë pozitive nga media britanike e cila njihet për natyrën e vet tepër kritike. Një prej gazetarëve më të njohur në Britaninë e Madhe, i quajtur Harry Eyres, i cili ka një lidhje të veçantë me Shqipërinë, pasi stërgjyshi i tij, ka qenë ambasadori i parë britanik në Shqipëri nga viti 1922-1926 ka shkruar në revistën prestigjioze "Newsweek"[58]:

"Shqipëria mbart shumë vlera që prej lashtësisë, por vazhdon të mbetet një mister për Perëndimin. Shqipëria më tërheq shumë, thotë ai, pasi stërgjyshi im[59] i ka qëndruar shumë afër babait tim, ndaj unë mund të them, se kam një lidhje të ngushtë me Shqipërinë".

Për këtë libër ka folur edhe historiani dhe shrimtari më i madh anglez ende i gjallë sot, Paul Johnson[60]. Ai shpreh pikpamjen se Noel Malcolm ka paraqitur një histori të jashtëzakonëshme të shqiptarëve dhe vijon traditën angleze rreth Shqipërisë, e njohur që nga veprat e Lord Bajronit dhe Eduard Learit, në përceptimin e britanikëve për shqiptarët. Ai thotë mes tjerash:

[58] Newsweek, 11.06.2015, by Harry Eyres: Europe's internal frontier: Albania has long been a mystery to the West.

[59] Sir Harry Charles Augustus Eyres, Ambasador i Britansë së Madhe në Shqipëri, 1922-1926

[60] Paul Bede Johnson i lindur në vitin 1928 është gazetar, historian, autor i pesëdhjetë librave. Ai është shkrimtari më i madh ende i gjallë në Britaninë e Madhe. Vlerësimet e tij për librat e historisë janë më të konsideruarat dhe më të pranuarat nga opinioni i gjërë dhe elita intelektuale angleze.

"Shqipëria është një vend shumë i bukur. Është përshkruar në një mënyrë të tillë edhe nga Lordi Bajron. Eduard Lear e pikturoi mrekullisht dhe shkruajti një libër të bukur për Shqipërinë. Shqipëria ka tërhequr syrin e personazheve kryesorë britanikë. Ata e deshën Shqipërinë, shkruajtën për të dhe e pikturuan atë. Shqipëria mund të bëhet sërish shumë e rëndësishme. Kjo për shkak të pozicionit të saj gjeografik. Ajo është kyçi i Adriatikut. Është një vend shumë i rëndësishëm. Vetë shqiptarët janë njerëz shumë të zgjuar, dinamikë dhe origjinalë. Kanë shumë cilësi që i favorizojnë ata. Unë mund të ve bast për Shqipërinë. Ata do të luajnë një rol të rëndësishëm në botë"[61].

Ky libër i Sir Noel Malcolm, zë tashmë një vend nderi jo vetëm në literaturën historike në Shqipëri por në çdo bibliotekë të botës sot. Mjafton të përmendim faktin se gazetat më prestigjoze angleze e kanë sjellë "cështjen e neglizhuar shqiptare", në vemendjen e lexuesit elitar britanik dhe më gjërë për disa ditë rrjesht duke i dhënë shqiptarëve vend qendror në historinë e atyre kohërave të përshkruara nga Noel Malcolm. Në vijim të librave për shqiptarët ai boton edhe librin tjetër kushtuar Ernesto Cozzi[62], një prift katolik italian që i kushtoi jetën albanologjisë[63].

[61] Intervistë e Paul Johnson dhënë gazetarës Erisa Zyko, transmetuar nga ABC News, Londwr, qershor 2015.

[62] Noel Malcolm – Ernesto Cozzi (1070-1926) A neglected figure in Albanian Studies and in the History of Albania, Dispense e pabotuar.

[63] Ky artikull është botuar në Gazetën Panorama me datën ./gusht, 2015

KAPITULLI I DYTË

NGJARJET KRYESORE QË I KANË DHËNË FORMË MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO - BRITANIKE

Marrëdhëniet midis dy vendeve, popujve dhe qeverive tona kanë marrë formë nëpërmjet të një radhe veprimtarishë diplomatike ndërkombëtare. Disa prej tyre kanë rëndësi kritike për Shqipërinë. Këto ngjarje janë përshkruar në këtë libër për ta vënë atë në disa shtylla të fuqishme mbi të cilat qëndrojnë marrëdhëniet tona. Britania ka qenë përherë aktor kryesor i zhvillimit të ngjarjeve, negociatave dhe arritjes së marrëveshjeve. Në lidhje me këto ngjarje, përgjithësisht, historiografia shqiptare ka qenë kritike, dhe brezat tanë të tërë, të lindur në shekullin e njëzetë janë mësuar të dëgjojnë vetëm variantin negativ të qëndrimeve britanike. Natyrisht, momente të tilla si Traktati i Fshehtë i Londrës, (ky Britania nuk është palë e vetme) nuk mund të mos trajtoheshin me një sens tejet kritik. Por shumë pak kemi dëgjuar se cili ka qenë roli i britanikëve në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, apo në Lidhjen e Kombeve, në Gjenevë. Po agjentët britanikë të SOE – përse e dhanë jetën në truallin shqiptar? A ishte Britania për zhdukjen e Shqipërisë nga harta e Europës, siç e dimë që kishte të tillë midis Fuqive të Mëdha, apo ishte për një shtet shqiptar, siç ndodhi në të vërtetë? Po ne shqiptarët çfarë ofronim në atë periudhë në tryezën e bisedimeve ku uleshin britanikët? Sa kryengritje të mëdha dhe çfarë rezistence të organizuar hasnin trupat e fqinjëve tanë, të cilët është e vërtetë se kishin mbështetje ose nga nga një fuqi e madhe ose nga një tjetër, për të rrëmbyer territoret tona? Përvçse të luajmë rolin e viktimës, çfarë ditëm të bënim ne në atë kohë?

Prandaj duhet të shohim se si zëra të fuqishëm të politikës britanike u ngritën në mbrojtje të vendit tonë. Shqipëria u njoh si shtet i pavarur dhe u vu nën kujdesin e Europës, falë patriotëve tanë por edhe përpjekjeve britanike. Por edhe pse mbretëri komike, Shqipëria e drejtuar nga Princ Wiedi, ndoshta do të qëndronte në këmbë në kufijtë e vitit 1913, nëse grupe bashibozukësh injorantë nuk do të kërkonin përsëri "babën". Përzënja e tij, kaosi i Luftës së Madhe në Europë dhe kaosi që shkaktuan vetë shqiptarët do të jipte avantazhe lakmive të fqinjëve dhe disavantazhe miqëve tanë dhe vetë Shqipërisë. Në një raport të Foregn Office të vitit 1921, del qartë se çfarë kursi ka ndjekur politika e këtij vendi, deri në atë kohë,dhe si janë shprehur politkanë të atij vendi, miq të Shqipërisë si Lord Balfour, Lord, Lamington, Kolonel Herbert, Lord Sydenham, Lord Newton, Lord Cecil, etj. Le të shohim disa prej ngjarjeve kryesore që i kanë dhënë formë këtyre mardhënjeve.

1878

Kongresi i Berlinit
"*Memorandum to Lord Beaconsfield*"

Kongresi i Berlinit u mbajt prej Fuqive të Mëdha, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Austro Hungarisë, Italisë dhe Rusisë, në qershor dhe korrik të vitit 1878 për të rishikuar Traktain e Shën Stefanit në të cilin Rusia iu imponua Perandorisë Osmane atë vit si dhe për të krijuar një situatë marrëdhëniesh politike stabël në Ballkan. Kongresi u drejtua nga Otto Bismark, i cili vepronte si "ndërmjetës i paanshëm". Kongresi njohu pavarësinë e Serbisë, Malit të Zi dhe Rumanisë dhe bëri shumë rregullime për një Bullgari më të vogël edhe pse autonome. Asgjë nuk u bë për Shqipërinë.

Shqiptarët i dërguan një memorandum Lordit Beconsfield (Benjamin Dizraelit) në fillim të Konferencës. Mendohet se memorandumi është shkruar nga Vaso Pashë Shkodrani. Përkundër këtij apeli, interesat e shqiptarëve u injoruan plotësisht dhe territoret shqiptare u lanë nën kontrollin e Perandorisë Osmane. Udhëheqësit shqiptar*ë* reaguan duke themeluar Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.[64]

Është interesante të shihet sesa shumë shpresë kishin vendosur shqiptarët tek Benjamin Dizraeli dhe çfarë zhgënjimi përjetuan ata prej mospërfilljes së tij.

Do të ishte me interes të njiheshim me pikat e këtij memorandumi, pasi shpesh flitet por jo dhe aq mirë dihet. Prandaj po paraqes të shkurtuara pikat e tij[65]**.**

> *Ata i drejtohen kryeministrit anglez me fjalën "Shkëlqesi" dhe kërkojnë të dëgjohet zëri i shqiptarëve në këtë mbledhje të Fuqive të Mëdha; shqiptarët duhen dëgjuar, sepse nuk kanë një qeveri ose organizatë të vetme që flet për ta; ajo nuk mund të përfaqësohet nga otomanët; shqiptarët ruajtën karakterin e tyre kombëtar në kushtet e pushtimit osman dhe ndarjeve fetare; nga Buna në Janinë, shqiptarët janë një komb kompakt me identitet të qartë; parardhësit tanë e kanë mbrojtur qytetërimin europian duke u shkatërruar për vete; propaganda greke është përdorur për të vënë në dyshim territoret shqiptare; shqiptarët*

[64]Robert Elsie, Historical Dictionery of Albania
[65] Robert Elsie, website i studimeve te tij rreth Historisë së Shqipërisë

janë të ndryshëm nga sllavët dhe grekët dhe nuk janë përzier kurrë me ta, përkundër influencave fetare; ne i kemi rezistuar me forcë shtypjes turke për mëse katër shekuj dhe nuk jemi asimiluar; Porta e lartë nuk na la të qeverisemi, na i mori djemtë, lulen e kombit për të luftuar në Lindje; Shqipëria ka shumë qeveri fisnore që do të thotë se nuk ka qeveri fare; zëri i popullit shqiptar është shumë i dobët për t'u dëgjuar prandaj kërkon mbështetjen e Fuqive të Mëdha; Austria ka shumë interesa dhe nuk e fsheh dot dëshirën për ta kthyer Adriatikun në një liqen të saj duke u shtrirë në portet shqiptare; Italia bën të njejtën gjë; me përjashtim të Rusisë që ka interesa në rajon, Fuqitë tjera të Mëdha janë larg dhe pa interes që të mbrojnë Shqipërinë; Prandaj vetëm Britania e Madhe mund të marrë parasysh kërkesat tona dhe më pas edhe të tjerat pasi të kenë kuptuar ekzistencën tonë politike ndërkohë që principet e kombësisë janë bërë dominuese tashmë; Britania ka interes të madh të krijojë një kordon të pathyeshëm për të ndaluar avanicimin sllav drejt Adriatikut dhe këtë mund ta bëjmë vetëm ne. Sllavët nuk hezitojnë të avancojnë pas krijimit të mbretërisë bullgare dhe asaj malazeze këta të fundit mbi fortesat shqiptare; tani që Rusia, ajo që njëherë e një kohë depërtoi dhe iu imponua Europës duke folur në emër të fesë kristiane, i ka shpalosur hapur interesat e veta ndaj Shqipërisë dhe kërkon zhdukjen e saj nga harta e Europës; - ky është kthim mbrapa i fiseve shqiptare, të cilët mezi po prisnin rastin që të hiqnin qafe zgjedhën turke duke penguar një aleancë të Malit të Zi, i cili është si pararoja e ushtrive ruse; - Rusia dhe Austria përkundër kontraditave që kanë me njëra-tjetrën deshën ta përpijnë dhe asfiksojnë kombin tonë; - ashtu sikundër që nuk jemi dhe as që duam të jemi turq, nuk jemi as sllav, austriak dhe as grek. Krejt çfarë duam të jemi është të jemi shqiptar; -Ishte frika e humbjes së kombësisë tonë që na bëri të mos lëvizim, jo indiferentizmi ndaj rënies së Perandorisë Osmane. Përndryshe ne do të bashkonim forcat në revoltë bashkë më kombet e tjera; - Është e rëndësishme që Europa të vlerësojë që kjo ka qenë sakrifica më e madhe dhe më e dhimbshme që kemi bërë për Europën; - Shqipëria ka një vend të lavdishëm në analet e historisë që nga Skënderbeu deri tek Marko Boçari që nga Lekë Dukagjini deri tek Ali Pashai, të cilët kanë ruajtur karakterin kombëtar dhe mbajtur përkushtimin ndaj pavarësisë; - shqiptarët kanë luftuar maleve për të mbrojtur vatrat e tyre të të parëve përkrah ushtrive të kombeve të tjera; - karakteri ynë kombëtar, të cilin nuk e mohon askush që ka luftuar për katër shekuj kundër osmanëve, nuk duhet që në këtë kohë civilizimi të zhduket prej veprave të aleatëve europinë. Europa është mbledhur për të sanksionuar të drejtat legjitime të kombeve, të cilat u mendua se

përfunduan me Traktatin e Shën Stefanit; - Europa e ka kuptuar që në vend që të sillte paqe ky traktat nxiti luftra edhe më të tmerrshme. Ai ndihmoi të imponontе sundimin sllav në shumë rajone që ishin greke ose të predominuara prej grekëve, duke shtrirë sundimin që nga brigjet e Detit të Zi, deri në Adriatik e Egje, ndërsa Mali i Zi u zgjerua drejt zemrës së Shqipërisë që ajo të përdorej si avanpost i Rusisë dhe lakmive të saj grabitqare;- Rumania u gjymtua nga pjesë të saj të rëndësishme; - Serbia megjithëse një vend sllav ka fituar vetëm disa territore të vogla; - është e qartë se qëllimi i Rusisë është të sundojë Thrakën, Bosforin, Bullgarinë dhe Shqipërinë; - Nëse Rusia ka marrë shpatën në dorë për të çliruar të krishterët nga shtypja turke pse i ka braktisur shumë prej tyre? Vetëm bullgarët dhe malazezët paskan të drejtë të shpallin pavarësinë? Po popujt e tjerë që luftuan për liri – grekët, shqiptarët dhe rumunët – janë mallkuar të jetojnë përjetë si raja? Apo këta popuj duhet të zgjedhin vetëm midis zgjedhës dhe sllavëve? Fuqitë europiane nuk mund të japin bekimin për një padrejtësi të tillë; - nuk do të ketë paqe të qëndrueshme në Lindje nëse shpërbërja e Perandorisë Osmane nuk do të zëvendësohet në një formë të re të kombeve që e përbënin atë; - është e drejta dhe e mira e kombeve sllave të formojnë një ose dy vende autonome, por po aq e drejtë është që tërë grekët të jetojnë të bashkuar në një shtet, dhe tërë shqiptarët të kenë pavarësinë e tyre të njohur; Shqipëria nuk mund të bashkohet më Greqinë për shkak se ekzistojnë dallime në gjuhë, costume e kulturë. Shqipëria kurrë nuk do të pranojë dominimin sllav nga do që të vijë, Bullgaria apo Mali i Zi, lëre pastaj po të jetë turk, kur ajo ka luftuar në mënyrë të paepur për katër shekuj; ne mund të kemi ndryshuar pak në fe, por përherë kemi mbetur shqiptarë; në pikpamje politike nuk duhet harruar se Shqipëria është e destinuar të shërbejë si një barrierë natyrore kundër pushtimeve sllave siç ka qenë edhe më përpara gjatë ekspansionit Osman; Europa e verbër dhe e ndarë, Europa e shekullit të nëntëmbëdhjetë nuk duhet të bëjë të njejtin gabim që bëri në shekullin e pesëmbëdhjetë; me një popullsi prej njëmiljon e gjysëm. Shqipëria mund të mbajë dyzet mijë ushtarë luftëtarë të sprovuar; pozita gjeografike dhe terreni malor e bën atë një vend të pathyeshëm nga pushtuesit; Një Shqipëri e pavarur nuk do të shërbejë vetëm si mburojë ndaj pushtimeve slave, por edhe si një faktor stabiliteti dhe sigurie; Po të shihet Shqipëria nga një aspekt pozitiv ligjor mund të shquhet menjëherë që po të jetë autonome dhe e pavarur nuk sjell asnjë problem ndaj qeverisë osmane. Ajo e ka ruajtur përherë autonominë e vet në mënyrë fisnore. Dallimi i vetëm me vendet e tjera është se ata janë sunduar nga gospodarët ose princat vasalë; si e tillë duhet vetëm të konfirmohet dhe ruhet status- quoja, pasi i vetmi dallim

është forma politike dhe administrative e organizimit dhe kalimi nga përqëndrimi i fuqisë në një dorë kalimtare, në atë të shumë duarve; - kështu, nëse duhet ruajtur integriteti i Perandorisë Osmane, këtë nuk e prek njohja e pavarësisë së Shqipërisë; Ne përherë jemi gjykuar padrejtësisht; - Nuk është e drejtë të braktiset Shqipëria në këto momente; - është në interes të Austrisë, Malit të Zi, Greqisë, dhe Bullgarisë së re, që të kenë edhe një Shqipëri me qeveri të organizuar dhe shoqëri të civilizuar; - Mos ti shkojë mendja dikujt se Shqipëria do të bëhet në marrëveshje me Turqinë! - Vetëm një komision ndërkombëtar mund ta bëjë këtë; - Nëse do të përzihej Turqia në këtë çështje ne më mirë rrimë në këtë gjendje anarkie sesa të sakrifikojmë pavarësinë tonë; - Shqiptarët do të mblidheshin rreth shqiponjës së zezë nën flamurin e një princi dhe nuk do pranonin askënd që nuk flet shqip.

Ata i drejtohen përsëri Dizraelit:

"Nga këto që i thamë Shkëlqësisë Tuaj, në emër të popullit tonë del e qartë se:

1.Duhet të ngremë një shtet shqiptar që të jetë barrierë ndaj ekspansionit sllav;

2. Nëse kjo barrierë natyrore nuk ndihmohet, atëherë Europa do të gjendet përsëri si në shekullin e gjashtëmbëdhjetë kur vetëm një mrekulli e shpëtoi nga hordhitë osmane në dyert e Vjenës;

3. Nëse ka dëshirë për paqe të qëndrueshme në lindje, atëherë shtetet duhen ndërtuar bazuar në kombet e secilit vend;

4. Shqipëria është një komb i vetëm me gjuhë, tradita, histori dhe tërë elementët e tjerë përbërës të identitetit kombëtar prandaj duhet të jetë nën një qeveri të vetme;

5. Kjo qeveri duhet të jetë kombëtare, të dalë nga gjiri i vendit dhe të drejtohet nga një dinasti kombëtare;

6. Puna për ndërtimin e saj nuk duhet t'u lihet turqve, por përfaqësuesve të fuqive Europiane;

7. Ky shtet dhe ato që po dalin nga rrënojat e Perandorisë Osmane duhet të sigurohen nga Fuqitë e Mëdha.

Britania e Madhe, vend i lashtë dhe mjeshtre e lirisë për tërë popujt pararojë midis të gjitha fuqive ka njohur të drejtën e kombeve tjera për pavarësinë e tyre; Rumania, Serbia dhe Mali i Zi janë borxhlinj ndaj saj për mbështetjen e autonomisë që ato kanë fituar; Është merita e Fuqisë së Madhe dhe do të ishte në lavdinë e saj të përjetëshme që ajo promovoi të ardhmen e Greqisë së re që tani nën patronazhin e

Perandores Viktoria, është e aftë të zgjerojë dhe plotësojë unitetin e vet kombëtar, mbështetur në heroizmin e lashtë të grekërve modern.

Shqipëria gjithashtu do t'i jetë borxh për jetë Britanisë së Madhe për konsolidimin dhe njohjen e pavarësisë dhe kjo dhuratë nuk do të jetë humbje derisa rindërtimi i këtij shteti të ri do të prodhojë një korpus të ushtarëve të disiplinuar, i cili do të shërbejë si një avanpost roje për ushtritë e Europës perëndimore."

Shqiptarët, Shkodër 13 qershor 1878.

1913
KONFERENCA E AMBASADORËVE NË LONDËR

Foto e Ndërtesës së Foreign Office, Londër

Konferenca e Ambasadorëve në Londër ishte mbledhja e përfaqësuesve të gjashtë Fuqive të Mëdha, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Austro-Hungarisë, Rusisë dhe Italisë në nivel ambasadorësh. Ajo kishte si qëllim zgjidhjen e problemit të Shqipërisë në Ballkan, pas rënies së Perandorisë Osmane. Ajo u zhvillua nga data 1 dhjetor 1912 nën drejtimin e Eduard Greyt pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Konferenca i përfundoi punimet me datën 30 maj 1913 me një marrëveshje midis Turqisë e cila duhej të hiqte dorë nga territoret perëndimore në linjën Enos - Midia.

Në lidhje me Shqipërinë, ambasadorët fillimisht vendosën që vendi të njihej si shtet autonom nën sovranitetin e sulltanit. Megjithatë pas shumë diskutimesh, ata arritën një vendim formal që Shqipëria edhe pse e privuar nga gjysma e territoreve etnike si Kosova, të ishte një shtet sovran dhe i pavarur nga Perandoria Osmane. Ky vendim u arrit pas pesëdhjetë e katër takimesh të konferencës me datën 29 qershor1913. Ajo formuloi shkurtimisht pikat e mëposhtme për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Shqipërisë:

1. Shqipëria konstituohet si një vend autonom, sovran dhe principatë e trashëgueshme prej të drejtës së saj të garantuar (primogeniture) prej gjashtë fuqive. Sovrani do të caktohet prej këtyre gjashtë fuqive.
2. Përjashtohet çfarëdo lloj forme e sovranitetit midis Shqipërisë dhe Turqisë.

3. Shqipëria është asnjanëse; asnjanësia e saj garantohet prej gjashtë fuqive.

4. Kontrolli i administratës civile dhe financave i kalon një Komisioni Ndërkombëtar të përbërë prej delegatësh të gjashtë fuqive dhe një delegati shqiptar.

5. Kompetencat e këtij komisioni do të zgjasin dhjetë vjet dhe mund të shkojnë edhe më tej nëse shihet e nevojshme.

6. Komisioni do të ngarkohet me hartimin e një plani për organizimin e detajuar të të gjithë degëve të administratës së Shqipërisë. Brenda gjashtë muajsh, ai do tu paraqesë Fuqive një raport të punës së tij dhe vendimet e veta në organizimin financiar dhe administrativ të vendit.

7. Sovrani duhet të caktohet brenda gjashtë muajve. Deri sa ai të caktohet dhe deri sa të formohet një qeveri e përhershme kombëtare, aktivitetet e autoriteteve lokale dhe xhandarmëria do të kontrollohen prej një Komisioni Ndërkombëtar.

8. Rendi dhe siguria publike do të sigurohen prej një xhandarmërie. Ky organizëm do të jetë në duart e oficerëve të huaj, i cili do të ushtrojë komandën efektive në xhandarmëri.

9. Këta oficerë do të zgjidhen nga ushtria suedeze.

10. Misioni i oficerëve të huaj dhe instruktorëve nuk do të ndërhyjnë me njësitë e shërbimit ose me punësimin e vendasve.

11. Rrogat e këtyre oficerëve mund të sigurohen nga të ardhurat e vendit siç garantohet prej fuqive.

26 Prill 1915

TRAKTATI I FSHEHTË I LONDRËS

Traktati i Fshehtë i Londrës u nënshkrua me datën 26 prill 1915 midis Italisë dhe forcave aleate, Francës, Britanisë dhe Rusisë. Ai kishte si qëllim të tërhiqte në krahun e vet Italinë, në Luftën e Parë Botërore. Ata dëshironin pjesëmarrjen e Italisë për shkak të kufirit të saj me Austrinë. Pikërisht për këtë asaj iu premtuan Triestja, Tyroli Jugor, Dalmacia Veriore dhe territore të tjera përfshirë krejt çfarë të dëshironte ajo në Shqipëri, mjafton që të binte dakord të hynte në luftë brenda një muaji. Përkundër kundërshtimit masiv të vetë italianëve, të cilët kërkonin asnjanësinë, Italia hyri në luftë kundër Austro -Hungarisë në muajin Maj të atij viti.

Traktati i Fshehtë i Londrës kishte klauzola nga më të dëmshmet ndaj Shqipërinë e cila po kalonte një nga fazat më të pastabilizuara të historisë së saj. E ndodhur në amulli të plotë pas largimit të Princ Vidit, ky Traktat i jipte asaj edhe një goditje tjetër tmerrësisht të rëndë nëse do të arrinte të zbatohej ndonjëherë. Për të pasur një ide më të qartë rreth qëllimeve armiqësore të këtij traktati le të shohim konkretisht disa prej neneve të tij.

Në nenin 7-të këtij Traktati të Fshehtë thuhej:

Nëse Italia do të përfitojë Trentinon dhe Istrian siç parashikohet në nenin 4, së bashku me Dalmacinë dhe ishujt brenda kufizimeve të përcaktuara në nenin 5, si dhe Gjirin e Vlorës sipas nenit 6 – të, dhe nëse pjesa qendrore e Shqipërisë do të rezervohej për themelimin e një shtetit të vogël autonom dhe asnjëanës, atëherë Italia nuk do të kundërshtonte ndarjen e Veriut dhe të Jugut të Shqipërisë midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë…

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ky ishte akti më i rëndë i ndërmarrë kundër saj dhe shtetit të sapo formuar, të brishtë dhe të pa forcuar ende siç duhet. Secili nga nenet e këtij traktati, i jepte Italisë koncesione të tilla të cilat rëndonin mbi vendet e tjera dhe në radhë të parë, dhe më dukshëm, ndaj Shqipërisë.

Në nenin e 1-rë kërkohej një mbledhje e menjëherëshme e shefave të shtabeve të ushtrive të Francës, Britanisë së Madhe, Italisë dhe Rusisë. Ky takim do të përcaktonte numrin e trupave që do agazhoheshin nga Rusia kundër Austro - Hungarisë. Ndëkohë që në nenin e 2-të Italia do të përdorte

tërë forcat e saj për të luftuar përkrah Francës, Britanisë së Madhe dhe Rusisë kundër armiqve të tyre. Në nenin 3 kërkohej që Flota Britanike dhe ajo Franceze të ndihmonin në mënyrë aktive dhe të përhershme Italinë. Ndërsa neni 4, i siguronte Italisë të gjitha zonat e lakmuara prej saj. Për të kaluar tek neni 5, i cili i garantonte asaj Dalmacinë brenda kufijve të saj administrative. Sipas nenit 6–të:

"*Italia do të përftonte sovranitet mbi Vlorën, Ishullin e Sazanit dhe territoret rreth saj…*"

Të gjitha nenet e mëpastajme tregojnë koncensionet që i bëheshin Italisë, duke parashikuar rënien e mundshme të Turqisë. Ndërkohë që në nenin 14 thuhej:

"*Britania e Madhe angazhohej të lehtësonte veprimet me një kredi më kushte lehtësuese prej pesëdhjetë milionë sterlinash*".

Ndërsa i tërë traktati mbyllej me nenin 16 ku konkretisht thuhej:

"*Kjo marrëveshje duhej të mbahej e fshehtë.*"

Ajo që mbetet të thuhet është se ky Traktat i Fshehtë nuk u zbatua kurrë. Duket qartë se hartimi dhe nënshkrimi i tij kishte si qëllim futjen e Italisë në Luftën e Parë, duke i bërë disa koncensione krejtësisht të pazbatueshme. Fakti që ky traktat nuk është ratifikuar kurrë nga parlamentet e vendeve përkatëse, tregon sesa i papabazë ishte. Megjithatë, duhet thënë se ishte Presidenti Wilson, i cili pikërisht si kundërvënie ndaj Traktatit të Fshehtë të Londrës, shpalli Parimet e Vetvendosjes së Kombeve, të cilat i shpalosi në Konferencën e Paqes në Paris, kur deklaroi:

"*Thjesht pse Amerika nuk është nënshkruese e Traktatave të Fshehta kjo nuk do të thotë se ajo nuk ka qenë në dijeni të tyre*"[66].

[66] Archive of, Yale University Divinity School Library, New England, Erickson collection group 26, series nr 1, box nr 2, folder nr 4.

Prandaj dhe e kundërshtoi me force, duke çimentuar pavarësinë e Shqipërisë brenda kufijve të vendosur nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër e vitit 1913.

1919 – 1920

LIDHJA E KOMBEVE DHE KONTRIBUTI I BRITANIKËVE NË ANTARËSIMIN E SHQIPËRISË

Lidhja e Kombeve, si një Oganizatë Ndëkombëtare erdhi fill pas Konferencës së Paqes së Parisit në vitet (1919–1920). Qëllimi i kësaj Lidhje ishte çarmatimi dhe parandalimi i luftërave bazuar në një siguri të përbashkët. Grindjet midis vendeve të ndryshme do të zgjidheshin nëpërmjet bisedimeve, mjeteve diplomatike dhe përmirësimit të mirëqenies globale. Filozofia e Lidhjes ishte e ndryshme me atë çfarë njerëzimi kishte bërë ndër shekuj. Ajo nuk do të kishte ushtri, prandaj mbetej të mbështetej tek forca e armëve e Fuqive të Mëdha në mënyrë që të detyronte zbatimin e rezolutave të saj, të imponontе sanksione ekonomike në raste të caktuara ose të mobilizonte forca ushtarake po ta kërkonin interesat e përgjithshme.

Në të vërtetë një përpjekje e pasuksesshme ishte bërë për të themeluar një organizatë ndërkombëtare në vitet 1899 dhe 1907 e quajtuar Konfederata e Shteteve të Hagës[67] siç e kishte pagëzuar pacifisti neo-kantian Walther Schücking'. Kjo ide ishte frymëzuar nga Emanuel Kanti në një vepër të tij filozofike të njohur me emrin "*Paqa e Përjetshme*" – një skicë filozofike e vitit 1795. Ky projekt dështoi për t'i lënë vendin një përpjekje tjetër të ndërmarrë nga Sekretari i Jashtëm Britanik, Eduard Grey në vitin 1915. Ideja e këtij të fundit u përkrah menjëherë nga Presidenti Amerikan Woodrow Wilson dhe këshilltari i tij Koloneli Eduard M. House. Qëllimi ishte të parandalohej gjakderdhja që po ndodhte në Luftën e Madhe. Formimi i një Lidhje të tillë kishte në themel të saj Katërmbëdhjetë Pikat për Paqen të formuluara nga Presidenti Amerikan, mbi Vetvendosjen e Kombeve, e cila në pikën e fundit thoshte se, duhej të formohej një Organizatë e Përgjithëshme Ndërkombëtare bazuar në një marrëveshje të veçantë me qëllim që të sigurojë garanci reciproke për pavarësinë politike dhe integritetin territorial të shteteve qofshin ato të mëdha apo të vogla. Kjo organizatë u mishërua në atë që njihet si Lidhja e Kombeve, anëtare e 42–të e së cilës u bë Shqipëria, falë mbështetjes së pakursyer së britanikëve.

Roli i Britanisë në Anëtarësimin e Shqipërisë

Për të ardhur deri tek anëtarësia e vendit tonë në Lidhjen e Kombeve duhej të ishin patjetër në mbështetje Britania e Madhe dhe SHBA. Ndërsa

[67]The Hague Confederation of States

Eduard Grey e kishte treguar interesin e tij për Shqipërinë në Konferencën e Ambasadorëve të vitit 1913, në Londër, do të duhej Presidenti Amerikan Ëilson që të siguronte ekzistencën e shtetit tonë në Konferencën e Paqes në Paris, 1919. Në këtë akt, rol të rëndësishëm kanë luajtur Vatranët e Amerikës nëpërmjet të delegatit të tyre në Konferencë, Reverend Charles Telford Erickson, pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga Turkhan Pasha. Kjo jo vetëm do të ruante kufijtë e 1913-ës, por do të hapte rrugën për anëtarësimin e Shqipërisë në Lidhje. Në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombëve kanë ndikuar dy elementë shumë të fuqishëm:

• Presidenti Wilson, i cili e mbrojti Shqipërinë në Paris, gjë që e shpëtoi atë nga copëtimi që i kishte rezervuar Traktati i Fshehtë i Londrës i Vitit 1915;

• Lobimi i fuqishëm i anglezit Aubrey Herbert, me delegacionin britanik të përbërë ose alternuar prej Lord Robert Cecil, Lordit Balfour dhe historianit M. Fisher.

Kështu veprimi i parë e ndihmoi të dytin. Shqipëria aplikoi për anëtarësi në dhjetor të vitit 1920. Raportin e nënkomisionit për paraqitjen e kërkesës së Shqipërisë, e mbajti Lordi Robert Cecil, përfaqësues i Mbretërisë së Bashkuar, mik e afërt i Aubrey Herbert. Ai në argumentet e veta rreth Shqipërisë tha se, ndonëse kufijtë e Shqipërisë ende nuk janë përcaktuar përfundimisht, fakti që vendi ekziston prej disa vitesh brenda këtyre kufijve e vërteton ekzistencën e tij si shtet. Ndonjë rregullim i mëtejshëm mund t'i lihet të ardhmes. Lordi Cecil tha se Shqipëria duhej pranuar pasi:

"Ajo prej virtytit përbënte një komb me dëshirë të njëzëshëm të banorëve të vet."[68]

Ajo çfarë Lordi Robert Cecil kërkoi në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve nuk gjeti përkrahje për shkak të lakmive të fqinjëve dhe shteteve që i mbështesnin ata. Megjithatë, ai lëshoi një apel të fuqishëm për anëtarësimin e Shqipërisë i cili pati një efekt të jashtëzkonshëm. Në fjalën e tij ai deklaroi:

> *"Njohja fillimisht e sjell shtetin e ri në familjen e kombeve e më pas, ai vazhdon të ekzistojë që mos të zhduket prej ndonjë pushtimi apo ndonjë marrëveshjeje të përgjithëshme të atyre që e lakmojnë atë; Qeveritë herë*

[68]Proces - verbal nga mbledhja e i Komitetit të Asamblesë së Parë të Lidhjes së Kombeve, nr 13, datë 11 dhjetor 1920, faqe 12-13.

pas here ose i arrijnë qëllimet, ose dështojnë t'i arrijnë, por kur ekziston shteti si shtet, ai mbetet." [69]

Falë kësaj këmbëngulje të Lordit Robert Cecil në Komisionin e Pestë të Asamblesë u deklarua si më poshtë:

"Në tërësi ne jemi të mendimit se megjithëse Qeveria e Shqipërisë nuk është tërësisht në pozitën që i takon, prapësepraprë ajo është një qeveri e cila ka një shkallë të caktuar autoriteti në të gjitha pjesët e vendit dhe padyshim përfaqëson një ndjenjë shumë të fortë kombëtare, e cila shpërfill dallimet fetare. Duket gjithashtu se vendi është i banuar prej një race të pastër shqiptare që flet një gjuhë të përbashkët, atë shqipe."

Argumentet e Lordit Cecil, si dhe puna e delegacionit shqiptar dhe veçanërisht paraqitja e çështjes shqiptare nga Fan Noli, bënë që Shqipëria të pranohej në Lidhjen e Kombeve më datën 17 dhjetor 1920. Ai në mënyre të vëçantë theksoi faktin se:

"Kufijtë e Shqipërisë ishin po ata të caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve dhe se ajo konferencë nuk ishte abroguar. Ai theksoi faktin se shqiptarët ishin në zotërim të tërë territoreve, përveç një zone në Korçën e liruar nga francezët dhe pushtuar nga grekët.[70]

Në ndihmë të Shqipërisë nga delegacioni britank doli edhe Mr. H. A. L. Fisher, i cili mbështeti fort ruajtjen e integritetit të Shqipërisë dhe gjeti argumente shumë të fortë ligjor ndërkombëtar se përse Lidhja e Kombeve dhe Konferenca e Ambasadoreve, si dy trupa ndërkombëtarë nuk duhet të ndërthureshin në veprimtarinë e tyre në çështjet e kufijve të Shqipërisë, siç kërkonin fqinjët lakmiqarë të vendit tonë. Ai deklaroi tekstualisht:

"*Këshilli i Lidhjes së Kombeve e vlerëson si të pa këshillueshëm që të merret njëherësh me të njejtën çështje*"[71]

[69] Lidhja e Kombeve: Protokoll i mbledhjes së Asamblesë së Parë, mbledhja plenare, faqe 669. Po aty, deklarata e përfaqësuesit Italian: "Në momentin e tashëm qeveria italiane nuk e ka njohur qeverinë shqiptare as *de jure* as *de facto*" faqe 570.

[70] Lidhja e Kombeve, Proces - verbalet e sesionit të trembëdhjetë të Këshillit, 17 – 28 qershor, 1921, faqe 210.

[71] Lidhja e Kombeve, Shënime nga sesioni i trembëdhjetë i Këshillit, 17 – 18 qershor 1921, faqe 48

Ai shtoi se marrëveshja midis shteteve anëtare e përjashtonte *ipso facto* marrjen me çështjen e kufijve të Shqipërisë nga ana e Lidhjes së Kombeve. [72]

Më 4 korrik 1921, Kryeministri shqiptar Vrioni, paraqiti në Asamblenë e Lidhjes një apel ku i kërkonte Lidhjes të mos njihte asnjë shmangie nga kufijtë e caktuar prej Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913. Me datën 2 shtator 1921, u adaptua një raport i përgatitur prej Lordit Balfour, ish Sekretar I Jashtwm i Britanisë dhe një ndër arkitektët e Lidhjes së Kombeve. Ai i doli zot Shqipërisë duke e përmbledhur në tre fraza të përgjithshme tërë thelbin e kësaj çështje. Andaj ai udhëzoi:

- Asamblesë t'i kërkohej nga Shqipëria që të vepronte për përcaktimin e kufijve ndërsa Këshilli të ndalonte dhunimin e tyre;
- Çështja e statusit të Shqipërisë të zgjidhej përfundimisht me pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve;
- Trajtimi i pakicave rridhte jo nga Traktati i Paqes, por nga Rezoluta e Asamblesë së Lidhjes.

Këto ide të Lordit Balfour u pranuan dhe kjo pati një ndikim shumë të madh në mbarëvajtjen e punëve të mëpastajme të Shqipërisë.

Me 4 tetor, në komitetin e gjashtë të Lidhjes, u paraqit një rezolutë nga ana e Lordit nga Afrika e Jugut, Robert Cecil për kufijtë e cila pas shumë dëbatesh, pas kuintave, kaloi e plotë duke i bërë një shërbim tjetër të madh çështjes shqiptare. Një kombinim i britanikëve Balfour - Fisher - Cecil nën ndikimin e kolonelit Aubrey Herbert, në Lidhjen e Kombeve, zgjidhi shumë probleme që nxirrnin herë grekët, herë jugosllavët, e herë italianët në forma të ndryshme, sa për pretendime territoriale, ashtu edhe trajtim të pakicave. Kështu u ra dakord për dhënien e shtetësisë çdo banori të Shqipërisë që kishte mbi dy vjet që jetonte aty pa dallim feje apo etnie. Po kështu lejohej përdorimi i çfarëdolloj gjuhe, por shqipja do të ishte gjuha zyrtare. Gjuha amtare sigurohej të përdorej në gjykata dhe fëmijët e minoriteteve të mësonin gjuhën e nënës së tyre.

Shqetësimet në kufi me Jugsllavinë bënë që kabineti qeveritar britanik ti kushtonte rëndësi të madhe çështjes së Shqipërisë. Është kjo arsyeja pse britanikët shpallën njohjen e Shqipërisë si qeveri *de jure* e të gjithë shqiptarëve.[73] Këtë akt e pasuan edhe fuqitë nënshkruese të Konferencës së Ambasadorëve, Franca, Italia, Japonia, duke e njohur qeverinë e Tiranës si një shtet konstitucional të pavarur dhe sovran.[74]

Por siç dihet telashet me fqinjët, Shqipërisë nuk iu ndanë asnjëherë. Është përsëri Lordi Balfour, i cili më datën 12 mars të vitit 1922, paraqet

[72] Po aty, f 48-49

[73] Debate Parlamentare, House of Commons, (1921) CXIVIII, 29 Le Temp, 6,9,10 November: Woods Contemporary Revieë CXXI, 46.

[74] Lidhja e Kombeve, Official Journal, December 1921 nr 12, faqe 1195.

në prani të përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre të Komisionit të Lidhjes raportin e mbikqyrjes së kufijve në të cilin thotë se:

"*…komisioni edhe pse ka vënë re se ka një pakicë greke, (në Korçë) prapëseprapë, vëren se "qyteti është substancialisht i banuar nga shqiptarët dhe është pjesë e tokës shqiptare."*[75]

Anëtarësimi i Shqipërisë mban padyshim vulën e përpjekjeve të patriotëve shqiptarë, por si në çdo moment tjetër të zgjidhjes së çështjeve të mëdha të kombit tonë në shekullin e njëzetë, britanikët gjenden aty. Sesi vajti puna me Lidhjen e Kombeve dhe ecurinë e shtetit shqiptar është një temë shumë e gjerë, por nuk mund të neglizhohet për asnjë çast kontributi i jashtëzakonshëm i atyre britanikëve dhe pikërisht: Aubrey Herbert, themelues i Komitetit të Mbrojtjes së Shqipërisë, Edith Durham, Lordit Robert Cecil, Lordit Balfour dhe delegatit britanik H.A.L Fisher.

Përfundimi i Lidhjes së Kombeve

Lidhja e Kombeve funksionoi deri në vitin 1945, kur vendin e saj e zuri Organizata e Kombeve të Bashkuara e themeluar në Konferencën e San Franciskos më datën 24 tetor 1945. Kjo është edhe data kur festohet themelimi i OKB-së. Shqipëria nuk u ftua të merrte pjesë në atë konferencë. Megjithatë, "*Vatra*" si përherë iu gjet atdheut në krahë dhe dërgoi amerkanin Charles Telford Erickson, i cili gjatë gjithë jetës së tij aq aktive pro-shqiptare, e "*bombardoi*" me letra Presidentin Truman për të drejtën e Shqipërisë që të ishte pjesë e kombeve të qytetëruara.[76] Shqipëria, u pranua vetëm më datën 14 dhjetor 1955 si anëtare e Kombeve të Bashkuara. Sot objektivi kryesor i diplomacisë shqiptare dhe i tërë shtetit shqiptar është anëtarësimi i shtetit tjetër shqiptar, Republikës së Kosovës në këtë organizatë.

[75] Raport suplementar i 12 Majit 1922 Official Journal of the League of Nations nr 5 third part 580-82.
[76] Archive of, Yale University Divinity School Library, New England, Erickson collection group 26, series nr 5, box nr 6, folder nr 5.

RAPORT I FOREIGN OFFICE –

SHQIPËRIA – POLITIKA BRITANIKE NGA VITI 1912 DERI NË QERSHOR 1920[77]

Pas një serie ngjarjesh të cilat pasuan njëra tjetrën që nga Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e vitit 1913, Foreign Office, në vitin 1921, i ka bërë një vlerësim të përgjithshëm situatës së shtetit të ri shqiptar. Pa u ndalur në problemet me Italinë, keqpërdorimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës nga lakmitë greke, serbe dhe malazeze apo Protokollin e Korfuzit, po sjellim disa qëndrime të politikanëve anglezë në Parlamentin Britanik të përfshira në atë raport qeveritar.

Në datën 5 dhjetor 1917, në përgjigje të një pyetje bërë në Parlament, Sekretari i Jashtëm Balfour[78] deklaroi:

> *"Qeveria e Madhërisë së Tij kishte simpatinë më të madhe ndaj popullit shqiptar dhe do të mirëpriste çdo zgjidhje e cila, e shoqëruar me sigurine e duhur ndaj grindjeve të së ardhmes, të ishte e një natyre të tillë që të mbronte ushtrimin e të drejtave të tyre të plota kombëtare".*

Në datën 18 shkurt 1918, R. Lambert drejtoi këto pyetje në Dhomën e Komunave[79]:

> "A ishte njohur Shqipëria në vitin 1913 prej Fuqive të Mëdha si një shtet i pavarur dhe a ishte deklaruar ajo asnjanëse dhe e vënë në mbrojtje? A njihej Shqipëria ende si një shtet asnjanës dhe i pavarur? A ka ndonjë marrëveshje të bërë me ndonjë prej aleatëve që duhet të trajtohet si një pengesë ndaj pavarësisë dhe integritetit të Shqipërisë dhe a është e zbatueshme doktrina e "*vetë-vendosjes*" në rastin e Shqipërisë?"
>
> *Sekretari Balfour tha se marrëveshjet vijnë nga viti 1913, në të cilën Shqipëria vetë nuk ka qenë palë, dhe se ato kanë pushuar së vepruari po të marrim parasyshë faktin se të gjitha palët janë përfshirë në luftë. Sa i takon të ardhmes, qeveria e Madhërisë së Tij, do të ishte e kënaqur të shihte principet e nacionalitetit të zbatuara sa më mirë të jetë e mundur, po aq sa edhe ndaj çështjes tjetër po, aq të vështirë, e cila mbetet për tu zgjidhur në Konferencën e Paqës.*

Në 20 nëntor 1918 në Dhomën e Komunave Lordi Sydenham[80], në emër të Lordit Lamington, i drejtoi një pyetje qeverisë së Madhërisë së Tij, nëse përfaqësuesit shqiptar do të ishin të pranishëm në Konferencën e Paqës; dhë nëse jo, çfarë hapash do të merreshin për t'i siguruar Shqipërisë të drejtën e vetëvendosjes siç është rënë

[77] Public record Office, Foreign Office, 371/5726 – 05585/580/1921
[78] British Parliament, Parliamentary Debates, volume 100, page 400
[79] British Parliament, Parliamentary Debates, volume 103, page 404
[80] British Parliament, Parliamentary Debates, volume 32, page 319

dakord solemnisht prej Mbretërisë së Bashkuar, në emër të kombeve më të vogla të Europës.

Në vitin 1913, ekzistenca e një shteti të pavarur shqiptar ishte, besoj për herë të parë, e garantuar prej Fuqive. Në Traktatin e Fshehtë të 26 Prillit 1915, një "Shtet Muhamedan i Pavarur Shqiptar" është përmendur aty, dhe në shpërndarjen e territorit i cili qe bërë sipas pikave të këtij traktati, Shqipëria duket të ketë qenë e privuar nga njëri prej porteve të saj të mira, Vlorës dhe gjithashtu prej territorit të vlefshëm dhe të pasur të saj në atë rrethinë.

Së pari, a duhet që Shqipëria të lihet e pavarur nën kujdesin e një Fuqie të Madhe? Së dyti, territoret e dhëna asaj a janë të mjaftueshme për zhvillmin e saj të lirë e progresiv?. Unë shpresoj se do ti jepen siguri të tilla shqiptarëve që të gëzojnë konsideratën më të plotë në Konferencën e ardhshme të Paqës dhe se rregullime të tilla do të jenë të asaj natyre që tu garantojnë atyre një jetë kombëtare të lirë dhe të prosperuar.

Asistenti i nën sekretarit të shtetit për Mardhënjet me Jashtë, Lord Newton, i përgjigjet:

> *"Lordë, çështja e trajtimit të vendeve të vogla në Konferencën e Paqës nuk është vendosur ende prej qeverive aleate dhe konsiderohet të jetë krejt e pamundur në momentin e tanishëm që ta angazhojmë qeverinë e Madhërisë së Tij me ndonjë rast të veçantë. Sa për sigurimet e kërkuara prej lordit të nderuar, ai mund të rrijë plotësisht i qetë se interesat dhe dëshirat e popullit shqiptar do të gëzojnë çdo konsideratë."*

Në 28 mars, 1919, majori Jameson[81] pyeti në parlament nëse Konferenca e Paqës propozonte të zbatonte principet e *vetë-vendosjes* për Shqipërinë; ai ishte informuar që delegatët e Konferencës së Paqës po përpiqeshin të rregullonin kufijtë në Europën Jug- Lindore në përputhje me dëshirat e popullsisë së interesuar për to.

Në 30 maj 1919 Kolonel Lejtnant Aubrey Herbert[82], antar i Parlamentit Britanik, pyeti nëse Fuqitë do t'i mbeteshin besnike premtimeve të 1913 - ës për të njohur shtetin shqiptar, dhe nëse ishte kështu, a do ti jepnin atij shteti mundësine e një jete ekonomike?

Në 28 prill, 1920 Lordi Lamington[83] përsëri kërkoi të dinte qëndrimin e qeverisë së Madhërisë së Tij në Shqipëri dhe bëri deklaratën e mëposhtme:

> *"Çështja është se Konferenca e Ambasadorëve e 1913 – ës i pranoi principet e një Shqipërie të pavarur dhe pas bisedimeve të zgjatura kufijtë e shtetit të ri u ra dakord të pranoheshin".*

---

81 British Parliament, Parliamentary Debates, volume 114, page 768
82 British Parliament, Parliamentary Debates, volume 116, page 1590
83 British Parliament, Parliamentary Debates, volume 39, page 1124

Në 26 qershor, Lordi Sydenham, në emër të Lordit Lamington pyeti nëse qeveria italiane ka burgosur kohët e fundit dhe përzënë parinë shqiptare nga Vlora dhe përse qeveria shqiptare nuk ishte lejuar të lëshonte pashaporta për qytetarët e vet?[84]

[84] Ky dokument si i tërë është nënshkruar nga John W Field, në emër të Foreign Office me datën 12 prill, 1921. Këto janë fragmente të atij atij dokumenti.

ORGANIZIMI I XHANDARMËRISE SHQIPTARE NGA BRITANIKËT

Gjatë periudhës së ekzistencës së shtetit shqiptar si Mbretëri, britanikët qenë të pranishëm në shumë fusha të organizimit të administratës dhe veçanërisht xhandarmërisë. Edhe sot thuhet se nëse shteti shqiptar kishte diçka të organizuar mirë, ky ishte rendi. Dhe për këtë rol shumë të rëndësishëm kanë luajtur britanikët. Këtë më mirë se askush e thotë oficeri britanik Dayrell Oakley-Hill në librin e tij, "Një anglez në Shqipëri"

Dayrell Oakley-Hill



Koloneli Dayrell Oakley-Hill ishte një ndër oficerët britanikë që i ishte caktuar detyra e organizimit të xhandarmërisë shqiptare në vitet 1930, nën drejtimin e Gjeneralit Jocelyn Percy. Ai ka lindur në Afrikën e Jugut dhe u diplomua në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst, në tetor të 1916-ës. Oakley-Hill ishte rekrutuar për misionin shqiptar në vitin 1929 dhe ka shërbyer kryesisht në Elbasan, ku ai mësoi shqip dhe udhëtoi shumë. Ai me gruan e tij ka hapur agjencinë e parë turistike dhe ka ngritur shoqatën për parandalimin e keqtrajtimit të kafshëve. Oakley-Hill u detyrua të largohet nga Shqipëria me tërheqjen e të gjithë oficerëve britanikë në nëntor 1938 dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore u vendos në Maltë. Në fund të prillit 1940, ndihmoi në punën paraprake për të organizuar një lëvizje të rezistencës shqiptare dhe filloi të punojë për Operacionet e Posaçme të njohura si Special Operations Executive (SOE), në Beograd dhe në Kosovë. Në prill të vitit 1941, Oakley-Hill air ra në duart e gjermanëve dhe u mbajt si i burgosur lufte për dy vjet e gjysmë, deri në tetor 1943. Oakley-Hill kthehet në Londër në vitin 1944 dhe vazhdon punën për operacionet e SOE në Shqipëri. Në fund të Luftës së Dytë Botërore, nga marsi i vitit 1945, deri në maj 1946, ai kryesoi misionin e Kombeve të Bashkuara (United Nations Relief and Rehabilitation Administration - UNRRA) dhe më 2 maj 1945 shkoi në Tiranë për të negociuar me regjimin e ri shqiptar në ofrim të ndihmës humanitare. Shumë shpejt e pati të pamundur të punonte me regjimin e ri prandaj dha dorëheqjen në vitin 1946. Nga janari (1951-1955), ai punoi si Sekretar i Tretë në Ambasadën Britanike në Athinë dhe për MI6[85], në veçanti për

[85]Shërbimi i fshehtë britanik

operacionet për përmbysjen e rregjimit në Shqipëri. Në vitet e mëvonshme, ai shërbeu si kryetar i Shoqatës Anglo-Shqiptare në Londër. Oakley-Hill vdiq në Londër në vitin 1985. Kujtimet e tij për Shqipërinë u botuan në vëllimin "*Një anglez në Shqipëri: Kujtimet e një oficeri britanik" (1929-1955)*", Londër 2002.

SPECIAL OPERATION EXECUTIVE[86]

Në aktet më të rëndësishme, dashamirëse dhe ndihmën më të madhe të dhënë nga ana e Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë, është futja e vendit tonë në hartën e veprimeve të SOE. Një numër i madh djemsh e vajzash britanikë shkuan në Shqipëri për tu ballafaquar me një terren dhe situatë krejtësisht të panjohur edhe pse misioni i tyre ishte pro përkrahjes të shqiptareve. Dhe lind pyetja se çfarë ishte kjo organizatë?!

Në rrjedhojë të Luftës së Dytë Botërore, me rënien e Francës në duart e nazistëve, lindi nevoja e menjëherëshme e krijimit të një force vullnetare luftarake britanike, e cila do të zhvillonte një luftë ndryshe kundër ushtrive hitleriane. Kjo forcë u pagëzua me emrin; Special Operations Executive (SOE) ndërsa misioni i saj ishte të kryente akte spiunazhi dhe sabotazhi në prapavijat e nazistëve. Luftëtarët e këtij formacioni do të nxirrnin trenat nga shinat, të shembnin urat si dhe të sabotonin fabrikat e prodhimit të armëve. Ata do të ndihmonin organizmin e luftës guerrile në të gjitha vendet e pushtuara nga armiku. Në 16 korrik 1940, Kryeministri Churchill emëroi Hugh Dalton si mjeshtrin politik të SOE-s dhe menjëherë e urdhëroi atë të fillonte veprimtarinë në terren. Organizata punësoi ose me saktë angazhoi 13.000 pjestarë prej të cilëve 3.200 ishin femra. Ajo u shpërnda zyrtarisht me datën 15 janar të vitit 1946. Agjentët e SOE në qershor të vitit 1941, arritën të shpërthenin stacionin elektrik francez Pessac. Ky akt u prit në Londër si një sukses dhe krijoi bindjen se nuk ishin vetëm bombat ato që do të shkatërronin makinën ushtarake gjermane. Ky operacion çoi në qindra të tjera anë e mbanë Europës deri në Lindjen e Largët, në Japoni.

[86]The Special Operations Executive (SOE) ishte një organizatë britanike e Luftës së Dytë Botërore e krijuar nga Kryeministri Churchill për tu marrë me sipunazh dhe sabotazh kundër fashistëve në Europën e pushtuar. Kjo organizatë veproi derinë përfundim të plotë të Luftës së Dytë Botërore.

Në vitin 1942 një skuadër e SOE–s vrau zëvendësin e Hitlerit, Reinhard Heydrich me një granatë; Në Greqi në vitin 1942 ata shkatërruan urën e Gorgopotamos, duke i prerë furnizimet ushtrisë së Romelit në shkretëtirë; Në Norvegji shkatërruan një fabrikë të ujit të rëndë, duke i dhënë fund ëndrrës naziste për prodhimin e një bombe atomike. SOE mund të godiste armikun në çdo kohë dhe në çdo vend.

Cili ishte roli i SOE–së në Shqipëri?

Dy fotot në krye të këtij teksti bëjnë lidhjen midis dy cepave fundorë, kohorë të kësaj historie. E para është statuja që simbolizon luftëtarët e SOE–s, e ngritur në Londër, në Albert Embankment, në anën e Lumit Tames, në një baraz-largësi midis Urës Lambeth dhe London Eye[87]. Tjetra është një fotografi e memorialit të të rënëve të SOE–së në Tiranë, të vendosura në vitin 2012, me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

SOE, përveç vendeve të tjera si Francë, Poloni, Gjermani, Hollandë, Belgjikë, Itali, Jugosllavi, Hungari, Greqi, Kretë, Çekosllavaki, Norvegji, Danimarkë, Rumani, Abisini, Azinë Juglindore veproi edhe në Shqipëri. Një grup i vogël ndërlidhës hyri nga Greqia në Shqipëri në vitin 1943. Agjentët e SOE–së ishin Julian Amery, Anthony Quayle, Davis Smiley dhe Neil "*Billy*" McLean.

Por si u zhvilluan operacionet e SOE–së në Shqipëri?! Këtë na e ka përshkruar më së miri Rodrick Bailey në librin e tij:

"**Provinca më e egër - SOE në Tokën e Shqipeve**"[88]**.**

Në vitin 1943, një ekip i vogël elitë i ushtarëve britanikë, filloi të zbriste me parashutë në malet e Shqipërisë së pushtuar. Ata ishin pjestarë të SOE–s dhe kishin si detyrë të gjenin dhe të armatosnin çetat e luftëtarëve guerrilas dhe të sulmonin armikun sa më shumë që të mundeshin. Ata kurrë nuk kishin shkelur në Shqipëri dhe as që dinin se çfarë do t'i priste atje.

Duke u përpjekur të mbijetonin në kushtet më ekstreme dhe në një terren tejet të vështirë këta britanikë të rinj jetuan nën rrezikun e përhershëm se mos binin në duart e armikut ku i priste vdekja e sigurtë. Përveç sëmundjeve, pamundësisë për një jetë të pastër, atyre iu shtohej edhe fakti se guerrilasit shqiptarë, sipas Roderick Bailey-t, ishin në konflikt

[87] Ky bust është vepër e skulptorit të njohur anglez Ivan Saxton

[88] Roderick Bailey – The Ëildest Province, SOE in the Land of Eagles. Random House, 31 Oct 2011 - History - 416 pages. Ky libër është promovuar në Ambasadën Shqiptare në Londër me datën 23 shkurt, 2013.

me njëri - tjetrin. Në këtë libër të jashtëzakonshëm autori ka përdorur intervistat me të mbijetuarit, ditare të fshehura prej kohësh dhe të deklasifikuara më së fundi, të cilat dëshmojnë historinë e jashtëzakonëshme të SOE–së në Shqipëri.

SOE, sipas dokumentave të saj deri në vitin 1945, ka dërguar në Shqipëri 7.000 pushkë, 5.000 armë gjysmë automatike, 1.800 mitroloza të lehtë, bashkë me 16 milion e pesëqint mijë fishekë, 240 mortaja, me 25.000 bomba, dhe 25.000 granada përveç pistoletave dhe gjashtëdhjetë mitralozave gjysëm të rëndë. Po ashtu ata dërguan 28.000 palë rroba ushtarake, 57.000 palë çizme ushtarake, 14.000 batanie, 390 fenerë, 6 xhipsa, dhe një motorbarkë. Ata dërguan edhe qindra ton me ushqime.

Nga grupi i parë prej 50 britanikëve që zbritën në Shqipëri, 16-të mbetën të vrarë ndërsa 17 të mbijetuar janë dekoruar. Në atë periudhë kohore të veprimtarisë së SOE–së në Shqipëri, dhanë jetën 53 pjesëtarë të këtyre forcave. Autori e fillon rrëfimin e tij dramatik me pjesë nga vepra e autorit tonë të madh Ismail Kadare që u bë i famshëm me "*Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur*". Historia e mbetjeve të eshtrave të këtyre të rënëve britanikë është tejet e dhimbshme. Ata kurrsesi nuk mund të vlerësohen si armiq pushtues të Shqipërisë. Përkundrazi, ata erdhën dhe dhanë jetën për të nxitur dhe ndihmuar popullin shqiptar të çlirohej nga fashizmi dhe nazizmi. SOE u shpërnda zyrtarisht me datën 15 janar të vitit 1946. Pas luftës ata bënë përpjekje të mëdha për të mbledhur eshtrat e të rënëve të tyre, si kudo tjetër edhe në Shqipëri.

Regjimi i Enver Hoxhës, i cili kishte marrë tërësisht një kurs, fillimisht pro-Jugosllav e më vonë pro–sovjetik, i solli shumë pengesa britanikëve për të marrë eshtrat e djemve e vajzave të veta. Autori tregon sesi përkundër tërë pengesave të qeverisë, një oficer i quajtur MacIntosh gjeti një mbështetje të jashtëzakonshme tek populli shqiptar që u tregua aq bujar ndaj tij. Kështu në shkurt të vitit 1946, ai pasi kishte shkuar fshat më fshat, e breg më breg në kërkim të tyre, arriti të mblidhte eshtrat e të rënëvë britanikë në Shqipëri. Fatkeqësisht, MacIntosh u përzu nga qeveria shqiptare si "reaksionar dhe armik i popullit shqiptar" dhe misioni i tij mbeti i pambaruar. Por më e keqja ende nuk kishte ndodhur. Qeveria angleze ia besoi ambasadës franceze detyrën për marrjen e eshtrave. Në vitin 1950 një atashe francez, shkoi të vizitonte varrezat e britanikëve në Shqipëri. Ai nuk gjeti asnjë gjurmë të tyre. E drejta e këtyre njerëzve për tu prehur në një vend të qetë u "*fitua*" vetëm pas rënies së diktaturës komuniste në Shqipëri. Ata u mblodhën dhe u vendosën në një varrezë në Parkun e Tiranës. Me datën 11 nëntor 2012, Ambasadori Britanik në Tiranë ShT z. Nicholas Cannon dhe Kryeministri i asaj kohe Dr. Sali Berisha organizuan një shërbesë përkujtimore në varrezën e britanikëve prapa Universitetit të Tiranës. Ata ishin 53 të rënë, por vetëm 46 prej tyre i kanë pllakat e varreve mbi kokë.

Shqipëria i ka borxh nderi këtyre të rënëve për kontributin në çlirimin e vendit tonë. Pas kthimit në atdhe, veteranët e SOE që shërbyen në

Shqipëri i shërbyen vendit të tyre në fusha të ndryshme të jetës. Shumë prej tyre u bënë njerëz të shquar dhe politikanë të zotët. Le të veçojmë disa prej tyre:

Harold Julian Amery, Baron Amery of Lustleigh, (1919–1996) – Politikan konservator britanik, i cili shërbeu tre dekada si figurë drejtuese e kësaj partie dhe 42 vjet anëtar i parlamentit. Ai ka shërbyer si oficer ndërlidhës i SOE për lëvizjen e rezistencës antifashiste shqiptare në vitet (1943–1944) në përbërje të grupit të quajtur "*Tre Mosketjerët*" bashkë me majorin Davis Smiley dhe kolonelin Neil McLean.

John Anthony Quayle, officer i shërbimit të fshehtë anglez, i cili në vitin 1943 mbërriti në Tragjas, Shqipëri. Aty u takua me një oficer tjetër të SOE–së të quajtur Jerry Field të cilin e zëvendësoi, pasi ai ishte plagosur në një ditë peshkimi. Pas luftës ai iu kushtua aktrimit dhe drejtoi Teatrin Memorial të Shekspirit ku dhe hodhi themelet e krijimit të Kompanisë Mbretërore të Teatrit Shekspirian. Ai ka luajtur rolet e Falstafit, Otellos, Henrin e VIII-të si dhe ka interpretuar edhe me Lorenc Oliverin dhe ka një galeri të pafund rolesh. Për ne shqiptarët mbetet figurë e dashur pasi jo vetëm që shërbeu në Shqipëri, por ishte anëtar aktiv i përhershëm i Anglo Albanian Association. Vdiq në vitin 1989.

Kolonel Davis Smiley (1916–2009) ishte një oficer i shërbimeve të fshehta britanike. Në luftën e Dytë Botërore ai ka luftuar në Palestinë, Irak, Persi, Siri si dhe ka vepruar me SOE–në, në Shqipëri dhe në Tailandë. Ai ka shkruar librin "*Albanian Assignment".*

Kolonel Neil "Billy" McLean(1918–1986), oficer i shërbimeve të fshehta britanike i SOE në Shqipëri dhe më pas politikan i shquar. Më pas ka shërbyer si anëtar i Parlamentit Britanik. Në Prill të vitit 1943 ai u hodh me parashutë në Shqipëri ku ra menjëherë në kontakt me partizanët e Brigadës së Parë Sulmuese. Ai u përpoq të pajtonte grupet e ndryshme në Shqipëri. Pas një periudhe në Angli u kthye përsëri në Shqipëri në vitin 1944 me ekipin e vogël të Tre Mosketjerëve (*shih më lart*).

Magaret Hasluck për të cilën flitet në këtë libër, shërbeu në SOE. Pas luftës, dhe pas ekzekutimit nga komunistët të mikut të saj shqiptar, Lef Nosi, ajo u sëmur rëndë dhe vdiq në varfëri në Dublin në vitin 1948. Atë e ndihmuan miqtë e saj të SOE–së në ditët e fundit të jetës në mënyrë anonime.

Billy McLlean shërbeu si konsull në Sianking. Tony Neel shërbeu në forcat ajrore, Bill Tilman u bë gazetar i njohur. Shumica e tyre i shërbyen Britanisë në fusha të ndryshme, duke treguar se ishin po aq të guximshëm e të talentuar në paqe sa ç'ishin në luftën që zhvilluan në Shqipëri në shërbim të popullit shqiptar. Shqipëria iu ka borxh nderi si të rënëve, ashtu dhe të mbijetuarve, për kontributin në çlirimin e vendit tonë nga nazi-fashizmi.

KAPITULLI I TRETË

PRANIA DIPLOMATIKE SHQIPTARE NË LONDËR

Prania diplomatike e Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar fillon në Janar të vitit 1922 deri në vitin 1939 dhe ndahet në dy periudha me një ndërpreje shumë të gjatë që rinis në vitin 1991. Ndërkohë ajo britanike në Shqipëri fillon me datën 24 janar 1922 datë kur emërohet në këtë detyrë Sir Harry Charles Augustus Eyres. Një vështrim i përgjithshëm i këtyre marrëdhënieve, i vendndodhjes, titullarëve të përfaqësive do të mund të japë një ide sesa shumë rëndësi i kanë dhënë dy vendet këtyre marrëdhënieve. Nga ana e Mbretërisë Shqiptare do të shohim se në atë kohë në Londër kanë shërbyer emra të mëdhenj të patrotizmës shqiptare sado që secili prej tyre ka përfunduar paradoksalisht ose i persekutuar, ose ka vdekur në megrim, apo akoma më keq, është ekzekutuar nga regjimi komunist. Dhe kjo nuk është aspak më pak se një fatkeqësi kombëtare. Personalitete që kanë lënë trashëgimi jo vetëm idealizmën e tyre por edhe vepra të shkruara, të cilat e nderojnë kulturën tonë, shqiptarë që lanë rehatinë e vet në vendet ku kishin lindur si Fuad Asllani, apo të tjerë që kishin pasuri të pafundme të vëna në shërbim të atdheut si Ekren Bej Vlora, etj. Më poshtë do të shohim këtë listë burrash të cilët i bënë nder të madh kombit, edhe pse e paguan me persekutim, mërgim ose me humbjen e jetës dhe të emrit për shumë kohë.

Pas ngjarjeve të mëdha që pasuan Shpalljen e Pavarësisë siç janë Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Ardhja e Princ Vidit dhe largimi i tij, Lufta e Parë Botërore dhe pushtimi i Shqipërisë, Konferenca famëkeqe e Londrës (1915), Konferenca e Paqes në Paris (1919), Kongresi i Lushnjës dhe konstituimi i shtetit shqiptar me qeveri vendase dhe kryeqytet Tiranën dhe Lidhja e Kombeve 1920, erdhi edhe fillimi i vendosjes së misioneve diplomatike. Kështu Shqipëria do të vendoste përfaqësuesin e saj në Londër, ndërsa Mbretëria e Bashkuar atë të vetin në Shqipëri. Në ditët e para të shtetit shqiptar, misionet diplomatike ishin vendosur në Durrës pasi Tirana ende nuk ishte kryeqendër e njohur. Por ndryshe nga të tjerat që u zhvendosën në Tiranë ajo britanike qëndroi aty deri në shkurt të vitit 1939. Fatkeqësisht, pikërisht në atë kapërcyell të vendosjes në Tiranë, ajo e ndërpreu punën për shkak të pushtimit italian. Këto marrëdhënie u rivendosën pas plot 51 vjetësh dhe konkretisht në vitin 1991. Ato ishin ndërprerë qysh në vitin 1939 me pushtimin italian të Shqipërisë, ndonëse britanikët mbajtën një prani konsullore në Shqipëri deri në vitin 1940.

Pas mbarimit të luftës me 10 nëntor të vitit 1945, Britania e njohu regjimin e ri shqiptar dhe vendosi të rihapte përfaqësinë diplomatike. Pavarësisht se një përfaqësues u emërua, ai nuk e mori kurrë postin e tij. Interesi i shqiptarëve ndaj Britanisë dukej se kishte ndryshuar. Ndaj Misionit ushtarak britanik, i cili ishte pritur me shumë entuziazëm në Mars të vitit 1945, u vunë shumë kufizime mbi punën dhe lëvizjet e tyre.

Diskutimet për një rivendosje të marrëdhënieve diplomatike morën fund përfundimisht pas incidentit të Kanalit të Korfuzit në maj dhe tetor të vitit 1946. Në vitin 1981 Qeveria Britanike i propozoi Qeverisë Shqiptare rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike pa pritur një rezolutë për çështjen, por autoritetet komuniste shqiptare nuk e pranuan atë. Oferta mbeti e hapur dhe Mbretëria e Bashkuar vazhdoi të ofronte bisedime pa kushte. Në mars të vitit 1985, në Paris, u zhvilluan bisedime për arin shqiptar por u ndërprenë për shkak të vdekjes së dikatorit.

Marrëdhëniet midis dy vendeve mbajtën edhe një peshë të rëndë atë të operacioneve anglo -amerikane për rrëzimin e pushtetit komunist në Shqipëri nëpërmjet futjes së kundërshtarëve të rregjimit nga jashtë, të ashtuquajturave grupe diversioniste. Por ato siç dihet dështuan për shkak të tradhëtisë së agjentit britanik Kim Philby. I lindur me emrin Harold Adrian Russell në vitin 1912, ai u bë i njohur nga pseudonimi "*Kim*" Philby. Ai ishte oficer i rangut të lartë të shërbimeve të fshehta britanike. Si agjent i dyfishtë përpara se t'i dorëzohej shërbimit të fshehtë sovjetik në vitin 1963, ai u bë operativ i KGB–së. Vdiq në vitin1988. Ai njihet si një ndër spiunët më të famshëm të shekullit të njëzetë. Në vitin 1949 ai ishte sekretari i parë i Ambasadës Britanike në Washington. Që aty mori përgjegjësinë e një operacioni të fshehtë për rrëzimin e komunizmit në Shqipëri, duke përdorur agjentë të fshehtë shqiptarë në mërgim. Duke ditur tërë organizmin e kësaj veprimtarie, ai ua kaloi informacionet Moskës prej nga njoftohej Tirana dhe mendohet se qindra nacionalistë shqiptarë anti-komunistë ranë në duart e sigurimit të shtetit në vitin 1950. Vdiq i dekoruar me urdhërin e Leninit, por me një trashëgimi që ka patur ndikim shumë të madh në të dyja polet politike të Shqipërisë, si jashtë ashtu edhe brenda.[89] Veprimtarinë e tij, ai e ka përshkruar në librin "*Lufta ime e Heshtur*"[90]. Këto veprime dhe floriri që ishte mollë sherri, e cila nuk u zgjidh dot deri pas rënies së komunizmit kur të dyja palët si ajo shqiptare edhe

[89] Robert Elsie, Historical Dictionary of Albanian Scarecrow Press, Lanham, Maryland, and Oxford 2004, f 246

[90] My Silent War, Kim Crown Publishers New York, a Pinguin Random House Company, New York.

ajo britanike gjetën një gjuhë të përbashkët, i penguan marrëdhëniet midis dy vendeve.

Si në shumë raste të tjera historia përsëritet dhe, për fatin e mirë ishte i biri i diplomatit të fundit të Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, Dervish Dumës, z. Alexander Duma i cili u bë ndërmjetësi i asaj kohe. Ai u autorizua nga shteti ynë për zgjidhjen e çështjes me çdo kusht. Shqipëria e dalë nga rrënojat e komunizmit nuk e kishte luksin të vazhdonte luftën me Britaninë e Madhe tani që kursi politik i shtetit të ri demokratik do të ishte tërësisht pro anglo – amerikan.

Marrëdhëniet diplomatike më në fund u rivendosën më 29 Maj 1991. Në Londër u vendos që marrëdhëniet me Tiranën duhet të mbaheshin nga Roma, sepse interesat britanike atëhere nuk ishin aq sa të justifikohej një mision rezident. Sir Stephen Egerton, Ambasadori Britanik në Romë, u bë Ambasador jo-rezident i Mbretërisë së Bashkuar që do të mbulonte Shqipërinë. Në Maj të vitit 1992 u lëshua një deklaratë e përbashkët midis dy palëve, e cila shënon edhe përfundimin e luftës së ftohtë midis dy vendeve:

> *"Delegacionet Britanike dhe ato Shqiptare u takuan në Romë më 8 maj për të diskutuar mbi çështjet bilaterale dhe vendosën të nënshkruajnë një memorandum mirëkuptimi ku Qeveria Britanike vendos t'i japë Shqipërisë 1574 kg. ar. Ato gjithashtu shprehën kënaqësinë që ky memorandum u arrit në një atmosferë mirëkuptimi. Ato e shikojnë këtë memorandum si fillimi i një ere të re dhe pozitive të marrëdhënieve dypalëshe. Të dy palët shprehën keqardhjen për incidentin e Kanalit të Korfuzit në 22 Tetor të vitit 1946. Ato konfirmojnë se të gjitha kërkesat financiare të Qeverisë Britanike dhe të gjitha problemet që kishin të bëjnë me incidentin e Kanalit të Korfuzit janë zgjidhur nga të dyja palët"*[91].

[91]Arkivi i MPJ, Tiranë, Dosja e mardhnjeve Shqiptaro – Britanike

PËRFAQËSUESIT E SHTETIT SHQIPTAR NË LONDËR

Shteti shqiptar që nga vitit 1922 ka mbajtur një përfaqësi diplomatike në Londër. Ky përfaqësim fillon shumë shpejt, në vitin 1922, thuajse në të njëjetën kohë kur Shqipëria vendos mardhënje diplomatike edhe më Shtetet e Bashkuara. Njohja me personalitetet shqiptare që e kanë përfaqësuar Shqipërinë duhet të jetë me interes jo vetëm për diplomatët shqiptar por edhe për një audincë më të gjërë.

MEHMET KONICA (1922 – 1924)

Mehmet Konica (1878-1948) Ministër Fuqiplotë, (1922–1924). Ka shërbyer si Ministër i Punëve të Jashtme, diplomat karriere dhe veprimtar politik i shquar. Ai ka meritën e madhe të të qenit diplomati i parë shqiptar në Britaninë e Madhe. Ai vinte nga një e kaluar e lakmueshme patriotike. Ishte anëtar i delegacionit të Qeverisë së Vlorës dhe anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1913). Në qeverinë e dalë nga Kongresi i Durrësit u emërua Ministër i Punëve të Jashtme, detyrë të cilën e mbajti edhe në qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës. Në vitet (1920-1924) shërbeu si përfaqësues diplomatik i Shqipërisë në Britaninë e Madhe. Në periudhën (1925-1939) ka shërbyer si këshilltar politik pranë kryetarit të shtetit shqiptar.

Mehmet Konica ishte një ndër të paktët dëshmitarë të tragjedisë shqiptare të kufijve. Ai e ndoqi atë nëpër disa etapa. Që nga viti 1913, deri më 1923, kur më së fundi, një delegacion ndërkombëtar i kryesuar nga një gjeneral italian, vendosi në Shqipërinë e Jugut gurët që shënonin kufijtë shqiptaro-grekë. Gjenerali quhej Telini dhe ai nuk u kthye kurrë në Itali pasi e vranë bandat greke në afërsi të Delvinës dhe trupi i tij, i përcjellë nga Mehmet Konica në emër të Qeverisë Shqiptare, u dërgua në Romë me nderimet ushtarake. Bashkë me të mori fund edhe aventura e kufijve. Një aventurë e cila ka sunduar për një kohë të gjatë, gjithë mosmarreveshjet në Ballkan. Në veprimtarinë e tij si diplomat shqiptar, mund të cilësohen marrëdhëniet me politikanin e shquar dhe dashamirës të Shqipërisë Aubrey Herbert. Në një moment historik, kur Shqipëria kërkonte një aleat të madh siç ishte Britania e Madhe, ai bashkë me amerikanin Charles Telford Erickson, me porosi dhe në mirëkuptim të plotë nga Zogu, po ashtu edhe nga Noli, i ofruan Herbertit kurorën e një Mbretërie Shqiptare ende të pa lindur. Herbert e pranoi por fati i tij i keq ishte se ai vdiq përpara se kjo

të ndodhte. Në historinë e Shqipërisë Mehmet Konica mbetet një figurë e ndritur i cili është gjetur aktiv dhe mjaft i dobishëm në çdo çast madhor të kthesave të mëdha historike të Shqipërisë.

ILIAS BEJ VRIONI (1925 – 1926)



Ilias bej Vrioni në vitet 1925 – 1926 ka shërbyer si Ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në Londër, me rezidencë në Onslo Gardens, SW7. Vrioni ishte një figurë e shquar politike në periudhën e parë zogiste dhe rridhte nga një familje e pasur tokash në Shqipërinë Jugore. I ati Mehmet Ali Pashë Vrioni kishte bashkëpunar me Abdyl Frashërin në kohën e Kongresit të Berlinit. Iliazi mori pjesë vetë në lëvizjen për pavarësinë në Vlorë dhe u zgjodh në senat në vitin 1912. Në vitin 1914 udhëtoi për në Gjermani bashkë me Esat Pashën për t'i dorëzuar kurorën Vilhelm Vidit. Më datën 19 nëntor 1920, pasi mori pjesë në Kongresin e Lushnjës ku u zgjodh Kryeministër pas rënies së qeverisë së Sylejman Delvinës, post të cilin e mbajti deri me datën 19 tetor 1921, u bë përsëri kryeministër nga 27 maj 1924 deri më10 qershor 1924, kohë kur u mbajt i ashtuquajturi revolucioni demokratik i Fan Nolit. Në vitet (1925–1926) shërbeu si Ministër Fuqiplotë në Paris dhe në Londër. Nga shkurti 1927-ës deri në janar 1929, ai ishte Ministër i Jashtëm dhe për një kohë të shkurtër Ministër i Drejtësisë. Ai ishte Ministër i Jashtëm në vitin (1925–1927) dhe nga viti (1931–1933) mbajti marrëdhënie të afërta me Italinë, në veçanti me Paktin e Dytë të Tiranës më datën 22 nëntor 1927. Ai mbante dekoratën Oficer i Lartë i Legjionit të Nderit (Grand Oficer de la Legion d'Honneur) në Francë. Vdiq në Paris.

MALIQ LIBOHOVA (1926 – 1927)

Source gallica.bnf.fr / Bibliothèque nationale de France

Maliq Libohova, Janar 1926 - shtator 1927 ishte i Ngarkuar me Punë në Londër. Ai shërbeu përsëri po në këtë funksion dhe po në këtë Ambasadë nga shkurti 1933 deri në qershor 1933. Ambasada në atë kohë ishte e vendosur në 118 Iverness Terrace, Londër. Për koinçidencë, krejt ngjitur me këtë adresë, sot qëndron Busti i Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, dhe pikërisht në 113 Inverness Terrace, London W2 6JH, i vendosur më datën 28 nëntor 2012. Ndërtesa e atëherëshme duket se nuk ekziston për shkak të ndërtimeve të bëra në atë truall.

EQREM BEJ VLORA (1927 – 1929)

Eqrem Bej Libohova (1885–1964) ka shërbyer si i Ngarkuar me Punë nga shtatori i vitit 1927 deri në maj 1929, kur Ministër Fuqiplotë ishte Iliaz Bej Vrioni me rezidencë në Paris. Ky Bej i Vlorës ka qenë një veprimtar i çështjes shqiptare, diplomat, politikan, shkrimtar dhe historian. Ai ka kryer studimet liceale dhe universitare në Theresianum, Akademia Orientale Mbretërore e Perandorake në Vjenë, ku u specializua në çështje ballkanike. Më pas i plotësoi studimet për doktoraturë në drejtësi në Stamboll në vitin1904. Gjatë udhëtimeve në Lindje të Mesme do të krijonte njohje me personalitete të larta të kohës si Field-Marshallin britanik Herbert Kitchener, shefin e Shtatmadhërisë Austro-Hungareze Franz Conrad von Hötzendorf dhe majorin e ri Mustafa Kemal Ataturk, themeluesi i ardhshëm i Turqisë moderne. Në vitin 1906, ishte sekretar i gradës së III në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane, Stamboll. Në vitin 1907, Sekretar i gradës së III në Ambasadën e Perandorisë Otomane në Shën Petërburg për tre muaj, ndërsa në vitin 1909, Sekretar i II në zyrën e përkthimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane Stamboll. Ai bashkë me miqtë e tij hapi të parin klub të quajtur "*Bashkimi*" në Stamboll më1908-ën. Bashkë me patriotin Dervish Hima, ai mori pjesë në Kongresin e Manastirit i mbajtur në Nëntor të vitit 1908. Ai mori pjesë në shpalljen e pavarësisë dhe më pas u bë nënpresident i senatit. Ka shërbyer si sekretar i jashtëm në qeverinë e Vilhelm Vidit. Gjatë Luftës së Parë Botërore në vitin 1916, ai u internua nga italianët në Cagliari. Në vitin 1924 u zgjodh në parlament. Zogu e spostoi atë në Londër si të ngarkuar me punë në vitin 1928. Më pas ai u emërua në Athinë. Eqrem Bej ka meritën e madhe të përkthimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit në gjermanisht bashkë me baroneshën Marie Amelie, Frein von Godin dhe shkruajtën veprën momumentale prej 1200 faqesh *"Vështrim Historik i kontributit ndaj historisë së sundimit turk në Shqipëri"*[92].

[92]Ekrem bej Vlora – Contributions to the History of Turkish Rule in Albania – Vepër e pabotuar.

Ai na ka lënë një trashëgimi të madhe letrare. Vdiq në mërgim në vitin 1964. Veprimtaria e tij aq komplekse dhe detyrat e mbajtura në shtetin shqiptar tregojnë për rëndësinë që Mbreti Zog i jepte në atë kohë marrëdhënieve me Mbretërinë e Bashkuar. Ai ishte anëtar i Akademisë së Shkencave Gjermane nga ku ka marrë edhe medalje ari, si dhe anëtar i akademisë diplomatike të Parisit dhe i Institutit të Shkencave në Romë dhe në Tiranë.

FUAD ASLLANI (1933 - 1981)

Fuad Asllani, (1897-1981) ka shërbyer si i Ngarkuar me Punë në Ambasadën Shqiptare në Londër nga viti 1933 në vitin 1934 dhe nga dhjetori 1934 deri në tetor 1935 si Ministër Fuqiplotë. Ka lindur në Bejrut të Libanit dhe ka kryer Kolegjin Robert në Stamboll. Ai u diplomua në vitin 1923 në Vjenë. Fuad Asllani ishte anëtar i shoqatës majtiste "*Bashkimi*" drejtimin e së cilës e mori pas vdekjes së Avni Rrustemit. Ai iu bashkua KONAR–s së drejtuar nga Fan Noli. Fuad Asllani ishte kundërshtar i hapur i Zogut, por më vonë ata vunë paqe midis tyre. Pas një internimi në Delvinë në vitin 1928, Zogu i ofroi punë në Ministrinë e Jashtme. Më pas shërbeu në disa misione shqiptare jashtë si në Bullgari, Britaninë e Madhe (1932–1934) dhe në Lidhjen e Kombeve. Ai ka shërbyer përkohësisht si parlamentar dhe Drejtor i Institutit Herbert. Ishte anëtar i Këshillit të Shtetit gjatë okupimit fashist dhe u fsheh disa kohë gjatë vitit 1944. Më pas u arrestua dhe u dënua bashkë me 36 shqiptarë të tjerë përfshirë edhe Musine Kokalarin. Fuad Asllani nën rregjimin e Enver Hoxhës i kaloi vitet e jetës deri sa vdiq, herë në burg, e herë në internim. Veprimtaria e tij si diplomat jep një shembull interesant sesi patriotët tanë edhe pse kundërshtarët politikë të Mbretit dërgoheshin në shërbimin diplomatik të shtetit shqiptar dhe në rastin tjetër, nën diktaturë, ata persekutoheshin deri në pikën më të paimagjinueshme. Fuad Asllani është shembulli më kuptimplotë i këtij dallimi drastik.

XHEMIL DINO (1932 – 1933)

Xhemil Dino(1894-1972) ka shërbyer si Ministër Fuqiplotë i Mbretërisë Shqiptare në Britaninë e Madhe nga Marsi 1932 – deri në shkurt 1933.[93]Ai ka lindur në Prevezë, në Vilajetin e Janinës në kohën e Perandorisë Osmane më 1894-ën, nga një degë e një familjeje fisnikësh të njohur me emrin, familja Dino. Ai ka studjuar në Universitetin e Gallatasarajit në Stamboll dhe, pas shpalljes së pavarësisë u zgjodh deputet i Dibrës. Ai e ka përfaqësuar Shqipërinë në Asamblenë e gjashtë, të shtatë dhe të tetë të Lidhjes së Kombeve, (1925–1927).

[93]Arkivi i MPJ, Tiranë

RAUF FICO

Rauf Fico, 13 Mars (1881–1994) – diplomat dhe politikan, është lindur në vitin 1881 në Gjirokastër. Ai ka studjuar në Vjenë dhe më vonë në Mekteb-i Mülkiye[94]. Në vitin 1912 ai iu bashkua qeverisë së Vlorës si një këshilltar në Ministrinë e Brendshme. Në vitin 1916, gjatë administratës ushtarake austriake, ai shërbeu si zëvendës prefekt në Tiranë. Në atë pozitë u bë bashkëthemeluesi i Strehes Vorfnore, e para jetimore e ngritur ndonjëherë në Shqipëri. Në vitin 1921, shërbeu si Ministër i Brendshëm i Shqipërisë në kabinetin e Pandeli Vangjelit. Në vitet (1923-1925) u zgjodh deputet i Durrësit. Në fund të viteve 1920, shërbeu si ambasador i Shqipërisë në Turqi dhe në Bullgari dhe në prill të vitit 1929, u emërua Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Por kjo nuk zgjati pasi ai ishte kundër italianëve dhe influencës së tyre në Shqipërinë e asaj kohe. Kështu ai u bë Ambasador në Jugosllavi në vitet (1933-1836), në Greqi në 1937-ën dhe Gjermani në vitin (1938-1939). U arrestua nga italianët dhe u internua në Itali. Vdiq në Tiranë më datën 23 janar 1944 vetëm pak muaj pas kapitullimit të Italisë dhe kthimit të tij në atdhe. Ai është mbajtës i një numri të madh dekoratash ndër të cilat Urdhëri i Kordonit të Madh të Franc Jozefit, i atij të Leoplodit, të Kurorës së Rumanisë, të Kurorës së Italisë, të Foeniksit të Greqisë, Kurorës së Luksemburgut, urdhërin e Skënderbeut, Legjionin e Nderit të Francës, Palmës së Akademisë Franceze, Urdhërit të Borisit të Bullgarisë, Doktor Honoris Causa të Akademisë së Naolit.

[94]Mekteb-i Mülkiye -Fakuteti i Shkencave Politike të Universitetit Shtetëror të Ankarasë.

QATIN SARAÇI, (1935 – 1935)

Qatin Saraçi, (1903-1974) ka shërbyer si i Ngarkuar me Punë i Mbretërisë Shqiptare nga tetori 1935 deri në dhjetor të vitit 1935. Lindi në një familje të njohur shkodrane dhe u bë figurë publike, diplomat dhe piktor shumë i njohur. Ashtu si edhe Eqrem Bej Vlora, ai ka ndjekur Shkollën e Mesme Theresianum në Vjenë me një bursë austriake. Ai u takua dhe u shoqërua që në atë takim të parë me Ahmet Zogun, duke e ndihmuar më pas që të vijë në pushtet. Zogu e përfshiu atë në karrierë diplomatike, duke e emëruar Konsull të Përgjithshëm në Vjenë dhe pas Anschluss–it e emëroi të Ngarkuar me Punë në Londër. Si piktor ekspozoi mjaft nga punët e tij në Londër në vitin 1948. Aty kishte miqësi me piktorin austriak Oscar Kokoschka (1886-1980), të cilin e ndihmoi gjatë viteve të emigracionit në Angli. Saraçi ka udhëtuar nëpër tërë Europën dhe ka botuar edhe një libër për Zogun me titull "*Inside the Story*".

LEC KURTI (1935 – 1939)

Në këtë ndërtesë ka punuar personeli i Ambasadës Shqiptare në Londër nga viti (1936-1938), Egerton Gardens, South Kesington, London SW3.

Lec Kurti (1884-1948) ka qenë Ministër Fuqiplotë i Mbretërisë Shqiptare, i cili shërbeu në Londër nga dhjetori i vitit 1935, deri në prill të vitit 1939. Ai është një figurë shumëdimensionale me një kontribut të madh në shumë fusha të jetës shqiptare, si ajo politike, diplomatike dhe muzikore. Ai është i biri i kompozitorit të njohur Palokë Kurti nga Shkodra. Ka studjuar në Liceun e Pesaros pranë Urbanos dhe më pas në Akademinë e Arteve të Bukura në Venecia. Më vonë ai studioi shkenca politike në Romë dhe shërbeu si përfaqësues i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë. Fatkeqësisht, atij iu dogj shtëpia dhe, mendohet se bashkë me të janë shkrumbuar edhe mjaft krijime të tij muzikore. Nga dorëshkrimet e mbetura mësohet se Lec Kurti kompozoi muzikë në harkun kohor (1908-1916) dhe më pas, duket se iu kushtua në fillim diplomacisë e më pas politikës.

Lec Kurti e fillon veprimtarinë e tij në diplomacinë shqiptare në vitin 1918 fillimisht në Bari si konsull i Shqipërisë (1921-1922), dhe më pas në Athinë si "*I ngarkuar me punë*" (1925-1926), ku merr titullin "*Qytetar Nderi*" i qytetit. Më tej e gjejmë përfaqësues të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë (1930-1935), dhe Ministër Fuqiplotë të Mbretërisë Shqiptare në Londër. Ai ka meritën se nuk ia dorëzoi përfaqësuesit italian Ambasadën Shqiptare në Londër. Gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, Lec Kurti do të ishte nënkyetar i Ballit Kombëtar dhe disa ditë përpara 29 nëntorit 1944, u largua përfundimisht nga Shqipëria. Vdiq në mërgim më1948-ën.

Ambasada Shqiptare ka qenë e vendosur
në këtë godinë, 71 Pont Street London SW,
nga viti (1938-1939)

ILJAZ BEJ VRIONI (1925 - 1926, 1929 – 1932).


ILIAS VRIONI
Ministri i P. Jashtme
(Ministre des affaires étrangères)

Ndërkohë do të vinte **Iljaz Bej Vrioni,** i cili do të drejtonte Ambasadën Shqiptare në Londër. Iliaz Bej Vrioni, u lind në Berat në vitin1882 dhe vdiq në Paris, Francë më 17 mars 1932. Ai ishte djali i Mehmet Ali Pashë Vrionit, patriotit të shquar shqiptar, nënkryetarit të Lidhjes së Prizrenit dhe babai i përkthyesit të shquar Jusuf Vrioni. Iliaz Bej Vrioni, ishte një nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar së bashku me Sami Bej Vrionin. Shërbeu tre herë si Kryeministër i Shqipërisë dhe disa herë si Ministër i Jashtëm dhe si Ministër i Plotfuqishëm i Shtetit Shqiptar në Paris, Francë. Gjithashtu shërbeu për një kohë shumë të gjatë dhe si Deputet i Parlamentit të Shqipërisë. Iliaz Beu ishte gjithashtu kryetari i delegacionit të Beratit në punimet e Kongresit të Lushnjës. Për kontributin e tij të pasur në marrëdhëniet ndërkombëtare, është dekoruar nga Republika Franceze në vitet 1920 me urdhërin e lartë "*Grand Officier de la Légion d'Honneur*". Në vitin 1946, regjimi dikatorial do të zhvarroste eshtrat e ish Kryeministrit Iliaz Bej Vrioni për t'i hedhur ato në Lumin Osum të Beratit. Eshtrat e Iliaz Bej Vrionit vazhdojnë të mbeten të humbura duke e lënë ende këtë personalitet të vyer të kombit shqiptar pa varr. Ai është nënshkrues i Deklaratës së pavarësisë me 28 nëntor 1912, Kryeministër i Shqipërisë tre herë, Ministër i Jashtëm i Shqipërisë pesë herë, Ministër Fuqiplotë në Britani dhe Francë (1925-1926 dhe1929–1932).

DERVISH DUMA (1939 - 1999)

Dervish Duma[95], ka jetuar nëntëdhjetë vjet dhe ishte një prej atyre të paktëve diplomatë të paraluftës, i cili për gjashtëdhjetë vjet mbeti një shërbëtor i shquar i popullit shqiptar, si përfaqësues diplomatik, si spiker transmetimesh radiofonike të luftës dhe udhëheqës jo zyrtar i bashkësisë së shqiptarëve të arratisur nga Shqipëria në Britaninë e Madhe. Ai ishte lindur në Borsh të Sarandës në vitin 1908. Fill pas shpalljes së Pavarësisë, në vitin 1913, Borshi u sulmua nga grekët dhe popullsia e atyshme u shpërnda. Familja Duma shkoi drejt Vlorës. Dervishi vetë, vajti në një shkollë italiane. Në vitin 1920, ai u transferua në shkollën teknike Amerikane në Tiranë si nxënësi i maturës së parë. Në atë kohë, kishte pak nga ata që e flisnin anglishten kështu që, ai në moshën njëzetvjeçare u caktua Sekretar i Përgjithshëm i Xhandarmërisë Shqiptare nën komandën britanike. Komandanti i saj, Majori Sir Jocelyn Percy ia njohu aftësitë Dervish Dumës dhe e ndihmoi të shkonte dhe të studionte administratë publike në Angli, në London School of Economics, nga viti 1933, deri në vitin1935.
Me tu kthyer në Shqipëri, Duma hyri në shërbimin diplomatik dhe iu dha detyra e dyfishtë – Sekretar i Parë i Delegacionit Shqiptar në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë dhe Sekretar i Dytë i Legatës Shqiptare në Londër. Në fillim të vitit 1939 ai mori detyrën e të Ngarkuarit me Punë. Kur më 7 prill 1939 Musolini pushtoi Shqipërinë, Duma u thirr të

[95] *The Independent, 14 May 1998*

kthehej mbrapsht në Tiranë. [96]Ai zgjodhi të rrinte në Britani dhe punoi për kompaninë Bowater dhe që aty ndihmoi shumë për të mbajtur dhe zhvilluar marrëdhëniet me botues Amerikanë. Në vitin 1940 themeloi seksionin shqip të BBC. Që aty, ai u bë zëri i shpresës për shqiptarët. Gjatë viteve të mërgimit të Mbretit Zog, e ndihmoi atë dhe familjen e tij veç të tjerash edhe me anglishten e tij. Ai kishte lidhje me emigracionin shqiptar në Amerikë, ndërkohë që ka shërbyer 62 vjet si drejtues aktiv i Anglo Albanian Association.
Pas rënies së komunizmit ai gëzoi një jetë të re. Njëri pas tjetrit atë e vizituan Kryetari i Parlamentit Shqiptar, Pjetër Arbnori, Presidenti i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova.
Në vitin 1992, ai u bë Konsull Nderi i Shqipërisë dhe u ftua të rihapte shërbimin shqip të BBC, të cilin e kishte mbyllur qeveria e Willsonit për një shpenzim fare të vogël prej 12.000 Sterlinash.
Dervish Duma ka lënë të shkruara poezi në gjuhën shqipe dhe angleze dhe njihej si një përdorues i shkëlqyer i të dy gjuhëve.

[96] Dervish Duma nuk i dorëzoi çelësat e Ambasadës Shqiptare tek Italianët pushtues. Ai i ruajti dhe ia la amanet të birit, Aleksandër Dumës, si relike e kujtimit të asaj ndërpreje mizore të veprimtarisë së shtetit shqiptar.

RIVENDOSJA E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE SHQIPËRI BRITANI E MADHE

Ambasadorët shqiptar në Londër

Marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve u rivendosën falë ndryshimeve të mëdha që ndodhën në Shqipëri pas rënies së Murit të Berlinit dhe, një vit më vonë pas rënies së diktaturës në Shqipëri. Ishin protestat e studentëve shqiptarë që në dhjetor të vitit 1990 detyruan dikatorin shqiptar të lejonte fomimin e partive poltike në vend dhe të drejtën e zgjedhjes së lirë, fjalës së lirë, lëvizjes së lirë dhe tregut të lirë, në Shqipëri. Ishin këto principe, të cilat në fakt vinin nga perëndimi i "*mallkuar*", ai anglo-amerikan, i cili ishte përmbledhur në një libër që bën të skuqet nga turpi këdo, atë që e kujton librin e quajtur "*Rreziku Anglo Amerikan për Shqipërinë*". Kështu u hap rruga e rivendosjes së marrëdhënieve, gjë që ndodhi në datën 29 Maj 1991, me deklaratën e përbashkët të lëshuar nga të dy vendet[97], gjë që mbylli përfundimisht një kapitull të errët në marrëdhëniet mes nesh dhe dy vendeve më mike të Shqipërisë, SHBA– ve dhe Mbretërisë së Bashkuar. Siç është përmendur në këtë libër, ato rifilluan në fillim me një mbulim diplomatik të Mbretërisë së Bashkuar nga Roma, ndërsa në Londër vepronte i biri i diplomatit të fundit shqiptar të Mbretërisë, Dervish Dumës, Alexandri. Ai veproi në kapacitetin e Të Dërguarit të Posaçëm të Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar. Vitin e parë të punës së saj, Ambasada Shqiptare ishte e vendosur në shtëpinë e vetë z. Duma. Pas një viti shteti shqiptar vendosi që në Oborrin e Shën Xhemjsit të përfaqësonte një intelektual i shquar shqiptar, i njohur për kontributin e tij në fushën e njohjes së gjuhës angleze në Shqipëri dhe pikërisht z. Pavli Qesku.

[97]Arkivi i MPJ, dosja e marrëdhënieve me Britaninë e Madhe

PAVLI QESKU (1993 – 1997)

Autori i fjalorit më të madh shqip-anglisht-shqip me 130.000 fjalë

Gjuhëtari i njohur Pavli Qesku u emërua në Londër më 14 prill 1993 dhe më pas i paraqiti letrat kredenciale si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar përpara Madhërisë së Saj, Mbretëreshës Elizabeth II.

Ka lindur në datën 16 qershor 1943 dhe ka studjuar në fakultetin e gjuhëve të huaja në Tiranë nga viti (1964-1968). Ai ka punuar si përkthyes në shtëpinë botuese Naim Frashëri në Tiranë nga viti 1968 deri në vitin 1973. Pas një periudhe si mësues i gjuhës angleze në Gjimnazin e Peshkopisë, ai punoi si përkthyes dhe redaktor në redaksinë e botimeve në gjuhë të huaja në Shtëpinë Botuese "*8 Nëntori*" – më vonë Shtëpia Botuese Enciklopedike (1976-1992). Filloi punë në MPJ në prill të vitit 1992 për një kohë të shkurtër për tu emëruar më pas Ambasador i RSH në Oborrin e Shën Xhejmsit në datën 14 Prill 1993, detyrë të cilën e ushtroi deri në vitin 1997. Gjatë asaj periudhe vendet nënshkruan një seri marrëveshjesh të rëndësishme për dy palët. Pavli Qesku është përkthyes i njohur dhe autori i fjalorit më të madh shqip - anglisht - shqip me 130.000 fjalë, i cili përbën një kontribut të jashtëzakonshëm, jo vetëm për dy kulturat, por edhe për marrëdhëniet dhe lehtësimin e komunikimit midis dy kombeve tona, si dhe të gjitha kombeve anglishtfolëse.

AGIM FAGU (1997 - 2002)

Agim Fagu, është një ndër sportistët më të njohur në Shqipëri. Si basketbollist i ekipit kombëtar të Shqipërisë ai mbahet mend për aftësitë e tij si lojtar i shquar. Ai ka qenë anëtar i Parlamentit Shqiptar dhe më pas nga nëntori i vitit 1997, deri në tetor të vitit 2002, ka shërbyer si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar. Ai ka shërbyer më pas si Drejtor i Drejtorisë së NATO – s në Mnistrinë e Punëve të Jashtme.

KASTRIOT ROBO (2002 – 2007)

Kastriot Robo ka lindur më 30 korrik 1960 në qytetin e Lushnjes. Ai ka shërbyer si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar nga tetori i vitit 2002, deri korrik të vitit 2007.

Ka kryer Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Tiranës dhe më pas studimet pasuniversitare për Politikën e Jashtme dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Ai ka punuar si Shef Sektori në Drejtorinë e Marrëdhënieve me vendet fqinjë në MPJ në vitin (1986–1991). Më pas ka punuar në Kabinetin e Ministrit të Jashtëm, dhe pastaj si Sekretar i Parë në Ambasadën e RSH-së, Athinë, (1991-1994) dhe në Sofje si dhe në hapjen e Ambasadës së Shqipërisë në Tokio (1995-1996). Pas një periudhe shërbimi si drejtor i Çështjeve Rajonale në MPJ ai ka shërbyer si Ambasador i RSH në Athinë, në Mbretërinë e Spanjës, në Madrid dhe momentalisht, ai është Ambasador në Mbretërinë e Danimarkës. Periudha e shërbimit të tij në Londër mbahet mend si një periudhë kur marrëdhëniet e Shqipërisë me Britaninë e Madhe ishin në një ngritje të vazhdueshme. Ai ka bërë një punë të lavdërueshme me bashkësinë shqiptaro – britanike. Në vlerësim të punës së tij ka marrë titullin "*Freeman of the City of London*".

ZEF MAZI (2007 – 2011)

Zef Mazi ka qenë Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë nga viti (2007-2011). Më parë ai kishte shërbyer si Ambasador dhe Përfaqësues i Përhershëm e Republikës së Shqipërisë në OSBE, OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare në Vjenë. Në vitin 1997 ishte Ministër Këshilltar dhe i ngarkuar me punë si dhe Ambasador dhe Përfaqësues i Përhershëm në Kombet e Bashkuara, IAEA dhe OSBE si dhe organizatat ndërkombëtare të akredituara në Vjenë nga viti 1991, deri në vitin 1997 dhe, nga viti 1991, deri në vitin 1992. Ai shërbeu si Ministër Këshilltar dhe i Ngarkuar me Punë në Ambasadat shqiptare në Austri dhe Zvicër. Në vitet 1978, deri në vitin 1986, ka qenë përkthyes dhe editor në shtëpinë botuese "*8 Nëntori*". Ai ka punuar edhe në shërbimin botëror të Radio Tiranës (1975-1985). Që nga Marsi i vitit 2011, Zef Mazi është asistent special i Drejtorit të Përgjithshëm për Strategjinë në Sekretariatin e IAEA.

Dr. TEUTA STAROVA (2008 – 2011), (2011 – 2012)
(E ngarkuar me punë).

Dr. Teuta Starova ka shërbyer si Ministre Këshilltare dhe për një periudhë kohore e Ngarkuar me Punë në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo ka kryer studimet universitare për Filozofi 1985, studimet pasuniversitare (1986-1990) në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike - Juridike, dhe ka vazhduar studimet pasuniversitare jashtë vendit në Universitetin "*Central European University"* (CEU), në Pragë. Para se të shërbente si diplomate ajo ka punuar pedagoge në Katedrën e Historisë së Filozofisë pranë Fakultetit të Shkencave Politike - Juridike, në Departamentin e Filozofisë dhe Sociologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.

Dr. Starova ka një eksperiencë pune edhe në fushën e diplomacisë, pasi ka punuar diplomate në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Britaninë e Madhe, si Ministër Këshilltar nga viti (2008–2013). Në periudhën mars 2011 - shkurt 2012, ajo ka shërbyer si e Ngarkuar me Punë dhe më pas i është kthyer mësimdhënies si pedagoge, lektore e Sociologjisë Politike dhe Historisë së Mendimit Sociologjik Klasik pranë Departamentit të Sociologjisë së Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Mal Berisha (2012)

Ka lindur në vitin 1952, në Tropojë. Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin "*Ismail Qemali*" në Laç, të Kurbinit dhe është diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, Dega e Kulturës. Më pas ka studjuar në shkollën e Diplomacisë në Universitetin Hacetepe në Ankara.

Për një kohë të gjatë është marrë me veprimtarinë kulturore dhe artistike në rrethin e Krujës dhe, ka botuar artikuj për trashëgiminë kulturore – etnografike të kësaj zone.

Në vitin 1992 fillon punë në shërbimin diplomatik të shtetit shqiptar si specialist në Drejtorinë Rajonale të MPJ dhe më pas emërohet në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Stamboll, Turqi ku shërbeu deri në vitin 1997.

Në vitin 1998 – 2000 i bashkohet përpjekjeve të shqiptarëve të Amerikës nën emblemën e Ligës Qytetare Shqiptaro – Amerikane dhe Federatës Pan Shqiptare Vatra në Amerikë për çështjen e Kosovës.

Në vitin 2000 fillon punën si antar i stafit ndërkombëtar të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, (UNMIK). Nga viti 2009 drejton Drejtorinë Konsullore dhe më pas atë Rajonale në MPJ.

Në 17 shkurt 2012 merr detyrën e të Ngarkuarit me Punë në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut dhe Irlandë (jo-rezident) Në 27 Qershor 2013, paraqet letrat kredenciale tek Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth II si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në atë vend dhe me datën 10 tetor 2013 para Presidentit të Irlandës, Sh.T Michael D. Higgins.

Veprimtarinë e tij si diplomat e ka kombinuar edhe me punë studimore dhe botimin e gjashtë librave rreth historisë së marrëdhënieve të Shqipërisë me botën anglo- saksone. Trashëgimia e tij në ambasadën

e Londrës është e lidhur me krijimin e një profili shumë të lartë kulturor dhe artistik të ambasadës me qëllimin e promovimit të vlerave më të mira të kombit shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar. Ndër to spikatin vendosja e bustit të Skënderbeut në Bayswater, organizimi i 145 veprimtarive promovuese ndër to - Edicionet "*Notes On Albania*" dhe "*Java Kulturore Shqiptaro Britanike*". Ai mban titullin "*Commendatore*" i Urdhrit Mbretëror të Franceskut I dhe dekoratën kalorsiake përkatëse. Ky titull nderon individë me merita në jetën publike, shkencore, artistike, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare dhe kombëtare.

Stafi diplomatik i Ambasadës, ditën e paraqitjes së Letrave Kredenciale, 27 qershor 2013.

KONSUJT E NDERIT TË SHQIPËRISË NË MBRETËRINË E BASHKUAR

1. Alexander Duma (30.03.1946)

Alexander Duma është i biri i diplomatit dhe patriotit të njohur Dervish Duma, i fundit diplomat shqiptar që i vuri çelësin ambasadës shqiptare në Londër pas pushtimit Italian të Shqipërisë. Në gjurmët e të jatit ai e ka dëshmuar veten si një patriot dhe dashamirës i kombit të vet, ndonëse është lindur dhe rritur në Angli. Ai ka ndjekur një karrierë shumë të suksesshme në fushën e financave nëpër korporata në Britaninë e Madhe dhe ato ndërkombëtare, duke mbajtur poste drejtuese në mjaft kompani. Ai ka dhënë shumë kontribute të vlefshme në një sërë fushash të tjera, duke përfshirë politikën, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mbështetjen e një numri organizatash bamirësie.

Alexander Duma është marrë shumë me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Britanisë së Madhe dhe Shqipërisë. Ai ka qenë i Dërguar e Posaçëm i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar në periudhën tranzitore nga deklarata e përbashkët për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve, deri në emërimin e Ambasadorit Qesku në Oborrin e Shën Xhejmsit. Më pas u emërua Konsull Nderi i Republikës së Shqipërisë për periudhën (1992-1994). Alexander Duma është anëtar i Shoqatës Anglo-Shqiptare prej vitit 1966 dhe ka qenë kryetar i saj në periudhën (2005-2012). Ai ka inicuar edhe krijimin e Qendrës për Studime Shqiptare, e cila drejtohet nga z. Bejtuallah Destani që në vitin 1998. Në dhjetor të vitit 2014, ai është dekoruar me medaljen "*Nderi i Kombit*", nga Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani.

2. ZONJA BRYONY BETHEl
KONSULL NDERI NË OKSFORDSHIRE

Bryony Bethell ka lindur në vitin 1966 dhe është rritur në Uells dhe në Angli. Ajo mban shtetësi të dyfishtë Britanike dhe Irlandeze dhe ka studjuar Letërsi Angleze dhe Jurisprudencë në Universitetin Kembrixh. Me një të kaluar të pasur në fushën kërkimeve dhe arësim, ajo ka punuar për Autoritetin e Brendshëm Arsimor të Londrës dhe Grupin Saatchi & Saatchi ku ka qenë Drejtore Projekti e specializuar në punë strategjike për projekte transnacionale me qeveritë e vendeve të huaja. Ajo ka pasur një interes shumë të hershëm dhe të vazhdueshëm për Europën Jug Lindore, duke pas udhëtuar nëpër vendet e Ballkanit dhe, duke kaluar disa vite punë në fushatën e Qeverisë Turke për t'ju bashkuar Bashkimit Europian. Një ish-këshilltare lokale në Londrën Qendrore ajo ka qenë kandidate në zgjedhjet e Parlamentit Europian të vitit 1999, duke iu afruar shumë zgjedhjes. Ajo beson se interesat ekonomike dhe strategjike të Britanisë janë shërbyer më së miri prej pjesëmarrjes konstruktive në Bashkimin Europian dhe mbështet fuqishëm aplikimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Interesat e Bryonit në Shqipëri ishin frymëzuar prej bashkëshortit të saj të ndjerë tashmë, Nicholas Bethel, i cili ka shkruar një libër për tradhëtinë e Kim Philby ndaj grushtit anti komunist të shtetit të quajtur "*Tradhëtia e Madhe*". Znj. Bethell ka udhëtuar për herë të parë në Shqipëri në vitin 1991 kur dërgoi edhe një ndihmë mjekësore dhe, takoi shumë aktivistë pro-demokratë. Ajo ka një lidhje të herëshme me Qendrën për Studime Shqiptare e themeluar për të propaganduar njohuritë shkencore për Shqipërinë. Që prej vitit 2013, ajo ka shërbyer si Konsulle e Nderit të Republikës së Shqipërsë në Oksford dhe Midland. Ajo ka privilegjin të jetë mikeshë e të ndjerës Elena Bonner dhe ka pasur rastin të ndajë angazhime të mëdha për të drejtën e vetvendosjes së grupeve të vogla etnike dhe kombeve.

3. ZOTËRI JOHN VAN WEENEN OMT MBE

KONSULL NDERI PËR RAJONIN E NOTHRAMPTONSHIRE

John Van Weenen është shpallur Konsull Nderi i Republikës së Shqipërisë për rajonin e Northamptonshire dhe rrethinë, në vitin 2012. Ai është i dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Urdhërin "*Nënë Tereza*" për merita të veçanta në ndihmat humanitare të dërguara në Shqipëri dhe Kosovë në fillim të viteve nëntëdhjetë dhe, pas luftës në Kosovë, në vitin1999. Ai është një organizator i mbledhjeve të fondeve për ndihma humanitare jo vetëm në Britani, por edhe në Australi. Që prej vitit 1991, është Drejtor i Task Force Albania me regjistrim në British Registered Charity. Ndihmat humanitare të z. Weenen kapin mbi tetë milion Euro për Shqipërinë e viteve (1991-1998) dhe po kaq për Kosovën e pasluftës. Ai ka dërguar në Shqipëri mijëra libra, me qindra kompjutera dhe orendi për shkollat. Ka kontribuar bashkë me të bijtë e tij, të cilët në nderim të punës së babait të tyre kanë mësuar gjuhën shqipe. Ai është një pjesëmarrës aktiv i veprimtarive të Ambasadës Shqiptare në Londër. Presdienti i Republikës së Shqipërisë e ka dekoruar me urdhërin "*Nënë Tereza*" për meritat dhe kontributet e tij me vlerë.

KAPITULLI I KATËRT

PRANIA E PËRFAQËSIMIT DIPLOMATIK BRITANIK NË SHQIPËRI

Legata Britanke në Tiranë, viti 1939.

AMBASADORËT BRITANIKË NË SHQIPËRI

Misioni i parë diplomatik britanik në Shqipëri me seli në Durrës, u hap në janarin e vitit 1922. Pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, ku britanikët luajtën rol përcaktues si dhe konsolidimit të shtetit shqiptar, ishte hapur rruga për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Të dyja shtetet shkëmbyen diplomatët në vendet respektive. Diplomati i parë i Shqipërisë në Londër ishte Mehmet Konica, një ndër patriotët dhe njerëzit me më shumë kontribut në historinë e Shqipërisë, ndërsa ai britanik ishte:

SIR HARRY CHARLES AUGUSTUS EYRES (1922 – 1926)



Sir Harry Charles Augustus Eyres - Është i pari diplomat britanik i dërguar në Shqipëri dhe shërbeu nga viti 1922, deri në vitin 1926. Dihet që britanikët kanë patur një prani konsullore për një kohë të gjatë në qytete të ndryshme të Shqipërisë si në Janinë, Shkodër, Gjakovë, Manastir por këto ishin nën qeverisjen osmane. Prandaj mund të themi se diplomati i parë britanik i akredituar në Shqipërinë si shtet i pavarur ishte Sir Harry Charles August Eyres.

Ai ka lindur me datën 21 korrik 1856 dhe ka vdekur me 17 korrik 1944. Ishte nga Great Melton në Nowfolk dhe kishte studjuar në Merlborough në Wiltshire. Në vitin 1877, pasi kaloi provimet u emërua përkthyes i Ambasadës Britanike në Stamboll. Në vitin 1882, pas një periudhe të shkurtër në Shkodër, mori detyrën e zevendës konsullit në Van, në Turqinë e sotme lindore. Më pas shërbeu si i ngarkuar me punët e zëvendës konsullit në Erzurum (1882-1883) dhe në Bejrut (1885-1887, 1890, 1894) dhe konsull në Damask, 1890. Nga viti 1896, deri sa doli në pension në vitin 1914, ai shërbeu si Konsull i Përgjithshëm britanik në Stamboll. U kthye në shërbimin diplomatic, pas Luftës së Parë Botërore. Posti i tij ishte Konsull i Përgjithshëm dhe Ministër dhe e filloi atë detyrë në janar 1921. Rezidenca e tij ishte në Durrës. Në vjeshtën e atij viti ai bëri një udhëtim në Dibër. Aty ai vizitoi 157 fshatra të shkatërruara nga forcat serbe dhe këtë ia raportoi Lidhjes së Kombeve. Në datën 24 janar 1922, u caktua Konsull i Përgjithshëm dhe Ministër Fuqiplotë. Ai i paraqiti letrat kredenciale para Këshillit të Lartë të Rregjencës më datën 11 mars 1922. Ai ka meritën e madhe se ndërhyri për të ndaluar luftimet në Tiranë midis forcave të Ahmet Zogut nga njëra anë dhe, atyre të Elez Isufit dhe Hasan Prishtinës në anën tjetër. Ai shërbeu në këtë detyrë deri në vitin 1926, kur vendin e tij e zuri William Edmond O'Reilly. Kur doli në pension mori titujt Kalorës i Urdhërit të St Michael-it dhe St Georges (KCMG).

Më datën 2 qershor 2015 në Ambasadën Shqiptare në Londër, u promovua libri i Sir Noel Malcolm, professor i All Soul College në Oksford, "*Agents of Empire*". Në këtë veprimtari mori pjesë edhe gazetari i njohur anglez, Harry Eyre. Prania e tij nuk ishte e lidhur vetëm me miqësinë me Sir Noel Malcolm, por edhe për arësye se ai ishte brezi i katërt, stërnip i Sir Harry Charles Augustus Eyre, Ambasadori i parë britanik në Shqipëri. Ai mban emrin e stërgjyshit të tij dhe ruante shumë relike të tij nga Shqipëria.

WILLIAN EDMUND O'REILLY (1926)

William Edmund O'Reilly (1873–1934) diplomat britanik, i cili shërbeu në Shqipëri për një kohë të shkurtër në vitin 1926. Ai e ka filluar shërbimin diplomatik ndaj Madhërisë së tij në vitin 1901. Më pas nga viti 1919, deri në vitin 1924, është emëruar Ministër në Bolovi dhe në Guatemalë.

SIR WILLIAN SEEDS (1926 - 1928)

William Seeds KCMG (1882–1973) ka qenë diplomat britanik i cili ka shërbyer nga viti (1925-1928) si i Dërguar i Jashtëzakonshëm, Ministër Fuqiplotë dhe si Konsull i Përgjithshëm në Shqipëri. Karriera e tij është shumë e larmishme. Ka shërbyer si Ambasador në Rusi dhe në Brazil. Ai ka lindur në Dublin, Irlandë më datën 27 qershor 1882 në një familje protestante të Ulsterit. Ai fliste perfekt frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, portugalisht dhe rusisht. Ka kaluar dy vjet në Rusi kur ishte i ri nga viti (1899-1901) si student dhe, ka jetuar me disa familje ruse. Ai i hyri shërbimit dilomatik britanik në vitin 1904 dhe shërbeu në Uashington nga viti (1904–1907), pastaj në Legatën Britanike në Pekin (190-1909), në Stokholm 1910 dhe në Ambasadën Britanike në Greqi në vitet (1911–1913), i ngarkuar me punë në Lisbonë të Portugalisë në vitet (1913-1919) dhe me punët e sekretarit të parë në Berlin në vitin 1919. William Seeds u emërua Konsull i Përgjithshëm në Bavari në vitin 1920 dhe më pas i Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë në Republikën e Kolumbias në Bogota (1923-1925) si dhe Ministër Fuqiplotë dhe i Dërguar i Jashtëzakonshëm në Shtetet e Bashkuara (1925–1926). Në vitin 1928, ai mori detyrën e Komisionerit të Lartë Britanik për Rhineland në Coblenz. Pas dy vjetësh u dekorua Kalorës i Urdhërit të St Michael-it dhe atë të St George (KCMB) prej Mbretit George V. Nga viti (1930-1935) shërbeu si ambasador në Brazil, por posti i tij më i rëndësishëm do të mbetej ai i ambasadorit të Mbretërisë së Bashkuar në Bashkimin Sovjetik në vitit (1939-1940).

SIR ROBERT MACLEOD HODSON (1928 – 1936)

Ministër në Shqipëri, Sir Robert MacLeod Hodgson KCMG KBE (25 shkurt 1874 – 18 tetor 1956) ka qenë Ministër Fuqiplotë në Shqipëri në vitin (1928-1936). Studimet i kreu në vitin 1897 dhe iu bashkua shërbimit konsullor britanik. Nga viti (1901–1904) ai shërbeu në Algjer. Më pas shërbeu si zëvendës konsull në Marsejë, në vitin 1904. Në vitin 1906 u emërua agjent tregtar në Vladivostokun e largët dhe u bë zëvendës konsull e më pas konsull në vitin 1911. Aty qëndroi deri në vitin 1919. Në vitin 1919 u emërua agjent tregtar në Moskë. Në vitin 1924 qeveria Britanike e njohu qeverinë komuniste bolshevike por ai u thirr mbrapsht në atdhe. Në vitin 1928 u emërua Ministër në Shqipëri dhe shërbeu deri në vitin 1936. Nga viti 1943 deri në vitin 1945 ai ishte kryetar i këshillit të Shkollës së Studimeve Sllavonike dhe Studimeve të Europës Lindore dhe më pas, në vitin 1944 dhe 1945, ishte këshilltar i Foreign Office. Ai është dekoruar Kalorës i Urdhërit Kalorsiak të St Michael-it dhe St Georges (KCMG). Sir Robert MacLeod Hodgson vdiq në vitin 1956.

SIR ANDREW RYAN (1936 – 1939)

Sir Andrew Ryan ka shërbyer si Konsull i Përgjithshëm në Shqipëri në vitet (1936–1939). Ai ka lindur në vitin 1876 dhe ka vdekur në vitin 1949. Ka studjuar në Christian Brothers College dhe është diplomuar nga Universiteti i Irlandës në vitin 1896. Ai ishte një diplomat britanik i cili shërbeu si Konsull i Përgjithshëm në Kostandinopul nga viti (1924–1930) dhe më pas në Rabat (1930-1936). Ai është diplomati i fundit që shërbeu në Shqipërinë e para luftës së Dytë Botërore. Ka shërbyer si i Dërguar nga Durrësi që nga tetori i vitit 1936, deri në vitin 1939. Ai mbeti si Konsull i Përgjithshëm në Tiranë pas pushtimit Italian të 7 Prillit 1939, deri më datën 17 korrik të atij viti. Një vit më vonë ai doli në pension. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbeu si ndërmjetës i FCO me Mbretin Zog, i cili kishte kërkuar azil në Britani në vitin 1940. Kujtimet e tij janë përmbledhur në volumin e titulluar "*I Fundmi i Dragomanëve*"[98], botuar në vitin 1951. Dokumentet e tij gjenden në Kolegjin e Shën Antonit në Oksford.

[98]The Last of the Dragomans, Sir Andrew Ryan, Geoffrey Bles; First Edition (1951) - Middle East - 351 pages, St Anthony Collage, Oxford.

LAURANCE BARTON GRAFFTEY (1939 – 1940)

Laurence Barton Grafftey – Ka shërbyer nga viti (1939–1940) si Konsull i Përgjithshëm në Durrës dhe pak kohë në Tiranë. Ai iu bashkua shërbimit diplomatik britanik në vitin 1914 si një student përkthyes. Nga viti 1916 deri në vitin 1918, shërbeu si zëvendës konsull në Aleksandri. Në vitin 1919, ai shërbeu si Sekretar i Ambasadës në Kajro. Në vitin 1920, u caktua zëvendës konsull në Jedah dhe më pas në vitin 1923 në Kostandinopul. Ai e mbylli karrierën si Komisioner i lartë në Pakistan. Ky është edhe diplomati i fundit që e la Shqipërinë pas pushtimit fashist italian.

RIFILLIMI I MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE
BRITANI E MADHE – SHQIPËRI Viti (1991 – 1992)

Pas një ndërprerje prej 51 vjetësh marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve rifilluan me shkëmbimin e diplomatëve. Në pritje të një shkëmbimi të tillë, Shqipëria e njohu si të Dërguar të Posaçëm z. Alexander Duma, i biri i diplomatit të fundit të Mbretërisë Shqiptare, Dervish Duma. Më pas diplomati i parë britanik me kredenciale që mbulonte Shqipërinë u bë:

SIR STEPHEN LOFTUS EGERTON (1991 – 1992)

Sir Stephen Loftus Egerton, gjatë shërbimit të tij në Romë (1989–1992) u caktua Ambasador jo-rezident i Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, duke shënuar rifillimin e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe vendit të tij. Ai ka shërbyer si Ambasador britanik në Bagdad, Riad dhe Romë, ku dhe është njohur si arabologu më i mirë në shërbimin diplomatik britanik. Shërbimi i tij në Bagdat dhe takimet me Sadam Hyseinin janë pasqyruar nga gazeta Telegraph si një nga tregimet më interesante për një diplomat britanik. Ai ka lindur në datën 21 korrik 1932 në Indore, në Indinë qendrore dhe iu bashkua shërbimit të jashtëm në vitin 1956. Pas studimeve në Eton kreu studime plotësuese në Liban dhe u dha pas studimeve të arabishtes. Ai ishte dëshmitar i luftërave të Irakut me Iranin dhe Irakut me Kuvajtin.

SIR STEPHEN LOFTUS EGERTON (1991 – 1992)

Sir Patrick Fairweather është një diplomat britanik i cili ka shërbyer si Ambasador në Shqipëri në vitin 1991. Po kështu ka shërbyer edhe në Angola në vitet (1985-1987). Ai ka qenë Drejtor i Fondacionit Butrinti nga viti 1997, deri në vitin 2004. Sir Patrick Fairweather ka kryer Tirinity College në Cambridge i diplomuar për histori. Shërbimi i tij diplomatik përfshin shumë poste ndër të cilat edhe si Këshilltar në Bashkimin Ekonomik Europian në Bruksel.

SIR JOHN STEWART DUNCAN - <u>OBE</u> (1992 - 1996)
I NGARKUAR ME PUNË

Sir John Stewart Duncan <u>OBE</u> është një diplomat britanik i specializuar për Kontrollin Shumëpalësh dhe Çarmatimin si dhe Përfaqësues i Përhershëm në Konferencën e Çarmatimit në Gjenevë në vitet (2006–2011). Ai ka qenë emëruar nga Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeth e II–të, ta përfaqësonte atë si Guvernator në Ishujt British Virgin Islands dhe *de facto* kreu i shtetit në atë territor. Ai e ushtron atë detyrë që prej gushtit të viti 2014. Ai i është bashkuar shërbimit diplomatik të Britanisë në vitin 1980 pasi kishte studjuar në universitetet e njohura si ai i Sorbonës në Francë. Në Tiranë u spostua si i ngarkuar me Punë në vitin 1992 dhe qëndroi në vendin tone, deri në vitin 1996. Kjo sepse Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria nuk shkëmbyen ambasador deri në vitin 1996.

DAVID ARTHUR SLINN (1995 – 1996)

David Arthur Slinn, CMG, OBE, i lindur në vitin 1959 në Nirthampton ka qenë i Ngarkuar me Punë në Shqipëri nga viti (1995-1996). Më parë ka shërbyer si ambasador britanik në Korenë e Veriut. Ai është ambasadori i shtatë i Britanisë në Kroaci. Ka shërbyer gjashtë muaj në Tiranë dhe më pas tre vjet në Beograd në fillim si zyrtar i tregtisë dhe më pas në vitet (1998–1999) si oficer Politik mbi Kosovën. Gjatë ngjarjeve në Maqedoni në vitin 2001, ai ka punuar me NATO–n si pjesë e ekipit që prodhoi Marrëveshjen e Ohrit.

ANDREW TESORÉRE (1996 – 1998)

Andrew Tesorière është një diplomat britanik. Ai shërbeu në Shqipëri nga viti 1996, deri në vitin 1998. Më pas ai shërbeu si Ambasador në Latvi nga viti 2002, deri në vitin 2005 dhe në Algjeri nga viti 2005 deri në vitin 2007. Që nga viti 2008, ai ka shërbyer në OSBE dhe Ambasador në Kyrgistan.

STEPHEN NASH (1993 - 1995) (1998 – 1999)



Stephen Nash ka shërbyer dy herë në Shqipëri, një herë si i ngarkuar me punë (1993-1995) dhe pastaj si Ambasador në vitet (1998-1999). Z. Nash është Kryetar i Shoqatës Anglo – Shqiptare, organizata historike që ka luajtur atë rol të madh historik në fatin e Shqipërisë nën drejtimin e Aubrey Herbert dhe Edith Durham.

Ai e ka filluar karrierën diplomatike në vitet '60. Pas diplomimit në Cambridge dhe një viti studime të gjuhës arabe në Universitein e Londrës filloi punë në Bagdat dhe më pas edhe në Amerikën Jugore dhe Qendrore. Me vonë ai u bë Drejtor i Përgjithshëm i Conning House në Londër, vendi ku mblidhen dhe bëjnë debate, komente, festojnë dhe shkëmbejnë njohuri për gjuhët dhe kulturën e historisë së Amerikës, Spanjës dhe Portugalisë. Ai ka qenë emëruar në Bankok në Traktatin e Organizatës Aziatike dhe më pas në Hapsirën Ajrore Britanike në Britaninë e Madhe. Në vitet '90 ai shërbeu Ambasador në Shqipëri, Gjeorgji dhe në Latvia. Ai ka marrë pjesë në misione si vëzhgues i OSBE dhe BE–së për zgjedhje si në Ukrainë, Rusi, Venezuele, Shtetet e Bashkuara dhe drejtues misionesh vëzhguese në Serbi dhe Rumani. Ai është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në vitin 2014 me titullin "*Për Merita Civile*".

PETER JANUARY (1999 – 2001)

Peter January i lindur në vitin 1952, ka shërbyer në Shqipëri si Ambasador i Britanisë së Madhe nga viti (1999–2001) Më parë ai ka punuar në Qeverinë Qendrore të Madhërisë së saj në agjensitë e komunikimit

DAVID LANDSMAN

David Landsman OBE, i lindur në vitin 1963 ka shërbyer si ambasador në disa vende. Ai ka kryer Kolegjin Oriel të Oksfordit dhe më pas mori një PhD në gjuhësi në vitin 1990 nga Kolegji Claire në Cambridge. Ai iu bashkua shërbimit të jashtëm britanik në vitin 1990 dhe punoi në departamentin e Europës Jugore. Në vitin 1997 ai ishte zëvendës shef i Misionit në Beograd. Pas një turneu në Ballkan dhe Hungari Lansman u emërua ambasador në Republikën e Shqipërisë. Në vitin (2009–2013) shërbeu si ambasador në Greqi.

RICHARD JONES (2003 – 2006)

Richard Jones ka shërbyer në Shqipëri nga Marsi 2003 deri në Nëntor 2006 si ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë. Ai ka kryer studimet në Kolegjin Merton në Oxford në Mbretërinë e Bashkuar për Historinë Moderne. Z. Jones ka filluar si asistent desk oficer mbi kontrollin e armëve në FCO në vitin 1984 për të vazhduar të mbulojë Iranin, Lindjen e Mesme. Në vitin 1991 ishte desk officer për OSBE, FCO në Londër dhe më pas, ai mbulonte Egjyptin, Sudanin Lindjen e Mesme dhe Departamentin e Afrikes në FCO. Në vitin1998 ai ishte zëvendës drejor i Departamentit të Bashkimit Europian në FCO. Në vitin 1999 i hyri mësimit të gjuhës shqipe dhe në mars të atij viti ai u emërua Ambasador në Tiranë, por vetëm për disa muaj. Ai është Ambasador i Bashkimit Europian në Zvicër dhe Principatën e Lihtenshteinit.

FRASER ANDREW WILSON (2006 – 2009)



Fraser Andrew Wilson MBE i lindur në vitin 1949 ka shërbyer si Ambasador në Shqipëri nga 27 Nëntori 2006, deri në vitin 2009 me daljen e tij në pension. Më parë ai kishte shërbyer si zëvendës Konsull i Përgjithshëm në São Paulo si dhe ambasador në Turkmenistan. Ai ka qenë Komisioner i lartë në Seychelles para se të emërohej Ambasador në Shqipëri. Z. Wilson ka punuar në pozicione të ndryshme në FCO në departamentin e Lindjes, dhe departamente të tjera. Sot ai është anëtar i Anglo Albanian Association dhe merr pjesë rregullisht në veprimtaritë e kësaj shoqate.

Ambasada Britanike, sot, në Tiranë, Rruga Skënderbeg, Nr. 12.

FIONA MCLLWAM (2009 – 2012)

Fiona Mcllwham ka shërbyer si Ambasadore e Jashtëzakonëshme dhe Fuqiplotë e Britanisë së Madhë në Tiranë nga viti 2009, deri në vitin 2012. Ajo ka qenë shumë e njohur si diplomatja e re dhe shumë aktive në Tiranë. U kthye në Whitehall në vitin 2015 pas dy vitesh punë në Bruksel si këshilltare e Komisionerit dhe Drejtorit të Përgjithshëm për Zgjerimin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Znj. Mcllwham i është bashkuar shërbimit të jashtëm britanik në vitin 1998 pasi kishte kryer studime të larta master në Zhvillimin Ekonomik. Përveç kësaj, në kuadër të G8–tës dhe rolit shumëpalësh në Londër ajo ka shërbyer në Bosnjë, Irak dhe Uashington.

NICOLAS CANON, 2012

Nicholas Cannon është pasardhësi i zonjushës Fiona McNeill si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Britanisë së Madhë në Tiranë që nga marsi i vitit 2012. Ai i është bashkuar shërbimit të jashtëm britanik në vitin 1988 dhe ka shërbyer në Paris, Nikosia të Qipros, Islamabad si dhe Komisioner i Lartë në Ruanda dhe ambasador jo-rezident në Burundi. Me rastin e emërimit të tij në Shqipëri ai ka thënë:

> *"Është një nder i madh të emërohesh në këtë post në këtë përvjetor të 100 të Pavarësisë së Shqipërisë. Unë mezi pres ti çoj edhe më tej marrëdhëniet e shkëlqyera midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar".*

Marrëdhëniet e Ambasadorit Canon me Ambasadën Shqiptare në Londër kanë qenë të mrekullueshme. Në vitin 2013, ai mbajti një leksion në UCL me një grup të gjerë të interesuarish anglezë dhe shqiptarë ku bëri një analizë dhe prognozë të Shqipërisë në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të atij viti.

Siç shihet, Mbretëria e Bashkuar përherë ka emëruar në Shqipëri diplomatë të zgjedhur dhe me shumë emër në Foreign and Comunwelth Office.

KAPITULLI I PESTË

ÇLIRIMI I KOSOVËS RIPARIM I NJË PADREJTËSIE HISTORIKE. VENDOSJA E MARRDHËNIEVE KOSOVË – BRITANI E MADHE

Kapriçot e historisë nganjëherë janë të paparashikueshme. Aty ku nisi njohja gjymtarake e shtetit shqiptar, aty u vërtit përsëri historia dhe u kthye për të gjetur një zgjidhje për një pjesë të atyre tokave që Konferenca e Londrës i kishte lënë jashtë shtetit amë. Ka shumë shkolla dhe doktrina që thonë se ishin britanikët ata që e gjymtuan Shqipërinë. Por thjesht pse Konferenca e Ambasadorëve u mbajt në Londër, nuk mund të përkthehet në hedhje të tërë barrës së fajit pikërisht tek Britania e Madhe. E kundërta mund të jetë e vërtetë. Supozojmë se nuk do të kishte fare Konferencë të Londrës! Ose supozojmë se do të kishte një Konferencë të Moskës, ose Parisit për Shqipërinë! Çfarë do të ndodhte?! Mbase nuk do të kishte fare shtet shqiptar, por grupe etnike shqiptare në shtete të ndryshme. Eduard Grey ishte iniciatori i thirrjes së asaj Konference, rezultatet e së cilës dihen. Me atë konferencë, kemi këtë Shqipëri që kemi sot. Pa atë konferencë nuk dimë se çfarë do të kishim. Pra:

A do të kishim Shqipëri?

Ajo që dimë me siguri është se me Konferencën e Ambasadorëve tw vitit 1913, Shqipëria u njoh si shtet, Kosova mbeti nën Serbinë. Toka të tjera shqiptare mbetën në vise të tjera rreth e rreth vendit nën sundimin e huaj. Kështu u krijua shteti i vetëm në botë që rrethohet i tëri nga popullsia e vet, shqiptare. Por duket se do të vinte një ditë kur të paktën një pjesë e rëndësishme e padrejtësisë historike do të korrigjohej. Duhej çliruar Kosova. Po! Pas 87 vjetësh robëri. Dhe për të ndodhur kjo, përsëri duhej dora, aksioni dhe vula britanike. Në këtë periudhë kritike, kur një pjesë nga më vitalet e kombit po shkonte edhe një herë në zgrip të zhdukjes, ishin anglo – amerikanët që e morën situatën në dorë. Në këtë kuadër ia vlen të theksohet se i tërë shteti britanik, udhëheqja e urtë e Madhërisë së Saj, Elizabeth e II–të dhe sigurisht Kryeministri Tony Blair në bashkëpunim me ShBA dhe vendet antare të NATO – s u aktivizuan për të gjetur një zgjidhje. Dhe angazhimi nuk ishte individual si shtet, por më shumë se aq në arenën ndërkombëtare. Pas kaq vitesh del e qartë se vepra e britanikëve në dobi të Kosovës ka qenë përcaktuese. Në vend të komenteve do të desha të citoja pjesë nga dy fjalime të Kryeminstrit të atëhershëm Tony Blair; njëri në Parlamentin Britanik një natë para sulmeve ajrore të NATO–s kundër caqeve ushtarake serbe dhe, tjetri në Parlamentin e Kosovës i ftuar për të parë me sytë e tij Kosovën pas njëmbëdhjetë vitesh të asaj lufte.

TONY BLAIR:

Ne duhet të veprojmë për të mbrojtur jetët e mijëra njerëzve të pafajshëm, burra, gra dhe fëmijë[99].

Zonja Kryetare e Parlamentit!

"Merret me mend se takimi i radhës i Hollbrukut nuk do të prodhojë ndonjë ndryshim në pozicionin e Milosheviçit dhe represioni serb në Kosovë do të vazhdojë. Prandaj Britania qëndron e gatshme të ndërmarrë veprime ushtarake bashkë me aleatët e NATO–s. Neve na duhet të përjashtojmë atë që do të ishte një katastrofë humanitare. Më lejoni t'ju bëj të ditur se një çerek milioni njerëz të Kosovës, ose thënë ndryshe10 për qind e popullsisë, është e pa strehë mbi kokë, si rezultat i shtypjes serbe. 65.000 vetë janë dëbuar nga shtëpitë e tyre muajin e kaluar dhe jo më pak se 25.000 vetë, vetëm brenda katër ditëve qëkurse bisedimet për paqë u ndërprenë. Vetëm dje, 5.000 vetë nga zona e Serbicës janë nxjerrë me forcë nga fshatrat e tyre. Pothuajse pjesa më e madhe e Drenicës është pastruar prej shqiptarëve etnikë. Cdo vëzhgues i UNCHR mund të shohë flakët që i dalin Gllogovcit dhe Serbicës.

Më tej ai vazhdon me këtë tablo të zymtë duke nënvizuar se 2000 vetë kanë vdekur që në verën e kaluar. Me siguri që po mos të ishin vëzhguesit ndërkombëtarë ky numër do të ishte shumë më i madh.

Ne veprojmë të shtyrë nga përvoja e hidhur e përjetuar gjatë këtij shekulli më së shumti në Bosnjë ku destabilizmi dhe lufta civile në një pjesë të Ballkanit pashmangshëm përhapet në tërë rajonin dhe madje ka efekt edhe në pjesë të tjera të Europës.

Në qoftë se Kosova lihet në mëshirën e shtypjes serbe, nuk ka vetëm rrezikun e mundësisë së nxitjes së trazirave në Shqipëri, por destabilizohet Maqedonia dhe pasi të trokasë në Bosnjë, ajo do të ketë ndikim në Greqi dhe Turqi. Interesa strategjike të tërë Europës janë në rrezik. Ne nuk mund të lejojmë të ndodhë një shkatërrim, kaos dhe disintegrim në derën e Bashkimit Europian. Dhe së fundmi, zonja kryetare, ne i kemi premtuar diçka popullit të Kosovës. Mijëra syresh u kthyen në shtëpitë e tyre si rezultat i pushimit të zjarrit që negociuam tetorin e kaluar. Ju kemi thënë atyre dhe Milosheviçit se nuk do ta tolerojmë shtypjen brutale ndaj popullsisë civile. Pas masakrës së Reçakut këto kërcënime ndaj Milosheviçit janë përsëritur. Nëse i lemë në baltë tani, jo vetëm që do të shkatërrojmë besueshmërinë e NATO–s por edhe më shumë se kaq, do të humbasim besimin e mijëra civilëve të pafajshëm dëshira e të cilëve është të jetojnë në paqe.

[99]Fjalimi i Kryeministrit Toni Blair mbajtur në Dhomën e Komunave të Parlamentit Britanik me datën 23 mars 1999, në prag të fillimit të goditjeve ajrore kundër caqeve ushtarake të Milosheviçit.

Unë i them popullit britanik se ne kemi një përgjegjësi të madhe si qeveri kur i dërgojmë forcat tona në beteja për të justifikuar një veprim të tillë. Unë ju paralajmëroj: Rrjedhojat potenciale të aksionit ushtarak janë serioze edhe për NATO–n edhe për popujt e rajonit. Vuajtjet e tyre nuk mund të mbarojnë brenda natës. Por në gjykimin tim, pasojat e mos veprimit janë edhe më serioze edhe për jetën e njerëzve edhe për vetë paqen.

Ne duhet të veprojmë për të mbrojtur mijëra jetë burrash, grash dhe fëmijësh nga katastrofa humanitare, nga vdekja, barabarizmat dhe spastrimi etnik prej një diktature brutale; të sigurojmë stabilitetin e rajonit të Ballkanit ku siç e dimë çdo destabilizim mund të përfshijë në kaos tërë Europën. Ne nuk kemi zgjedhje tjetër veçse të veprojmë, dhe të veprojmë siç duhet derisa Milosheviçi, edhe tani nëse do, të zgjedhë rrugën e paqes.

Aksioni i NATO–s' do të jetë në formën e goditjeve ajrore. Ai do të mbështetet nga vendet e NATO–s dhe do të ketë objektiva minimale për të zvogëluar represionin e vazhdueshëm në Kosovë me qëllim që të shmanget një katastrofë humanitare. Prandaj objektivat e sulmit do të jenë qarqet ushtarake të diktaturës serbe. Për të shmangur një aksion të tillë Miloshevici duhet të bëjë atë që premtoi në tetor: T"i japë fund terrorit, të tërheqë trupat e tij në kazerma dhe t'i zvogëlojë deri në masën që kemi rënë dakord; të tërheqë nga Kosova tanket, artilerinë e rëndë dhe armët tjera që i ka sjellë në Kosovë vitin e kaluar. Ai duhet të pajtohet me propozimet e bëra në Rambuje duke përfshirë edhe lejimin e futjes së një force tokësore të NATO–s."

Ky ishte në përgjithësi fjalimi i Kryeministrit Britanik Blair një natë para sulmit të NATO–s drejtuar qarqeve ushtarake serbe të cilat zgjatën nga 24 Marsi deri me datën 12 qershor 1999, për 78 ditë. Aleanca e tij me Presidentin Bill Clinton dhe natyrisht me vendet anëtare të NATO s sollën çlirimin e Kosovës. Por roli i Blairit ishte shumë i veçantë dhe shumëkush e quan si forcën tërheqëse më të rëndësishme në ndërmarrjen e aksionit ushtarak kundër Milosheviçit.

Pas afro 10-vjetësh Toni Blair mbajti një fjalim tjetër, tashmë në parlamentin e Kosovës, i zgjedhur në mënyrë demokratike në paqen për të cilën ai kishte kontribuar aq shumë.[100]

Z. President, z. Kryeministër!

Urime!

Unë jam krenar për ju![101]

Më kujtohet fundi i vitit 1998, kur Downing Street u vizitua nga Ibrahim Rugova. Ai ishte burrë i qetë dhe modest. Më fali një dhuratë të vogël me kristale të bardha dhe të purpurta. E mbajta gjatë tërë kohës sa isha në Downing Street në tavolinën time. Tani gjendet në raftin e gjërave

[100] Nga fjalimi i Tony Blairt në Kuvendin e Kosovës me datën 9 qershor 2010.
[101] Të dyja të thëna në gjuhën shqipe

të mia të vyera. Ai ma tregoi të vërtetën për Kosovën, vuajtjet e popullit të tij, nevojën që ta dëgjonte bota, detyrën që bota të vepronte. Ai nuk fliste me zë të lartë as nuk e paraqiti hallin e tij me sllogane apo gjeste ekstravagante. Ai thjesht fliste butësisht, me një sinqeritet mbresëlënës. Kur u largua më tha:

> "*Ju lutem, ju kërkoj vetëm këtë: Mos e lër popullin tim të vuaj edhe më! Ndjehu për ta siç do të ndiheshe për popullin tënd! Dhe na ndihmo*!"

I thashë se Britania do t'ju ndihmojë. Ia dhashë "***besën***"[102]**fjalën** time. Dhe e mbajta. Sot e kujtoj Ibrahim Rugovën dhe e nderoj për lidershipin e tij, zgjuarsinë dhe përkushtimin. Unë e nderoj atë që keni arritur deri tani. Veçanërisht, isha i kënaqur të shihja qeverinë tuaj, Hashimin të punojë metodikisht me zyrën e Peter Faithit.
Por ju lutem vazhdoni kështu, bëni kilometra ekstra. Të gjithë shqiptarëve të Kosovës iu them atë që ju tanimë e dini:

> *Nëse siguroheni se kujdesi i qeverisë dhe i institucioneve të Kosovës arrijnë deri tek anëtari më i fundit i çdo bashkësie, atëherë secili syresh do të luajë pjesën e vet për ta bërë këtë vend që ju përket të gjithëve një vend të mrekullueshëm.*

Ata tashmë janë në qeveri, janë në polici, dhe nevojitet të bëhen gjykatës, në gjykatat tuaja. Dhe më në fund kur të keni ushtrinë tuaj, do jenë të gatshëm për të kontribuar në NATO, pasi edhe ndihma e tyre nevojitet, gjithashtu. Tërë ata që jetojnë në Kosovë janë kosovarë. Dhe janë ata që do ta shkruajnë të ardhmen si një komb, si një popull, të barabartë para ligjit. E ardhmja juaj është në Bashkimi Europian i cili për vete është shumë etnik dhe i gëzohet larmisë së vet.

Unë e dua sllloganin tuaj të kohëve të fundit – Kosova – Europianët e Rinj.[103]Jeni vendi më i ri i Europës me popullsinë më të re në kontinent. Ju keni qenë të përfshirë në luftra të gjata për liri. Por tani ju keni shtetin tuaj. Europa do t'ju mbështesë."

Pas shumë porosish për demokracinë, bashkëjetësën, zhvillimin ekonimik, Toni Blair e mbyll fjalimin e tij me fjalët:

> "*Njëmbëdhjetë vjet më parë, i ulur në një tendë në Maqedoni, mendime të tilla do të dukeshin të pamundura. Por ju keni treguar se ajo çfarë është e pamundur mund të bëhet e mundur. Tregoni të njëjtin shpirt tani. Tregoni të njëjtin guxim! Tregoni të njëjtin përkushtim për t'i arritur*

[102] Shqip në origjinal
[103] Kosova – The Young Europians

gjërat! Dhe do t'i arrini. Paçi fat dhe faleminderit! Ndjehem i nderuar që ju ndihmova. Është kënaqësi që jemi bashkë. Do të jetë privilegj që të jem pjesë e të ardhmes tuaj. Faleminderit!"

Dy fjalimet e Toni Blair-it në dy parlamentet, atë britanik dhe atë të Kosovës janë momente ku spikati oratoria e tij në mbështetjen që i dha Kosovës. Çlirimi i Kosovës dhe kujdesi që Mbretëria e Bashkuar ka treguar për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni janë rrjedhojë e një politike shekullore në dobi të kombit shqiptar. Tani z.Blair fliste me zërin e kombit britanik.

10 korrik 2015 – Tony Blair përshëndet inagurimin e këngëtares Rito Ora si Ambasadore Nderi e Republikës së Kosovës në MB, në selinë e Ambasadës së Kosovës, Londër.

Më datën 10 korrik 2015, në ndërtesën e Ambasadës së Republikës së Kosovës vërshuan shumë miq të Kosovës dhe natyrisht të shqiptarëve. Atë ditë Presidentja e Kosovës zonja Atifete Jahjaga dekoroi yllin e muzikës angleze Rita Ora me titullin Ambasadore Nderi e Republikës së Kosovës. Aty u gjendën një numër ambasadorësh, ish drejtues të NATO–s, si Lordi Robertson dhe vetë Toni Blair me të shoqen. Në atë fjalim të asaj dite, Toni Blair tha se dikur as në ëndërr nuk do ta kishim parë që Kosova të kishte një Ambasadë si kjo bash në zemër të Londrës.

AMBASADA E KOSOVËS NË LONDËR

Njohja e britanikëve me jetën, kulturën, traditën, lashtësinë, gjuhën e popullit shqiptar deri në vitin 1912 është bërë nëpërmjet udhëtarëve të vet të cilët i binin kryq e tërthor vilajeteve shqiptare nën perandorinë turke. Po ashtu kur flitej për fatin e Shqipërisë në periudhën otomane nënkuptoheshin katër vilajetet shqiptare, Manastiri, Shkodra, Janina dhe Shkupi. Këtu përfshihej edhe Kosova. Kjo bënte që britanikët të mësonin për shqiptarët pa dallim se nga cila krahinë, cep apo rajon i trojeve shqiptare merreshin këto përshtypje për shqiptarët. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912, luftrave ballkanike, ndërtimit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, nën pushtimin e të cilit mbeti Kosova, ngadalë u krijua një koncept pak ndryshe për shqiptarët që nuk jetonin nën një qeverisje shqiptare të përbashkët. E njëjta gjë vlen edhe për shqiptarët të cilët mbetën nën Greqinë dhe Maqedoninë. Padrejtësia historike që iu bë popullit shqiptar, në të gjitha trojet e veta, u korrigjua, të paktën në një pjesë të vet, pra në Kosovë me shpalljen e pavarësisë së saj me datën 17 shkurt 2008.

Mbretëria e Bashkuar është ndër vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës (e shtata në radhë) dhe e deklaroi këtë një ditë pas shpalljes së këtij akti, më datën 18 shkurt 2008.[104]

---

[104] Festën 28 nëntorit, në vitin e parë të pavarësisë së Shqipërisë, e kam festuar në vitin 1999 në Prizrenin historik bashkë me një grup shqiptaro – amerikanësh të drejtuar nga i nderuari, Joseph DioGuardi, ish kongresmeni amerikan me prejardhje arbëreshe që kishte bërë aq shumë për çlirimin e Kosovës. Ishte festa e parë në Kosovën e dalë nga lufta dhe të lirë. Ndërsa katër vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës pata nderin ta festoj në Corinthian Hotel në Londër, në ditën e parë të punës time në Mbretërinë e Bashkuar, me stafin e Ambasadës së Kosovës dhe Shqipërisë si dhe me trupin diplomatic të akreditуar në Londër.

Përpara se të vihej tek kjo ditë feste, në Londër, ishin bërë shumë përpjekje nga shqiptarët e vendosur në këtë vend në bashkëpunim me shumë britanikë. Nga fundi i vitit 1991, me iniciativën e një grupi aktivistësh të një dege të sapo formuar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe me aprovimin e Qeverisë së Kosovës në mërgim, u paraqit një kërkesë tek autoritetet britanike për themelimin e një qendre për informim në Londër. Autoritetet britanike lejuan hapjen e qendrës duke e bërë të ditur se ajo nuk do të kishte status diplomatik. Qendra, ndërkaq, gëzonte mbrojtjen dhe kujdesin e shtetit britanik. Qendra e filloi aktivitetin e saj duke identifikuar anëtarë parlamenti dhe institucione të tjera që do të mund të interesoheshin për çështjen e Kosovës dhe duke mbajtur autoritetet britanike vazhdimisht të njoftuara me gjendjen në Kosovë. Kosova në këtë kohë ua tërhiqte vëmendjen të huajve e prirë nga lideri i LDK-së, Dr. Ibrahim Rugova.

Pas rihapjes së Ambasadës së Shqipërisë me rënien e regjimit komunist, Qendra ka zhvilluar gjithë aktivitetin e saj në bashkërendim të përbashkët me të. Pra siç shihet ajo në atë kohë kishte vepruar si një zyre diplomatike edhe pse pa asnjë status. Të tilla kishte shumë në atë kohë në shtetet e ndryshme, por unë veçoj këtu atë të Stambollit e drejtuar nga z. Enver Tali me të cilin bashkërenduam punën e Konsullatës Shqiptare të Stambollit, shqiptarëve të Turqisë dhe asaj që njihej si Konsullata e Republikës së Kosovës në Vilajetin e Stambollit. Në Britani kjo zyrë ishte marrë me ndërkombarizimin e çështjes, me ndërgjegjësimin e politikës britanike, por edhe me ndihmat humanitare në drejtim të Kosovës. Një numër shqiptarësh nga Kosova por edhe nga Shqipëria që jetonin në Britaninë e Madhe u kthyen në Kosovë për të luftuar për çlirimin e saj. Ndër ta ishte Endrit Cara nga Kavaja, i cili ra në

Ambasada e Republikës së Kosovës u hap në Londër në tetor të vitit 2008. Për disa kohë ajo ka vepruar në këtë ndërtesë, nw Pall Mall Nr100. Ambasador i Jashtëzkonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Kosovës në Oborrin e Shën Xhemjsit u emërua Dr. Muhamet Hamiti.

Ndërtesa ku ka qëndruar disa kohë Ambasada e Kosovës në Londër, 100 Pall Mall.

luftë në Kosovë. Ai mbetet shembulli më i lartë i patriotizmës së tyre. Shqiptarët e Britanisë së Madhe kanë të drejtën të jenë krenarë për atë që që kanë bërë në atë kohë.

Dr. MUHAMET HAMITI (2008 - 2012)

Dr. Muhamet Hamiti ka lindur më 12 shkurt 1964 në Dumnicë të Podujevës, Kosovë dhe ka kryer studime për letërsi në Prishtinë, Zagreb (Kroaci) dhe Londër. Ka doktoruar me temë për prozën e Joseph Conrad-it dhe James Joyce-it. Ai është autor i një libri monografik për shkrimtarin anglez E. M. Forster. Dr. Hamiti ka botuar shkrime për letërsinë angleze dhe amerikane, por edhe shqipe. Aktualisht është profesor i letërsisë angleze në Universitetin e Prishtinës.

I angazhuar në lëvizjen për pavarësinë e Kosovës, ai ka qenë bashkëpunëtor i ngushtë i Presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, duke qenë edhe zëdhënës edhe këshilltar i tij në vitet (2002-2006). Më vonë punoi këshilltar politik i pasaardhësit të Rugovës, Presidentit Fatmir Sejdiu. Ai ka qenë anëtar i delegacionit të Kosovës në bisedat ndërkombëtare për përcaktimin e statusit të Kosovës në vitet (2006-2007). Themelues i Ambasadës së Republikës së Kosovës në Londër më 2008 dhe ka shërbyer si ambasador deri në shtatorin e vitit 2012. Ndërkohë ai ishte ambasador jorezident në Zelandë të Re dhe në Irlandë. Me emrin e tij lidhet fillimi i një periudhe të re marrdhëniesh midis dy vendeve.

Ndërkohë që Ambasadën e drejtonte Dr. Hamiti, zëvendës i tij ishte një emër shumë i njohur i letrave shqipe që rrjedhin nga studiuesit britanikë dhe pikërisht z. Bejtullah Destani.

BEJTULLAH DESTANI (2018 – 2014)

Bejtullah Destani, studiues, diplomat, themelues dhe drejtor i Institutit të Studimeve Shqiptare në Londër.

Bejtullah Destani, ka lindur në Prizren. Pas shkollës fillore dhe të mesme në vendlindje ai filloi studimet në shkencat politike në Beograd në vitin 1980. Më 1986 publikoi në Beograd, librin e tij të parë "*Bibliografi e Zgjedhur e Librave mbi Shqipërinë (1850-1984)*". Në vitin 1991 emigroi në Londër ku i kushtoi jetën studimeve shqiptare – britaniko, duke bërë zbulime të rëndësishme për historinë shqiptare në bibliotekat dhe arkivat angleze, gjermane, austriake, italiane, turke e më gjerë. Nga viti (2008–2014) ai ka shërbyer si Sekretar e më pas Ministër Këshilltar, zv/Ambasador në Ambasadën e Kosovës në Londër. Ai është themeluesi i Qendrës për Studime Shqiptare në Londër dhe ka arritur, si kreu i kësaj qendre, të publikojë apo ripublikojë një numër të konsiderueshëm veprash të rëndësishme për studimet shqiptare. Veprimtaria e studiuesit Bejtullah Destani është e asaj rëndësie pa të cilën nuk mund të mendohet historiografia e sotme shqiptaro-britanike. Ai sot punon Ministër Këshilltar në Ambasadën e Kosovës në Romë.

LIRIM GREIÇEVCI (2012)

Ambasada e Republikës së Kosovës u drejtua më pas nga Sh.T z**.** Lirim Greiçevci Ambasadori i dytë i Kosovës në Oborrin e Shën Xhemjsit. Ai është emëruar Ambasador në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandën e Veriut dhe në Irlandë (jo-rezident) në datën 18 tetor 2012 dhe i ka paraqitur letrat kredenciale më datën 11 dhjetor 2012. Para se të emërohej në këtë detyrë, ai ka punuar si këshilltar politik i kryeministrit të Republikës së Kosovës nga janari i vitit 2008. Nga marsi i vitit 2010, deri sa u emrua në detyrën e Ambasadorit, ka qenë anëtar i delegacionit të Kosovës në atë që njihet si "*Dialogu i Lehtësuar nga Bashkimi Europian*", mbi çështjet praktike me qeverinë e Serbisë. Në veprimtarinë e tij deri tek shpallja e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, z. Greiçevci ka shërbyer si koordinator i përkohshëm për transferimin e pushtetit nga administrata ndërkombëtare tek qeveria e re e sapo formuar kosovare. Ai erdhi në këtë detyrë pasi kishte shërbyer si sekretar privat dhe këshilltar special i udhëheqësit të Partisë Demokratike të Kosovës. Nga viti 2007 deri në vitin 2008 z Greiçevci ka studjuar politikat krahasuese në Universitetin e Biznesit dhe të Teknologjisë në Prishtinë. Përveç kësaj, ai shërbeu gjithashtu me Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe për gazetën e përditëshme ''*Koha Ditore*'' në seksionin e saj në gjuhën angleze. Z. Greiçevci ka kryer studimet e larta në shkenca politike dhe administratë publike dhe mban një diplomë në gjuhën dhe letërsinë angleze nga Universiteti i Prishtinës si dhe ka kryer master për politikat krahasuese, (nacionalizmi dhe etniciteti) nga London School of Economics dhe Shkencave Politike si një studiues Chevening. Ai ka lindur më datën 26 mars1976, në Prishtinë. Sot ambasada e Kosovës gjendet në adresën 8 John Street London WC1N2ES.

KAPITULLI I GJASHTË

SHOQATAT SHQIPTARO – BRITANIKE NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Në Britaninë e Madhe shqiptarët janë organizuar në shoqata të cilat përfshijnë një numër të madh të tyre. Ato kanë më së shumti karakter edukativ dhe humanitar. Duke përjashtuar Shoqatën e njohur me tre AAA, Anglo-Albanian Association, shoqatat e tjera janë formuar pas vitit 1990, ose më mirë të themi pas vitit 1997, kohë kur një numër i madh shqiptarësh vërshuan drejt Britanisë së Madhe.

Prej disa vitesh në Londër vepronte një Zyrë Ndërlidhëse e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në një mision fisnik për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe edukimin e britanikëve me ato që po ndodhnin në Kosovë nën shtypjen e pamëshirshme të regjimit shovinist serb.

Kësaj mase shqiptarësh pa dallim se nga vinin, iu bashkuan grupe nga tëra trojet shqiptare. Kështu me tu vendosur shqiptarët përbashkëtazi krijuan një varg shoqatash në të cilin aderonin lirshëm pa marrë parasyshë se nga vinin. Këtë e lehtësonte sidmos liria që ata gëzonin në këtë vend të lirive për të drejtën e mbledhjes, organizimit dhe shprehjes së dëshirave të tyre të çfarëdo karakteri që të ishin. Kuptohet që në themel të veprimtarisë së tyre ishte edukimi i fëmijëve, ruajtja e traditës kombëtare shqiptare dhe lidhjet me kulturën e atdheut.

Shoqatat e mëposhtme janë më të njohurat, ndonëse disa prej tyre duket se nuk kanë shumë anëtarësi ose nuk kanë një anëtarësi solide por ndoshta fluide. Ambasada ka të rregjistruara këto shoqata: Ardhmëria, Shpresa Program, Faik Konica, Dituria, Peja, Mother Tereza Union, Albanian Association South East London, Albanian Association for Mental Health, Albanian Culture and Arts, Sfida, Krijuesit Letrarë, ABC Project, Dituria Action, Hillington Albanian Speaking Community, Illyria Oxford, Besa, Media, Nënë Tereza – Albanian Community, Illyria Birmingham, Albanian Network Woman, etj.

Ambasada ka ndjekur me shumë kujdes dhe me prani thuajse të përherëshme veprimtaritë e shoqatave të mëposhtme. Pa minimizuar punën e shoqatave të tjera duhet thënë se shoqatat e mëposhtme kanë një veprimtari të dukshme, koherente dhe të organizuar e strukturuar mirë me programe të qarta dhe objektiva të mirëmenduara.

Por organizata më e vjetër dhe që ende zhvillon veprimtarinë më të sukseshme është:

ANGLO ALBANIAN ASSOCIATION

Shoqata Anglo – Shqiptare (AAA) rrjedh prej Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë të themeluar në vitin 1912 prej Aubrey Herbert, diplomati i mirënjohur, studjuesi dhe parlamentari i shquar britanik dhe miku më i madh i shqiptarëve i njohur në Britaninë e Madhe.[105] Qëllimi i atij komiteti ishte të mbronte të drejtat e shqiptarëve për pavarësi. Sekretare e tij u bë Edith Durham e cila kishte fituar famë si një korrespondente, udhëtare dhe studiuese antropologe e Ballkanit.

Pas Luftës së Parë Botërore, Shoqata i ndoqi me vëmendje ngjarjet në Ballkan duke u bërë një kanal i rëndësishëm nëpërmjet të cilit çdo lajm që vinte nga Shqipëria do t'i kalonte qeverisë britanike dhe publikut të gjerë. Nëpërmjet Aubrey Herbertit dhe Edith Durham ata angazhuan Lordin Robert Cecil, Lordin Balfour, një nga autoritetet më të larta të Brtiansë së Madhe dhe historianin M. Fisher në një luftë të principtë për anëtarësimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve .

Pas Luftës së Dytë Botërore, shqetësimi i saj i parë ishte fati i të mërgurave që iknin nga rregjimi represiv i Tiranës. Sapo ra komunizmi në vitin 1991 dhe vendi mori rrugën e demokracisë, shoqata i rivendosi dhe forcoi marrëdhëniet me Shqipërinë në shumë aspekte të punës së saj.

"AAA" është në një farë aspekti simotra e shoqatave shqiptare në mërgim ku do të veçoheheshin dy prej tyre: Federata Pan – Shqiptare VATRA e Bostonit dhe ajo, Vëllazëria Turko – Shqiptare[106] në Staboll të cilat

[105] Albanian's greatest Friend, Aubrey Herbert.
[106] Türk ve Arnavut Kardeşliği Derneği, Istanbul.

ekzistojnë edhe sot dhe po ashtu vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet midis vendeve përkatëse me Shqipërinë.

Që prej fillimit të viti 2012, Ambasada Shqiptarë në Londër e ka trajtuar atë si një institucion shumë të afërt të saj duke i dhënë hapsirë brenda objektit ku ajo e zhvillon veprimtaritë e sajë. Aty janë organizuar një seri veprimtarishë në shërbim të marrëdhënieve midis dy vendeve si promovime librash të autorëve anëtarë të shoqatës më së pari, pastaj të autorëve anglezë, shfaqje filmash shqiptar, përkujtime datash historike të Shqipërisë, leksione nga profesorë të nderuar universitetesh britanike, takime me diplomatë, pjesëamrrje në veprimtari të ambasadës. Të tëra këto dhe shumë të tjera e kanë gjallëruar jetën e shoqatës, por edhe të vetë ambasadës. Një nga veçoritë e kësaj shoqate sot është, se ajo ruan një nivel shumë të lartë intelektual të veprimtairisë së saj. Atë e ka drejtuar Harry Hodgkinson, ish diplomati shqiptar Dervish Duma. Anëtarët e tjerë të shoqatës kanë qenë figura të rëndësishme si Lord Lamington, i njohur për qëndrimet e tij në Parlamentin Britanik pas Konferencës së Londrës 1915, aktorët e famshëm shekspirian Antony Quiayle, ish officer i SOE dhe Philip Merdoc.

Edhe antërsia e sotme e saj është për tu admiruar. Presidenti i saj i nderit është Sir Noel Malcolm i njohur për kontributin e tij në shkrimin e Historisë së Kosovës si dhe vepra tjera sic është "*Agjentët e Perandorisë"*, një Histori Shqiptare e Shekullit të 16–të. Kryetar është ish ambasadori britanik në Tiranë z Stephen Nash ndërkohë që vazhdojnë të kontribuojnë pesë ish - ambasadorë tjerë të Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu, Aleksandër Duma, ish kryetar i saj dhe Bejtullah Destani, themeluesi dhe drejtori i Institutit për Studime Shqiptare. Në anëtarësinë e saj janë emra të tillë si John Hodgson, përkthyesi i veprës së Kadaresë në gjuhën angleze, Patricia Nugee, koleksioniste e njohur e veprave të Skënderbeut në gjuhë të ndryshme të botës, Johana Hansen, ish punonjëse e FCO–së, Adam Yemey, autor librash për shqiptarët etj.

Kjo është emblema e koleksionit të librave për Skënderbun, të cilën e ka zonja Patricie Nugee, antare e bordit të AAA. Ajo ka një numër të madh librash në shumë gjuhë të botës dhe përbën ndoshta koleksionin më të madh privat pë Skënderbun në botë.

Në vëllimin e dytë të këtij libri lexuesi do të gjejë një pasqyrë të plotë të veprimtarive kryesore që Shoqata "AAA" ka zhvilluar në vitet 2012-2016.

Shoqata vepron bazuar në statutin e saj dhe është e vetmja në mes shoqatave shqiptare që vepron bazuar në financimin e vet me kuotizacion. Statuti përshkruan të gjitha rregullat e funksionimit të saj. Ajo drejtohet nga një komitet i cili i merr tëra vendimet në mënyrë kolegjiale në të cilën bëjnë pjesë sekretare znj. Patricia Nugee, Filip Logoreci, Arbër Koci Patricia Swire, Neil Taylor, Patrick Wilson, Fatos Selita, Agron Loxha, Agim Morina, Michael Gun. Disa nga anëtarët e saj janë të dekoruar në kohë të ndryshme nga Presidentët e Republikës së Shqipërisë. Tre prej tyre i ka dekoruar Presidenti Bujar Nishani me datën 9 Dhjetor 2014 dhe pikërisht: Sir Noel Malcolm me Urdhërin e Skënderbut, z. Stephen Nash me urdhërin "*Për Merita të Larta Civile*", z. Alexander Duma me dekoratën "*Nderi i Kombit*".

Një mbrëmje me Anglo – Albanian – Association (AAA) në Ambasadë.

Pas një veprimtarie me mësues dhe nxënës shqiptar në Ambasadë

KAPITULLI I SHTATË

MIQ TË SHQUAR TË SHQIPËRISË NË MBRETËRINË E BASHKUAR.

Ambasda Shqiptare në Londër ka patur përherë miq të dashur të cilët janë kujdesur për propagandimin dhe bërjen të njohur të Shqipërisë në Britaninë e Madhe. Nëpërmjet tyre shumë herë ka ndodhur që të përcillen mesazhe të rëndësishme të shtetit shqiptar tek organet e larta dhe të rëndësishme të shtetit Britanik. Miqtë e Ambasadës janë shumë por në këtë libër do të vendosim vetëm disa më të rëndësishmit prej tyre. Ata janë Lordë, kalorës, sirs, artistë, dhe njerëz me reputacion të njohur në Britaninë e Madhe.

SIR NOEL MALCOLM

MBAJTËS I MEDALJES "NDERI I KOMBIT"

Sir Noel Robert Malcolm (1956) është Profesor në Kolegjin All Soul në Oxford, njëkohësisht President Nderi i Shoqatës Anglo – Shqiptare. Ai është historian anglez i kohëve moderne, shkrimtar dhe kolumnist, autori i librit "*Kosova, një History e Shkurtër*". Malcolmi është i mirënjohur për shkrimet dhe librat mbi historinë e Ballkanit. I arsimuar në kolegjin prestigjioz Eton dhe diplomuar në kolegjin e Peterhouse në Cambridge, para se të linte gazetarinë në vitin 1995 për t'u përqëndruar në kërkime shkencore dhe në shkrimin e librave, ai shërbeu si kolumnist politik për gazetën The Daily Telegraph dhe si redaktor i jashtëm i gazetës Spectator Daily. Malcolm ka mbuluar gjerësisht rajonin e Ballkanit kur punonte si gazetar politik dhe në vitin 1994 ka botuar librin "*Bosnja: Një histori e shkurtër*".

Katër vjet më vonë ai botoi librin "*Kosova. Një Histori e shkurtër*" libër i cili mund të ketë qenë edhe baza shkencore dhe historia e vërtetë e Kosovës që bindi vendet perëndimore për marrjen e një vendimi historik për zgjidhjen e çështjes së saj. Ai ka shkruar mjaft artikuj akademik për Kosovën dhe rajonin. Sir Noel Malcolm ka qenë lektor i jashtëm në Oksford dhe Harvard, dhe aktualisht jep leksione në All Souls College në Oksford. President Nderi i Shoqatës Anglo-Shqiptare ai njëkohësisht kryeson edhe Bordin e Institutit të Bosnjës. Ai sapo ka botuar librin "*Agents of Empire*"[107], Një Histori Shqiptare e Shekullit të 16–të. Po ashtu ka gati për botim

[107] Agents of Empire, Knights, corsairs, Jesuits and spies in the sixteenth-century Mediterranean World

historinë e Ernesto Cons–it, një prif katolik që i kushtoi jetën albanologjisë në fillmin e shek XX. Ai merr pjesë rregullisht në veprimtaritë e AAA (Anglo Albanian Association) Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani e ka dekoruar atë me dekoratën "*Nderi i Kombit*".

LORD NATHANIEL CHARLES JACOB ROTHSCHILD

Dekoruar me Dekoratën e Flamurit Kombëtar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë

Lordi Rothschild ka lindur në një degë angleze të familjes Rothschild në vitin 1936. Ai është i mirënjohur si figurë publike për mbështetjen që iu ka dhënë institucioneve të trashëgimisë kulturore hisotrike në Angli midis të cilave Galerisë Kombëtare dhe Trustit Kombëtar. Ai është një ndër filantropët më të njohur në botë. Shqipëria i detyrohet atij për donacionet e dhëna dhe kujdesin e treguar për ruajtjen e trashëgimisë arkelogjike dhe historike të parkut arkeologjik të Butrintit. Të njejtën gjë ai ka bërë me Shtëpinë Somerset, Shtëpinë e Spenserit dhe atë Waddeston në Angli. Ai është përgjegjës për ndërtesat e Knessetit (Parlamenti Izraelit) Gjykatën Supreme dhe Librarinë e ardhshme Kombëtare, të tëra në Jeruzalem.

Ky Lord është nderuar me "*Dekoratën e Flamurit Kombëtar*" me motivacionin: "*Për ndihmesën e shquar që ka dhënë duke nxjerrë në pah vlerat e jashtëzakonshme historike e arkelogjike të truallit shqiptar, njëkohësisht, pasuri botërore, si dhe për punën e pakursyer në promovimin e pasqyrimin e Shqipërisë kudo në botë*".

Lordi Rothschild dhe Sunsbery, dy themeluesit e "*Fondacionit Butrinti*" me rastin e dekorimit, e falënderuan Kreun e Shtetit Shqiptar për nderimin e madh që iu bë dhe vunë në dukje mes të tjerash se:

"Butrinti është një nga vendet arkeologjike më tërheqëse në Mesdhe, që duhet ruajtur, mirëmbajtur dhe zhvilluar, sepse përbën një pasuri të çmuar të trashëgimisë botërore".[108]

[108] Nga fjala e Lordit Rothchild ditën e dekorimit nga Presdienti i Republikës z. Bujar Nishani më datën 13 Maj 2014

LORD JOHN DAVAN SAINSBURY

MBAJTËS I DEKORATËS SË FLAMURIT KOMBËTAR.

Lordi John Davan Sainsbury, Baron Sainsbury of Preston Candover, KG, ka lindur në datën 2 nëntor 1927. Ai është i biri i Presidentit të Sainsbury-t, një biznesmen britanik dhe politikan i shquar. Ai është anëtar konservator i Dhomës së Lordëve dhe ka studjuar në Shkollën StoWe dhe në Kolegjin Worcester në Oksford. Në vitin 1980 ai është shpallur kalorës për shërbimet në fushën e industrisë ushqimore ndërkohë që njihet si Baroni Sainsbury i Preston Candover,

Në vitin 1985 Lordi Sainsbury i ka dhënë një fond prej 50 milion sterlinash Galerisë Nacionale në Londër për të ndërtuar një krah të kësaj galerie e cila përfundoi në vitin 1991. Po ashtu ai ka financuar Operën Mbretërore në Londër. Veprimtaria e tij në dobi të jetës artistike britanike luan një rol të jashtëzakonshëm.

Në vitin 1993 iu bashkua Lordit Rothschild për të ngritur Fondacionin e Butrintit e për të ruajtur dhe rregjistruar truallin arkelogjik të Butrintit në vendin tonë. Në vitin 2010 ai i dhuroi 25 milion sterlina Muzeut Britanik të cilën BBC e ka raportuar si dhuratën më të madhe të dhënë në dy dekada. Edhe Lordi John Davan Sainsbury i Preston Candover ka marrë dekoratën e "*Flamurit Kombëtar*", "*Për ndihmesën e shquar që ka dhënë duke nxjerrë në pah vlerat e jashtëzakonshme historike e arkelogjike të truallit shqiptar, njëkohësisht, pasuri botërore, si dhe për punën e pakursyer në promovimin e pasqyrimin e Shqipërisë kudo në botë*".

JOHN HODGSON

PËRKTHYESI I VEPRAVE TË ISMAIL KADARESË

John Hodgson është anëtar i Shoqatës Anglo – Shqiptare në Londër. Kjo shoqatë është e nderuar të ketë anëtar përkthyesin e disa prej veprave të Ismail Kadaresë në gjuhën angleze. Ai ka studjuar letërsi angleze në Universitetet e Cambridge-t dhe të Newcastle-s. Në vitin 1980 u dërgua nga Këshilli Britanik për të dhënë leksione në Universitetin e Prishtinës, në Kosovë. Aty mësoi gjuhën shqipe. Kjo bëri që të njihej dhe të dashurohej me letërsinë shqipe. Prandaj i hyri përkthimit të disa romaneve të Ismail Kadarese siç janë: "*Ura me Tri Harqe*", "*Aksidenti*" dhe "*Darka e Gabuar*". Për momentin ai punon për përkthimin ose botimin e veprave "*E Penguara*" dhe "*Kamarja e Turpit*". Z. John Hodgson ka përkthyer gjithashtu veprat e Fatos Lubonjës "*Ridënimi*", "*Nëntëdhjetë e shtata*" dhe "*Endeavour*", si dhe një antologji në gjuhën angleze të revistës "*Përpjekja*". Ka punuar disa vjet si përkthyes në Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, në Hagë.

LORD ALAN JOHN WATSON
MBAJTËS I DEKORATËS GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU

Baron Watson i Richmondit, CBE ka lindur më datën 3 shkurt 1941. Ai është një mik i shquar i Shqipërisë. Bir i një reverendi të quajtur Xhon Uilliam Watson dhe Edna Mary Peters. Studimet i kreu në Kape Toun në Afrikën e Jugut dhe më pas në Cambridge si drejtues i CTN Communications në qendër të Londrës. Është nga konsulentët më të mirë të British Petroleum dhe Tesco-s. Në vitet 60 ishte një ndër prezantuesit më të mirë të programeve financiare të BBC, si dhe në Programin Botëror të BBC. Në vitet (1976–1980) ai ka qenë përgjegjës për mediat e Komisionit Europian. Është bërë shumë i njohur si President i Partisë Liberale dhe në vitin 1990 hyri në Dhomën e Lordëve dhe përfaqëson Richmondin. Ai është midis Lordëve të zgjedhur në Bashkimin Europian dhe bën pjesë në komisionin e përhapjes së gjuhës angleze. Lordi e ka vizituar shumë herë Shqipërinë dhe ka mbajtur lidhje të forta me zyrtarët më të lartë shqiptarë si Kryetar i Dhomës së Tregëtisë Shqipëri – Britani. Si mik i Ambasadës Shqiptare në Londër ai ka dhënë kontribut të madh për forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, sidomos në veprimtarinë e organizuar dhe sponsorizuar bashkë me Ambasadën Shqiptarë në Abbey Westminster në Londër kushtuar Nënë Terezës. Presidenti i Republikës, z Bujat Nishani e ka dekoruar atë me medaljen "*Gjergj Kastrioti Skënderbu*".

LORD MICHAEL WALTON BATES
MBAJTËS I DEKORATËS "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU"

Lord Michael Walton Bates është dekoruar me medaljen *"Gjergj Kastrioti Skënderbeu"* nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Michael Walton Bates, ose Baron Bates ka lindur në vitin 1961. Ai është një politikan konservator dhe ka shërbyer në Dhomën e Komunave nga viti 1992 deri në vitin 1997 dhe më pas, që prej vitit 2008 ai kaloi në Dhomën e Lordëve. Që në moshën 18-vjeçare i është bashkuar Partisë Konservatore. Për momentin është Nënsekretar i Shtetit për Informacionin Kriminal të Home Ofice.

Midis vitit 2011 dhe 2012, Lordi Bates bëri një udhëtim për paqen prej 4.800 kilometrash që nga Olimpi i Greqisë deri në Londër, për të rritur ndërgjegjen rreth Rezolutës së Armëpushimit Olimpik të Kombeve të Bashkuara. Lordi Bates e përshkoi në këmbë territorin shqiptar duke bërë ndalesa që nga jugu në Gjirokastër deri në Shkodër. Ai është ngjitur në Malin e Dajtit dhe në Muzeun e Krujës në këmbë. Që prej asaj kohe ai ka mbetur një mik i mirë dhe i dashur për ambasadën dhe popullin shiqptar. Për këtë, më datën 12 shkurt 2015, në House of Lords në Londër, një grup shqiptaro-britanikësh u mblodhën për të marrë pjesë në ceremoninë e dorëzimit të dekoratës "*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*" që iu akordua nga Presidenti i Republikes z. Bujar Nishani. Ai prezantoi me fotografi udhëtimin nëpër Shqipëri, duke u ndalur tek bujaria, të cilin siç tha ai:

"Midis 16 vendeve ku kalova, Shqipëria më la përshtypjen më të mirë të udhtimit tim të gjatë."

Në përfundim të ceremonisë pjesëmarrësit, në mes të të cilëve edhe Ambasadori i Kosovës z. Lirim Grejçevci, bënë një foto që do të kujtohet gjatë në Dhomën e Lordëve.

SIR ANTHONY BAYLEY
MBAJTËS I DEKORATËS GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU

SIR ANTHONY BAYLEY

Sir Anthony John James Bailey është dekoruar me medaljen "*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Ai është mbajtës i dekoratave KGCN, OBE, GCSS, KC*HS dhe një ndër lobistët më të fuqishëm në Mbretërinë e Bashkuar për marrëdhëniet më të mira ndërfetare midis Europës dhe pjesës tjetër të botës. Ai është konsulent i njohur ndërkombëtar, si dhe donator e mbledhës fondesh bamirësie.

Ka kryer studimet në UCL[109] në Londër mbi Europën Lindore dhe më vonë në Universitetin Corvinus në Budapest, Hungari, në Universitetin e Sofjes, Cyril e Metod, Shën Kliment Ohridski dhe Veliko Turnovo. Në tetor të vitit 2007 është martuar me Princeshën Marie – Therese të Hohenberg, pjesëtare e Shtëpisë së Hohenbergëve, stërmbesë e Princ Franc Ferdinantit, vrasja e të cilit në 27 korrik 2014 në Sarajevë i dha flakën Luftës së Parë Botërore. Ai është Delegati i Grand Magistrate për Marrëdhëniet ndër-fetare dhe Delegat i Britanisë së Madhe dhe Irlandës i Sacred Military Constantinian Order of St George dhe i Royal Order of Francis I.

Veprimtaria e tij shtrihet në fusha të tilla, si ato diplomatike, marrëdhënie midis krerëve të shteteve ndërfetare, veprimtari të rëndësishme midis papatit dhe vendeve muslimane. Ai ka lidhje me një numër shumë të madh krerësh shtetesh që nga Amerika e Jugut e deri në Lindjen e Mesme dhe në Gjirin Persik. Ai është mik i ngushtë i shqiptarëve dhe i ambasadës.

[109] University College London

LORDI ROBERT MACLENNAN, BARON MACLENNAN I ROGATIT

Lordi Robert Maclennan, Baron Maclennan i Rogartit.

Lordi Maclennan ka lindur në Gllasgow në vitin 1936. Ai ka studjuar në Trinity College në Cambridge dhe në Universitetin Kolumbia në Nju Jork. Ai është një politikan me karrjerë të gjatë nga antar i parlamentit deri në antar i kabinetit qeveritar britanik, disa herë. Në vitin 1994, ai është zgjedhur President i Liberal Demokratëve. Më pas ka marrë titullin e lartë "*Lord*".

Maclennan ishte Lordi i Nderit në edicionin e Dytë të "*Notes on Albania*", organizuar nga Ambasada Shqiptare në Londër më datën 26 nëntor 2014. Ai iu adresua audiencës me një fjalë të shkurtër ndër të cilat tha:

> *"Jam i lumtur që kam rastin të mbështes projektin ambicioz të Ambasadës Shqiptare në Londër, e cila ka për qëllim t'i tregojë audiencës britanike kulturën shqiptare në sensin e saj më të plotë. Ngjarje të tilla jo vetëm që ndihmojnë në forcimin e marrëdhënieve tona historike, por edhe të promovojnë Shqipërinë si pjesë e mozaikut kulturor europian. Kultura europiane është themeluar dhe mbështetur në dy shtylla: në larminë e vlerave dhe vlerat e përbashkëta. Ky koncert i rrok të dya këto dimensione themelore dhe, thekson faktin se arti mund të tejkalojë axhendat institucionale dhe natyrisht ndërton urat e dialogut dhe të integrimit".*

DAVID JOHN LLOYD
MBAJTËS I MEDALJES "NËNË TEREZA"

David John Lloyd ka pasur një karrierë të vlerësuar në fushën e mbrojtjes e të sigurisë në Britaninë e Madhe, me mjaft kontribute edhe në fusha të tjera, duke përfshirë politikën, marrëdhëniet ndërkombëtare, mbështetjen e një numri organizatash të ndryshme me influencë në Mbretërinë e Bashkuar. Ai ka punuar intensivisht për realizimin e një prej projekteve më të rëndësishëm të Ambasadës së Shqipërisë në Londër, vendosjen e bustit të Skënderbeut në një nga sheshet kryesore në Londër, vepër kjo që u realizua dhe u inaugurua në 28 nëntor 2012, me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Ai është nderuar nga Presidenti Shqipërisë, z Bujar Nishani me dekoratën "*Nënë Tereza*"**,** me motivacionin: *"Për kontributin e veçantë e të çmuar në forcimin e miqësisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe në promovimin e vlerave historike dhe të çështjes shqiptare".*

ROXANNA PANUFNIK, KOMPOZITORE,

Doxanna Panufnik është mike e ambasadës shqiptare në Londër, ajo është një prej kompozitoreve më të dashura dhe më popullore në Britaninë e Madhe. Veprat e saj janë të mirëpritura nga audienca të gjera në Britani dhe më gjerë. Ajo është e bija e kompozitorit disident polak Andrzej Panufnik, i cili e la Poloninë nga përndjekja e KGB–së në vitin 1954. Ajo ka studjuar në Akademinë Mbretërore të Muzikës në Londër dhe është autore e një vargu veprash ku përfshihen opera, balete, muzikë për teatër, vepra korale, muzikë dhome, muzikë filmash dhe televizioni, të cilat janë luajtur anë e mbanë botës.

Ajo që e lidh këtë artiste të madhe me Ambasadën në Londër është vepra, "*Katër Stinët e Botës*" e kompozuar prej saj, në të cilën koha e parë është "*Vjeshtë në Shqipëri*". Premjera e kësaj vepre është luajtur nën tingujt e violinistes së madhe angleze Tasmine Little dhe orkestra London Moxart Players, transmetuar drejtpërdrejtë si premjerë nga BBC Radio 3. Nën kujdesin e Ambasadës Shqiptare në Londër, këtë vepër e luajti edhe Orkestra Simfonike e Radio Televizionit Shqiptar me datën 13 shtator 2013 në sallën e Akademisë së Arteve ku e ftuar ishte vetë autoria. Në Edicionin e Dytë të "*Notes on Albania*", vepra u luajt nga violinisti Eljon Vesjiu dhe pianistja Mariela Cingo. Panufnik është një mikeshë e artistëve shqipar që performojnë në Londër siç janë, Alda Dizdari, Tomorr Kokona, Brikelda Syla, etj.

KRISTEN JOHNSON, MUZIKANTE, POLITIKANE.

Ka lindur në Shtetet e Bashkuara dhe është vendosur në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1994. Pasi kreu studimet master në Universitetin e Teksasit Verior, përftoi bursë studimi nga Rotary International për të studjuar në Vjenë e Austri në vitin 1992-1993. Gjatë asaj kohe në Vjenë ajo mori një ftesë nga Shqipëria për të dhënë mësime master për piano dhe një koncert recital ku takoi dhe njohu shumë kompozitorë dhe muzikantë. Kjo e frymëzoi të bënte kërkime rreth muzikës shqiptare për gradën e vet të doktoraturës në Artin Muzikor. Dr Johnson rregjistroi dy CD me muzikë pianistike klasike shqiptare, njëra e quajtur "*Këngë*", e cila u prit me duartrokitje në shkallë botërore dhe ndihmoi në njohjen e muzikës tonë jashtë vendit. Për të pati komente të tilla si: "*Johnson luan me nuanca dhe ngjyra; regjistrimi është i pasur dhe rikumbues*," nga Guida Amerikane e Regjistrimit. E dyta, e quajtur "*Rapsodia*" përbëhet nga veprat e shumë kompozitorëve të shquar shqiptar përfshirë Çesk Zadenë, Feim Ibrahimin dhe Tonin Harapin.

Dr.Johnson ka regjistruar gjithashtu për Delos dhe Nimbus. Diskografia e saj përfshin veprën e plotë për muzikë pianistike të kompozitorit të famshëm Amy Beach dhe Arthur Foote dhe shumë pjesë të Dimitri Kabalevskit. Ajo është një mike e Shqipërisë dhe Ambasadës Shqiptare në Londër dhe e paraqet veten në Websitin e saj në një foto me instrumentin shqiptar të çiftelisë. Ajo jeton dhe jep mësim në Universitetin Oksford dhe pretendon të jetë anëtare e Parlamentit Britanik si kandidate laburiste në zgjedhjet e përgjithshmë të Britanisë së Madhe të vitit 2015.

CLLR SUSIE BURBRIDGE, LORD MAYOR WESTMINSTER

Susie Burbridge ka përfaqësuar Lancaster Gate për tetë vjet, ka qenë anëtare e këshillit bashkiak të Westminster Council dymbëdhjetë vjet dhe ka punuar për Parlamentin Britanik për më shumë se dhjetë vjet. Ajo është nënë e tre fëmijëve dhe beson në vlerat e familjes. Zonja Burbridge është mikeshë e Ambasadës Shqiptare dhe ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në lejimin e vendosjes së Bustit të Skënderbeut kur ishte Kryetare e Këshillit Bashkiak të Westminstër Council. Ajo mori pjesë në inagurimin e bustit më datën 28 Nëntor 2012 bashkë me kolegun e saj, këshilltarin Robert Devis. E dekoruar dhe e nderuar nga Mbretëresha Elizabeth miqësia e saj i bën nder Ambasadës Shqiptare në Londër.

KAPITULLI VIII
SHENJA KUPTIMPLOTË TË PRANISË SHQIPTARE NË LONDËR

Në Londrën e mbushur me muzeume, vepra arti, statuja, portrete, tre janë veprat e artit, të cilat në një mënyrë ose në një tjetër tregojnë praninë shqiptare:

BAYSWATER

BUSTI I SKËNDERBEUT

Ky bust është vepër e skulptorit tonë të njohur Kreshnik Xhiku, autor i Statujës së Nënë Terezës vendosur në Cleveland, i statujës së Mbretit Zogu I, i vendosur në Tiranë, portretit të Faik Konicës në Kodrat e Liqenit artificial, monumentit të Skënderbeut në Michigan, etj.

Ai është vendosur me datën 28 Nëntor 2012 me rastin e ditës së 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe gjendet në adresën: 113 Inverness Terrace, London W2 6JH.

Vendosja e këtij busti është frut i një pune intensive disa mujore të Ambasadës Shqiptare në Londër, Westminster City Council, Galerisë së Arteve në Tiranë dhe i ndihmuar intensivisht nga miku i dëshmuar i Shqipërisë, z David Lloyd dhe Lord Mayer of Westmister, zonja Susie Burbridge.

Ditën e inagurimit të bustit kishin ardhur qindra qytetarë britanikë me origjinë nga tëra viset shqiptare në rajonin e Ballkanit. Aty morën pjesë edhe përfaqësues të Westminster City Council, znj. Susie Burbridge dhe Robert Davis, Delegati i Urdhërit të Konstandinit për Britaninë dhe Irlandën, Sir Anthony Baily, si dhe njëri nga njerëzit që kanë ndihmuar më shumë për vendosjen e bustit, z David Lloyd.

Në fjalën e tij z. Robert Davis, përshkroi jetën dhe kontributin e pashembullt të Skënderbeut dhe arsyen përse ky bust do të qëndrojë në një prej lagjeve më të bukura të Londrës, në Bayswater. Busti i Skënderbeut në Londër është vendosur në Google Map si një ndër shenjat orientuse të qytetittë Londrës. Ai është kthyer në një qendër peligrinazhi. Shumë shqiptarë e vizitojnë atë në ditë gëzimesh, festash, martesash dhe ditëlindjesh.

GALERIA KOMBËTARE E PORTRETEVE

PORTRETI I GEORGE GORDON BYRON

Portret i poetit George Gordon Bayron në rroba Kombëtare Shqiptare konsiderohet si portreti më i bukur i Galerisë Kombëtare të Portreteve të Britanisë së Madhe. Vepra gjendet në atë që njihet si National Portrait Gallery në Londër, në St. Martin's Pl, London WC2H 0HE. Në të shkruhet diçitura: Byron në kostum shqiptar. Ky portret është bërë në dy kopje. Njëri gjendet në zyrën e Ambasadorit Britanik në Athinë dhe tjetri në Galerinë Kombëtarë të Portreteve në Londër. Porterin e ka bërë piktori i njohur anglez Thomas Philips (1770–18450). Byroni - i pozoi Philipsit në vitin 1813 i veshur në kostum kombëtar shqiptar, të cilin e kishte blerë katër vjet më parë. Ky kostum sot gjendet në Bowood in Wiltshire. Në atë kohë ka pasur shumë komente dhe mendime rreth këtij protreti. Më i pranuari ka qenë ai i eseistit dhe poetit Leigh Hunt, i cili mendon se ky është portreti më i bukur që është ekspozuar ndonjëherë me më shumë element dekorues, d.m.th. më i miri në jetën e tij, si në elementë ashtu edhe në shprehje. Ky variant është ekspozuar në vitin 1835. Autori ka bërë 700 portrete. Ai ka qenë anëtar i Akademisë Mbretërore qysh në vitin 1808 dhe profesor në vitet 1825 dhe 1832. Ai ka bërë një numër shumë të madh portretesh të njerëzve të shquar. Megjithatë portreti i Byron - it mbetet më i bukuri dhe pa dyshimm më e njohura vepër e Philipsit që e ka bërë edhe atë të pavdekshëm.

Instituti Mbretëror Anthropologjik i Britanisë së Madhe dhe Irlandës.[110]

Një tjetër vend ku gjëndet trashëgimia, kultura, historia, kostumografia, kultura materiale e shqiptarëve është Instituti Mbretëror Anthropologjik i Britanisë së Madhe dhe Irlandës. Aty gjëndet tërë koleksioni i mbledhur nga udhëtarja, antropologia, studjuesja dhe mikesha e pashoqe e shqiptarëve, Ms Edith Durham. Në atë institut gjëndën disa albume të mëdha me fotografitë që ajo ka marrë në Shqipërinë e Veriut, në vendbanimet shqiptare në Mal të Zi, madje edhe në Maqedoni. Ky koleksion është i hapur për studjuesit dhe përbën një tjetër shenjë të pranisë shqiptare në Londrën e pasurive të pafund të kësaj natyre. Bazuar në këtë pasuri si dhe në shkrimet e saj, janë botuar një seri librash tw saj.

[110] Royal Anthropological Institute of Great Britain and Ireland, 50 Fitzroy Street, London W1T 5BT

MUZEUMI I ARTIT TATE BRITTON
MEHMET ALI PASHAI I EGJYPTIT

Ndërkohë, në Muzeumin e artit britanik Tate Britton gjendet njw pikturw e Mehmet Ali Pashait, themeluesit të Egjyptit modern. Ai është i ekspozuar në një vend shumë të dukshëm dhe ze një vend të rëndësishëm në artin figurativ britanik. Mehmet Aliu (1769–1849) u bë pashai i Egjyptit në vitin 1805. Ai themeloi dinastinë e tij e cila sundoi deri në vitin 1952. Piktura është vepër e Sir David Wilkie (1785–1841). Autori e takoi Mehmet Ali Pashain në vitin 1841, ndërkohë që kishte shkuar për të bërë piktura me përmbajtje biblike si dhe peisazhe. Ai nuk arriti ti ekspozonte për së gjalli pasi vdiq rrugës për në kthim në vitin 1841. Kjo pikturë paraqet një figurë mbresëlënëse, të veshur në rroba të pasura me një shpatë të gjatë që e mban në anën e majtë. Fuqia dhe karakteri i tij theksohen në shprehjen e vendosmërisë në duart e tij që shtrëngojnë krahët e kolltukut ku është ulur. Vepra është e varur në muzeun më të madh të krijimeve të piktroëve më të shquar britanikë dhe iu kujton vizitorëve njërën prej figuave më madhështore shqiptare të shekullit të 19–të.

KAPITULLI I NËNTË

MARRËVESHJET E ARRITURA MIDIS SHQIPËRISË DHE BRITANISË SË MADHE

Ndër treguesit më kuptimplotë të nivelit të marrëdhënieve midis dy shteteve janë marrëveshjet e arritura në rrjedhë të marrëdhënieve diplomatike. Shqipëria ka një numër marrëveshjesh të arritura që nga data 22 korrik 1926, deri me 13.3.2013.

1. Marrëveshje ekstradimi ndërmjet Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe, nënshkruar më 22 korrik 1926.
2. Memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, nënshkruar më 8.05.1992, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
3. Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për transportin rrugor ndërkombëtar, nënshkruar më 09.02.1993.
4. Memorandum i mirëkuptimit për bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut, nënshkruar më 22.10.1993, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
5. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut mbi bashkëpunimin në fushat e arsimit, shkencës dhe kulturës, nënshkruar më 30.03.1994, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
6. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, nënshkruar më 30.03.1994, hyrë në fuqi 30.08.1995.
7. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për shërbimin ajror, nënshkruar më 30.03.1994, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
8. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në fushën e mbrojtjes së turizmit, nënshkruar më 30.03.1994.
9. Kontrata e shkëmbimit për pronësinë me Ambasadën Britanike, nënshkruar më 19.05.1997.
10. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe

dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave, nënshkruar më 14.10.2003, hyrë në fuqi më 16.08.2005.

11.Protokolli i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave, nënshkruar më 14.10.2003, hyrë në fuqi më 16.08.2005.

12.Memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për drejtimin e stërvitjeve ushtarake e të trajnimeve dhe për dispozitat e mbështetjes së vendit pritës, nënshkruar më 2003.

13.Memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe në lidhje me bashkëpunimin hartografik, vëzhgimin dhe shkëmbimin e materialeve gjeografike, nënshkruar më 2005, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.

14.Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për transferimin e personave të dënuar, nënshkruar më 15.1.2013, hyrë në fuqi më 11.6.2013.

15.Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariatit të Shtetit të Mbretërisë së Bashkuar për shkëmbimin e informacionit për migracionin, nënshkruar më 13.3.2013, hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Mbyllje

Realitete Shqiptaro Britanike është një punë në proces. Ashtu sikundër jeta vazhdon, këto mardhënje do të zhvillohen dhe historia i mbetet borxh që t'i shkruaji ato. Ky libër ka dhënë një pasqyrë të disa gjërave por jo të gjithave. Prandaj mbetet detyrë e diplomatëve shqiptarë që

do të shërbejnë në Ambasadën Shqiptare në Londër, jo domosdoshmërisht historianë, që të vazhdojnë të shkruajnë për traditën që ndërtohet çdo ditë. Përvoja në shërbimin diplomatik në Londër do të mësojë çdo diplomat se sa rëndësi i jep ky popull historisë së vet. Këtu edhe një relike e vogël, edhe një kartolinë, konsiderohet si një shenjë historie të cilës i rritet vlera çdo ditë që kalon. Kjo është edhe arësyeja përse ky popull është kaq krenar për veten e tij. Po ne përse mos të jemi?

Do të isha i lumtur nëse kjo që është shkruar në këtë libër do të përbënte një nxitje për ta bërë atë shumë volumësh në të ardhmen me autorë tjerë që do ta kenë mundësinë që pata unë, në vitet dhe dekadat që vijnë, për të mirën e Shtetit Shqitar që Zoti e Bekoftë!

MB

Përmbajtja

Hyrje

KAPITULLI I PARË

UDHËTARËT BRITANIKË NË SHQIPËRI NGA SHEKULLI XVII DERI SOT

Richard Knolles
Edward Brown

Lady Mary Wortley Montagu
William Martin Leake
George Gordon Byron
John Hobhouse
Henry Holland
Thomas Smart Hughes
Charles Cockerell
Benjamin Disraeli
David Urquhart
Robert Curzon
Edward Lear
James Henry Skeene
Edmond Spencer
Willian Wingfield
George Finlay
Georgina Mackanzie & Paulina Irby
Henry Fanzhawe Tozer
Arthur Macmurrough Kavanagh
Arthur Evans
Eduard Frederick Knight
Fanny Janet Blunt
Henry N. Brailsford
Edith Durham
Sir Robert Graves
Aubrey Herbert
Margaret Hasluck
Adham Peacock
Dunkan Heaton – Armstrong

Norman Douglas
George Phillips
Harry Hodgkinson
Sir Noel Malcolm

KAPITULLI I DYTË

NGJARJET KRYESORE QË I KANË DHËNË FORMË MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO BRITANIKE

Kongresi i Berlinit **"*memorandum to lord beaconsfield*"**
Konferenca e Ambasadorëve në Londër, 1913
Traktati i Fshehtë i Londrës, 1915
Lidhja e Kombeve dhe kontributi i britanikëve në anëtarësimin e Shqipërisë

Raport i Foreign Office – Shqipëria = Politika Britanike nga viti 1912 deri në qershorin e vitit 1920

Organizimi i xhandarmërise shqiptare nga britanikët, dayrell oakley-hill

Special Operation Executive

KAPITULLI I TRETË
PRANIA DIPLOMATIKE SHQIPTARE NË LONDËR

Mehmet Konica 1922 – 1924
Ilias Bej Vrioni (1925 – 1926) (1929 – 1932)
Maliq Libohova 1926 – 1927
Eqrem Bej Vlora 1927 – 1929
Xhemil Dino 1932 – 1933
Rauf Fico
Qatin Saraçi, (1935 – 1935)
Lec Kurti , (1935 – 1939)
Dervish Duma 1939
Alexander Duma, (I dërguar i posaçëm, 1991 – 1992)
Pavli Pesku (1993 – 1997)
Agim Fagu (1997 – 2002)
Kastriot Robo (2002 – 2007)
Zef Mazi (2007 – 2011)
Dr Teuta Starova (2008 – 2011), (2011 – 2012) (e ngarkuar me punë.
Mal Berisha (2012 – 2016)

Konsujt e Nderit të Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar

1. Alexander Duma 1992
2. Bryony Bethel Konsull Nderi në Oxsfordshire
3. John van Weenen, Northampton, 2012

KAPITULLI I KATËRT

PRANIA E PËRFAQËSIMIT DIPLOMATIK BRITANIK NË SHQIPËRI

Sir Harry Charles Augustus Eyres 1922 - 1926.
Willian Edmund O'reilly (1926)
Willian Seeds (1926 – 1928)
Sir Robert Macleod Hodson (1928 – 1936)
Sir Andrew Ryan, (1936 – 1939)
Laurance Barton Grafftey, (1939 – 1940)
Sir Stephen Loftus Egerton, (1991 – 1992)
John Stewart Duncan - OBE (1992-1996), i ngarkuar me punë
David Arthur Slinn (1995 – 1996)
Andre Toserere (1996 – 1998)
Stephen Nash (1993 – 1995) (1998 – 1999)
Peter January (1999 – 2001)
David Landsman
Richard Jones (2003 – 2006)
Fraser Andrew Wilson (2006 – 2009)
Fiona Mcllwam (2009 – 2012)
Nicolas Canon 2012 – sot

KAPITULLI I PESTË

Çlirimi i Kosovës – Riparim i një padrejtësie historike dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike Kosovë Britani e Madhe

Dr Muhamet Hamiti (2008-2012)
Bejtullah Destani (2018 – 2014)
Lirim Greiçevci **(2012)**

KAPITULLI I GJASHTË

SHOQATAT SHQIPTARO – BRITANIKË NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Anglo Albanian Association

KAPITULLI I SHTATË

MIQ TË SHQUAR TË SHQIPËRISË NË MBRETËRINË E BASHKUAR.

Sir Noel Malcolm, mbajtës i medaljes nderi i kombit
Lord Nathaniel Charles Jacob Rothschild, mbajtës i dekoratës së
Flamurit Kombëtar
Lord John Davan Sainsbury, mbajtës i dekoratës së Flamurit Kombëtar.
Lord Alan John Watson, mbajtës i dekoratës "*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*"
Lord Michael Walton Bates, mbajtës i dekoratës "*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*"
Sir Nnthony Bayley mbajtës i dekoratës "*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*"
Lordi Robert Maclennan, baroni Maclennan i Rogartit.
David John Lloyd mbajtës i medaljes "*Nënë Tereza*"
Roxanna Panufnik, kompozitore,
Kristen Johnson, muzikante, politikane.
Cllr Susie Burbridge, lord mayor Westminster

KAPITULLI I TETË
KATËR SHENJAT KUPTIMPLOTË TË PRANISË SHQIPTARE NË LONDËR

Bayswater
Busti i Skënderbeut

Galeria Kombëtare e Portreteve
Portreti i George Gordon Baron

Instituti Mbretëror Anthropologjik i Britanisë së Madhe dhe Irlandës

Muzeumi i artit Tate Britton
Mehmet Ali Pashai i Egjyptit

KAPITULLI I NËNTË

MARRËVESHJET E ARRITURA MIDIS SHQIPËRISË DHE BRITANISË SË MADHE

Mbyllje

Index – pwr tu bwrw

Kopertina e Pasme

MAL BERISHA 2012 - 2016

Kopertina e Pasme



Mal Berisha, ka botur një seri librash studimorë rreth çështjes shqiptare në lidhje me botën anglo-saksone siç është studimi i plotë i shkrimeve në revistën amerikane National Geographic Magazine për shqiptarët, botuar nën titullin "*Shqiptarët, Lisa mbi Truallin Ilir*".(2007) Më pas ka botuar librin "*Shqiptarët, Europianët më të Lashtë dhe më të Rinj*".(2008) "Jeta *e amerikanit Charles Telford Erickson kushtuar Shqipërisë*" (2012); Monografinë në gjuhën angleze "*Herman Bernstein – Gazetar, shkrimtar dhe diplomat*" (2014) të cilin e ka publikuar në Institutin e Studimeve Hebraike YIVO në New York si dhe, përpara trupit diplomatik në Londër nën kujdesin e Ambasadorit Amerikan në Mbretërinë e Bashkuar. Realitete Shqiptaro Brtianike është libri I tij I radhës. Punimet e tij gjënden online në websitin: www.Malberisha.com